

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 417 • GUSHT 2025



**EMPATIA E VOBECTË
PËRBALLË TRAGJEDIVE
NJERËZORE**

SAHABËT – HALLKA E PARË NË
THEMELIMIN E MEDHHEBIT HANEFI

LËVIZJA E DEÇANIT – MES LËVIZJES
KOMBËTARE DHE LËVIZJES PËR
PËRÇARJE NË DËRRËZIMET

GJENOCIDI I SHITIT SERB NDAJ SHQIPTARËVE GJATË
LUFTËS SË KOSOVËS (1998-1999)

FOTOALBUM NGA PROMOVIMI I LIBRIT DËSHMITAR I GJENOCIDIT NË SREBRENICË”



“Dëshmitar i gjenocidit në Srebrenicë”

Autori: Mevludin Hrnjić – i mbijetuar i gjenocidit

Ky libër rrëfen një dëshmi tronditëse nga brenda ferrit të Srebrenicës. Autori, imam dhe dëshmitar i drejtpërdrejtë, përshkruan me ndjenjë dhe vërtetësi 80 ditë të mbijetesës së tij – nga rënia e Srebrenicës e deri në shpëtimin në territoret e lira. Një rrëfim që duhet lexuar, kujtuar dhe shpërndarë.

- Libri është i qasshëm në Librarinë “Dituria Islame” në Prishtinë
- Adresa e librarisë në Facebook :
Libraria “Dituria Islame” Prishtinë
- Mund ta porosisni edhe online përmes faqes zyrtare të Shtëpisë Botuese “Dituria Islame”



EDITORIAL

- 4 Empatia e vobektë përballë tragjediave njerëzore
- 5 Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në promovimin e librit "Dëshmitar i gjenocidit në Srebrenicë" të autorit Mevludin Hrnjiq

FETARE

- 7 Forca e moralit në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë
Isa Tërshani
- 11 Myslimanët në Perëndim në mes ruajtjes së identitetit dhe tëhuajësimit
Dr. Bashkim Aliu
- 14 Sahabët – hallka e parë në themelimin e medhhebit hanefi
Dr. Muhamed Stublla
- 18 Origjina e shkollave juridike islame
Mr. Hazir D. Selmani
- 22 Fikhu i prioriteteve në jetën e myslimanit
Dr. Jusuf Kardavi
- 24 Mysafirët e vegjël të xhamisë
Nexhat Ibrahim

FAMILJE & EDUKIM

- 27 Sukresi i femrës së mbuluar si përgjigjja më e mirë për paragjykimet ndaj saj
Nada Dosti
- 30 Rinia dhe identiteti islam në kohën e rrjeteve sociale
Armida Plumbi
- 34 Të ushqyerit e shëndetshëm gjatë ditëve të verës
Nderim Rexhepi, Urata Rexhepi, Agron M. Rexhepi



KULTURË

- 37 Autochthonous
Nuredin Nazarko
- 39 Dëshmitari i gjenocidit të Srebrenicës
Dr. Azmir Jusufi
- 41 Lëvizja e Deçanit – mes Lëvizjes Kombëtare dhe Lëvizjes për përçarje ndërvëllazërore
Dr. Shkodran Imeraj
- 45 Objektet e kultit si ruajtëse të kujtesës historike – rasti i Teqesë së Radës
Dr. Eduart Caka

HISTORI DHE CIVILIZIM

- 48 Gjenocidi i shtetit serb ndaj shqiptarëve gjatë luftës së Kosovës (1998-1999)
Mr.sc. Adnan Qaka
- 52 Rezistenca – nga historia në ndërgjegje
PhD. Merjeme Gashi
- 54 Masakra e Srebrenicës e vitit 1995 në Bosnje e Hercegovinë në dritën e shtypit shqiptar në Kosovë (2)
Nuridin Ahmeti
- 58 Kontributi i El Frabiut (872 – 950) në zhvillimin e shkencës
M.sc Artan S. Mehmeti

AKTIVITETE

- 61 Reportazh nga vizitat e Myftiut Tërnavë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore
Nr. 417 • viti 38 • Gusht 2025
• Sefer 1447
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



Empatia e vobektë përballë tragjedive njerëzore

“Nëse ata tregojnë prirje për paqe, trego edhe ti prirje për të dhe mbështetu te Zoti, se Ai, me të vërtetë, i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë”.

(El Bekare, 61)

Sikur njerëzimi t'i vinte tërë kapacitetet e veta në shërbim të paqes, humanizmit e fisnikërisë, s'do të ngelte më forcë tek ai për intriga, keqbërie e as vullnet për brutalitet e krime në tokë. Por, ta imagjinosh botën se ajo u dashka të jetojë në paqe, respekt të ndërsjellë e harmoni, tanimë duket më shumë se naivitet dhe një gjë e tillë tingëllon thjesht një utopi. Për dikë tjetër mund të jetë ndryshe, veçse për myslimanët, paqja në mësimet fetare mbetet ndër postulatet më të kristalta që s'do mund të madh për ta kuptuar. Zoti ynë tha: *“Nëse ata tregojnë prirje për paqe, trego edhe ti prirje për të dhe mbështetu te Zoti, se Ai, me të vërtetë, i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë”.* (El Bekare, 61).

Ne bijtë e këtij nënqielli ballkanik, të rreshkur nga flakët e luftërave shekullore, dhe të ndrydhur nga ambiciet e shturura ekspansioniste të fqinjëve tanë, e kuptojmë më së miri çmimin e gjenocidit dhe e ndiejmë shijen e hidhur të betejave me ata që aspiruan mizorisht trojet tona. Ne, edhe po të donim, kurrë s'mund të mbetemi të varfër në ndjenjën e empatisë me të përvuajturit kudo në botë. Mund të hiqemi si indiferentë, ama thellë në shpirt, bashkëndiejmë vuajtjet me të shtypurit.

Duke shikuar me paanësi ngjarjet që ndodhin sot, e kuptojmë një fakt që bota, sikur edhe më parë, po aq sa vuan nga një pakicë njerëzish që kanë prirje keqbërëse e vandale, po aq vuan nga shumica tjetër që tragjeditë dhe krimet i shohin me indiferencë po sikur të ishin shfaqje teatrale.

Është e natyrshme që ne, të dalë nga një konflikt gjenocidal, të mos e kemi as luksin kombëtar e as peshën gjeopolitike për të gjykuar luftërat nëpër botë, por megjithatë kjo s'na bën të mos ndiejmë dhimbje për tragjeditë që iu ndodhin sot njerëzve të pafajshëm, sado larg nesh që ata mund të jetojnë.

Pamjet filmike dhe imazhet e tmerrshme që na shfaqen para syve tanë nga Gaza, por ngjashëm me to edhe nga Ukraina, ani pse jo në të njëjtën shkallë, të bëjnë të harrosh faktin se je i parëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Ato zgjojnë ndërgjegjen e thellë njerëzore dhe të bëjnë të ndiesh dhimbje për ata mijëra fëmijë, gra e pleq që vriten mizorisht e i nënshtrohen çdo ditë një aparteidi të frikshëm në planetin tonë. Ajo që ndodhë me popullin e ngujuar brenda një rripi toke të ngushtë, është klasifikuar nga gjithë organizmat relevantë ndërkombëtar si tendencë shfarosjeje të një populli të tërë, dhe si gjenocid i kulluar. Andaj, nuk është më dilema se çka është duke ndodhur atje, por çështja është se si po reagojmë dhe cilat janë rrugët e shërimit të kësaj krize.

E për reagimin e vobektë të botës përballë kësaj vuajtjeje, i drejtpërdrejtë ishte edhe António Guterres - sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ku mënyrë eksplicite deklarohet: *“Nuk kam asnjë koment për atë se sa moskokëçarëse e sa neglizhente është bashkësia ndërkombëtare, pos mungesës së humanizmit e mungesës së solidarizimit me vuajtjet palestinezëve në Gazë. Kriza në rrip, nuk është thjesht një krizë njerëzore, ajo për më tepër është krizë morale që përbën një sfidë për ndërgjegjen botërore, dhe ne do të vazhdojmë të ngremë zërin në çdo rast që e kemi”.*

Këtyre zërave racional që kërkojnë ndaljen e menjëhershme të gjenocidit ndaj popullatës së pambrojtur, i janë bashkuar liderët botërorë e evropianë dhe së fundi edhe presidentja e shtetit tonë. Është kështu ngase, uria e paprecedentë, lufta shfarosëse, përndjekja e një populli të tërë atje, përbëjnë arsye të fuqishme që ndjenja e empatisë të ngjallet në shpirtin e secilit njeri, pa përjashtim, nëse veç nuk e kemi harruar faktin se jemi njerëz. Ndoshta duket ironike, por organizata SIPRI (Stockholm International Peace Research Institute) raporton se shpenzimet ushtarake globale tejkalojnë 2 trilionë dollarë në vit (rreth 2 – 2.3 trilionë USD). Ndërkaq, sipas vlerësimeve të institucioneve si UN, konsiderojnë se duhen rreth 300 – 400 miliardë dollarë në vit, për një periudhë dhjetë vjeçare për të eliminuar varfërinë ekstreme në botë. Këto të dhëna na tregojnë se njerëzimi ka burimet e begata për të zhdukur vuajtjen dhe mjerimin, por mungon vullneti i përbashkët për ta bërë këtë realitet. Në vend që pasuritë të përqendrohen në përmirësimin e jetës dhe ruajtjen e dinjitetit të njeriut, ato sot më shumë investohen në mekanizma shkatërrimi e kaosi në tokë.

Mr. Driton Arifi

Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në promovimin e librit “Dëshmitar i gjenocidit në Srebrenicë” të autorit Mevludin Hrnjiq

Inderuari kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti,

E nderuara zëvendëskryeministre, znj. Emelia Rexhepi,

Të nderuar deputetë

Të nderuar përfaqësues të institucioneve,

Të nderuar udhëheqës dhe drejtues të Bashkësisë Islame të Kosovës,

Të nderuar të pranishëm,

Miq dhe dashamirë, motra dhe vëllezër!

Sot, në përvjetorin e 30-të të gjenocidit të kryer në Srebrenicë nga forcat serbe, jemi mbledhur jo vetëm për të kujtuar, por edhe për të dëshmuar se kujtesa nuk vdes dhe e vërteta nuk heshtet.

Ky përvjetor i dhimbshëm shënohet me një kontribut modest, në nderim të të gjitha viktimave, përmes botimit në gjuhën shqipe të librit “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës”, të autorit dhe të mbijetuarit të këtij gjenocidi, imamit Mevludin Hrnjiq. Promovimi i këtij botimi realizohet sot, në këtë aktivitet të veçantë, si homazh për viktimat dhe si shprehje e kujdesit, kujtesës dhe përgjegjësisë morale ndaj historisë sonë.

Ngjarjet e korrikut të vitit 1995 në Srebrenicë nuk janë një tragjedi e izoluar, por një akt i qëllimshëm gjenocidi, i orkestruar me synimin për zhdukjen e boshnjakëve, vetëm pse i përkisnin një besimi dhe etnie tjetër. Mbi 8,000 burra

dhe djem u masakruan, shumë gra u përdhunuan dhe mijëra familje u shpërngulën, nën sytë e botës dhe përballë institucioneve që kishin për detyrë mbrojtjen.

Gjenocidi në Srebrenicë këtu e -30vjet me parë u krye në një zonë të shpallur të mbrojtur nga OKB-ja, duke përfaqësuar jo vetëm dështimin e komunitetit ndërkombëtar, por edhe një plagë të përbashkët të njerëzimit. Ideologjia e shfarosjes qëndronte pas kësaj tragjedie dhe u përhap më pas edhe ndaj popullit shqiptar në Kosovë, i cili përjetoi masakra, dëbime masive dhe përpjekje për shfarosje në vitet në vijim.

Populli boshnjak, ashtu si ai shqiptar, treguan qëndresë me dinjitet, duke mbrojtur jo vetëm jetën, por edhe identitetin,





besimin dhe të drejtën për ekzistencë. Kjo qëndresë dhe kjo e vërtetë vazhdojnë të ruhen përmes kujtimeve dhe dëshmive të të mbijetuarve.

Është me rëndësi të veçantë përmendja e botimit në shqip të librit “*Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës*”, nga Mevludin Hrnjić, një prej të mbijetuarve të asaj tragjedie, i cili përmes fjalës së shkruar u ka dhënë zë atyre që nuk mundën të flasin.

Ky libër nuk do të ekzistonte pa guximin, motivimin dhe vendosmërinë e autorit, imamit Mevludin Hrnjić, i cili përjetoi në mënyrë të drejtpërdrejtë sfidën jetësore gjatë rrethimit të Srebrenicës dhe sulmit brutal të forcave serbe, si dhe në rrugën e tij drejt territoreve të lira. Ai ndau me botën përvojën e tij personale dhe kolektive, duke sjellë vuajtjet, rrëfimet, humbjet dhe rezistencën e një imami që nuk braktisi besimtarët në momentet më të rënda. Ky është një akt i lartë shërbimi ndaj së vërtetës, drejtësisë dhe brezave që vijnë.

Librin që po promovojmë sot, botuar nga Shtëpia Botuese “Dituria Islame”, përfaqëson më shumë se një dëshmi; ai është thirrje për ndërgjegje, burim edukimi për brezat e rinj dhe urë lidhëse mes kujtesës dhe së ardhmes. Për lexuesin shqiptar, kjo vepër hedh dritë mbi njërën prej plagëve më të rënda të historisë së popullit boshnjak dhe përmes saj nxit nevojën për ruajtjen aktive të kujtesës historike, përballë mohimit dhe harresës që shpesh vjen me kalimin e kohës. Ajo na fton gjithashtu të reflektojmë mbi përvojat e ngjashme të popullit tonë, duke forcuar solidaritetin dhe ndërgjegjësimin ndaj së vërtetës dhe drejtësisë.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, përmes Drejtorisë për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, ka ndërmarrë dhe do të mbështesë në të ardhmen projekte të tilla që dëshmojnë të vërtetën e hidhur të së kaluarës sonë të afërt – jo për hakmarrje apo urrejtje, por për vendosjen e drejtësisë dhe për parandalimin e tragjediave të ngjashme në të ardhmen.

Në këtë frymë, kujtojmë fjalën e Kuranit famëlartë: “*Mos mendoni se ata që janë vrarë në rrugën e Allahut janë të vdekur. Jo! Ata janë të gjallë te Zoti i tyre dhe furnizohen.*” (Ali Imran, 169). Dhe urtësinë popullore që thotë: “E kaluara kur harrohet, rrezikon të përsëritet.”

Meqenëse për librin do të flasin më kompetencë – referuesit e çmuar që vijnë nga bota akademike dhe kanë njohuri të thella në këtë fushë – për se unë dëshiroj t’i falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar që ky libër të jetë në gjuhën shqipe dhe në dispozicion të lexuesve shqiptarë.

Falënderoj përkthyesin, për ndjeshmërinë dhe besnikërinë ndaj autorit, redaktorët, për përkushtimin ndaj fjalës dhe kuptimit, dhe botuesit e realizuesit, për mundësinë që kjo dëshmi të arrijë te lexuesi shqiptar.

Të nderuar të pranishëm,

Para se të përfundoj, më lejoni që ta falënderoj nga zemra autorin e librit që promovojmë sot, në këtë përvojë të dhimbshme – imamin e nderuar Mevludin Hrnjić, i cili sot është në mesin tonë.

Jo vetëm për fjalët e shkruara në këtë libër, por për forcën e shpirtit që qëndroi përballë errësirës dhe zgjedhi të flasë. Të flasë për ata që nuk janë më. Të flasë që ne të mos harrojmë. Mevludin efendi, zëri yt është zëri i Srebrenicës! Përmes teje, ata që u zhdukën në errësirë, sot flasin përmes dritës.

Krejt në fund, me lejoni të them edhe këtë,

Me këtë aktivitet, dëshirojmë t’i bashkëngjitemi zërit të botës demokratike që kërkon drejtësi, të vërtetë dhe kujtesë për atë që ka ndodhur në Srebrenicë. I bashkohemi përpjekjeve të shteteve, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare që kanë mbështetur pa mëdyshje njohjen dhe cilësimin e kësaj masakre me emrin që meriton – *gjenocid*.

Po ashtu ky aktivitet duhet kuptuar si një mesazh dhe si një kontribut për paqe, mirëkuptim dhe bashkëjetesë. Ne besojmë thellë se Zoti i ka krijuar njerëzit të jetojnë në paqe e harmoni – jo në konflikte, urrejtje apo dhunë. Të gjithë jemi thirrur të ndërtojmë ura, jo mure. Të mbjellim shpresë, jo frikë. Dhe të flasim për të vërtetën, jo ta fshehim atë.

Srebrenica nuk është më vetëm një emër në hartë – ajo është plagë. Plagë e hapur në ndërgjegjen njerëzore, plagë që flet dhe që s’duhet të mbyllet pa drejtësi.

Zoti i mëshiroftë viktimat e Srebrenicës!

Fatiha për viktimat e gjenocidit në Srebrenicë!

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, më 8 korrik 2025

Forca e moralit në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë

Isa Tërshani

Morali është një nga shtyllat themelore mbi të cilat mbështetet jeta e individit dhe e shoqërisë. Ai përfaqëson vlerat, normat dhe parimet që e udhëheqin sjelljen e individëve në një shoqëri.

Etika ose morali është shkenca që studion kuptimin e të mirës dhe të ligës, qartëson se si duhet të trajtojnë njerëzit njëri-tjetrin, e sqaron edhe synimin që duhet ta kenë njerëzit me anë të veprave të tyre, pra është shkencë që ua ndriçon atyre rrugën për të vepruar si duhet. S'ka dyshim se vlerat morale janë shtyllat kryesore të ruajtjes së strukturës së popujve, dhe për këtë arsye vërejmë studiuesit dhe filozofët që janë pajtuar me domosdoshmërinë e këtyre vlerave për individin që ai të jetë i dobishëm së pari për vetveten, por edhe për shoqërinë në përgjithësi. Andaj ashtu si një individ që i bën dëm vetvetes me vepra të këqija, ai po ashtu e prish edhe shoqërinë duke përhapur amoralitet dhe vepra të dëmshme shoqërore.

Në thelb, morali ndihmon në krijimin e marrëdhënieve të ndershme dhe të drejta midis njerëzve. Kur individët sillen me ndershmëri, drejtësi, përgjegjësi dhe respekt ndaj njëri-tjetrit, lind besimi shoqëror, një shtyllë kyçe për unitetin dhe stabilitetin e çdo shoqërie. Shoqëritë që kultivojnë moralin

kanë më pak konflikte, më shumë bashkëpunim dhe më tepër ndjeshmëri ndaj problemeve të përbashkëta. Për këtë arsye nuk e kishte ekzagjeruar Rene de Chateaubriand kur kishte deklaruar: “Morali është themeli i çdo shoqërie”.¹

Një nga qëllimet kryesore të dërgimit të pejgamberëve ka qenë thirrja në virtyte të larta dhe përmirësimi i sjelljes së njerëzve. Kurani e ka përforcuar kërkesën për t'iu përmbajtur atyre virtyteve. Kështu që në fenë tonë islame, më shumë se çdo gjë tjetër, përparësi u jepet vlerave. Njerëzit vlerësohen për vlerat dhe virtytet që kanë, e jo pse janë të bardhë a të zi, flasin këtë apo atë gjuhë, i përkasin kësaj apo asaj shtrese.

NJERIU, QENIE SHOQËRORE

Njeriu, edhe pse është krijesa më e çmuar e Zotit xh.sh., përveç të tjerash, është edhe qenie shoqërore dhe si i tillë është i detyruar të jetojë në familje apo në bashkësi, që do të thotë se njeriu nga vetë natyra e tij është i krijuar të jetojë me të tjerët. Vetë jeta në bashkësi kërkon kushte dhe rregulla të cilat duhet t'i respektojë çdo individ me qëllim të arritjes së harmonisë në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Mirëpo nuk ka bashkësi të shëndoshë nëse nuk ka individ të shëndoshë, ndërsa nuk ka individ të

Morali përfaqëson vlerat, normat dhe parimet që udhëheqin sjelljen e individëve dhe ndërtojnë themelet e bashkëjetesës njerëzore.



shëndoshë pa moral. Pra, normat e moralit janë ato të cilat dirigjojnë sjelljet e përgjithshme të njeriut në bashkësi. Bazë e normave të moralit është feja, për arsye se ato nuk mund të respektohen nëse nuk burojnë nga ndonjë ligj i shenjtë, siç është Sheriati.

Të njeriu si individ ekzistojnë dy lloj prirje: të larta dhe të ulëta, (shpirtërore dhe emocionale), ato të lartat duhet zhvilluar, ndërsa të ulëtat (epshet) duhet kontrolluar-sunduar. Në grupin e emocioneve të ulëta bie, për shembull, emocioni i egoizmit. Ky emocion mund të kontrollohet vetëm nëpërmjet prirjes më të lartë dhe më të fortë, e cila lidhet me bindjen e vetëdijshme se njeriu i takon botës më të lartë, të cilës duhet gjithçka t'i nënshtrohet. Pa këtë bindje të njeriut do të ishte vështirë për t'u respektuar ndonjë ligj apo rregull, bile edhe atëherë kur ato rregulla janë kundër interesave personale të tij. Këtë e bënë vetëm besimi në Krijuesin-feja. Mu për këtë, me plotë të drejtë dijetari i njohur Lajbincse thotë se: "Patjetër të besojmë që moralisht të jetojmë", ose siç thotë Gëte: "Epokat e zhvillimit dhe ngritjeve të fuqishme kanë qenë gjithmonë edhe epokat e besimit të fuqishëm". Këtë shumë shekuj para tyre e ka thënë edhe vetë Platoni, i cili midis të tjerash thotë: "Kush shkatërron dhe sulmon fenë, ai ka shkatërruar moralin".² Pra, morali është fundament më se i nevojshëm për jetën e çdo individ apo bashkësie, prandaj pa moral nuk mund të paramendohet jeta e njeriut dhe e bashkësisë. Nga kjo që u tha kuptojmë se morali është pjesë e pandashme e njeriut dhe si i tillë është i vjetër aq sa edhe vetë njeriu. Gjithmonë në histori fati i njerëzve është varur nga niveli i moralit të tyre, që do të thotë se bazë dhe kusht për jetë të lumtur në këtë botë është respektimi i normave morale.

SHOQËRIA E VIRTYTIT DHE MORALIT

Kur njerëzit udhëhiqen nga porositë hyjnore, si: ndershmëria, drejtësia, butësia dhe respekti, shoqëria funksionon në harmoni. Kurse mosrespektimi dhe mungesa e moralit sjellë padrejtësi, përçarje, korrupsion dhe dhunë. Islami nxit të gjithë njerëzit të sillen me etikë të lartë, jo vetëm ndaj myslimanëve, por edhe ndaj çdo krijese të Zotit. Andaj, kushdo që e studion shoqërinë e vërtetë myslimane dhe karakteristikat e saj dhe mendon për vlerat dhe moralin që është shumë i përhapur tek anëtarët e saj, do të shohë se kjo është shoqëri e dalluar nga shoqëritë e tjera njerëzore. Kjo është një shoqëri në të cilën, standardet fisnike dhe sjellja e mirë e përbëjnë pjesën më të rëndësishme të saj.

Nëse fillojmë t'i përmendim virtytet dhe vlerat morale, si: drejtësinë, mirësinë, mëshirën, sinqeritetin, ndershmërinë, bujarinë, dëlirësinë, pastërtinë, sakrificën, jo egoizmin dhe vlerat e tjera sublime dhe moralet e mëdha me të cilat njihet shoqëria myslimane ne nuk do të mund t'i përmendim të gjitha. Këto vlera morale nuk janë thjesht të mira shoqërore me të cilat shoqëria myslimane krenohet dhe mburret para shoqërive të tjera, por ato janë çështje të fesë për të cilat çdo anëtar i shoqërisë do të merret në llogari nëse bëhet neglizhencë ndaj tyre.³

Shoqëria myslimane dallohet me moralin e saj. Në këtë shoqëri standardet morale dominojnë të gjitha çështjet dhe i japin asaj karakterin e dalluar, qoftë në fushën e shkencës, politikës, artit, luftës ose paqes. Nuk ka ndarje në mes të këtyre gjërave dhe moralit, sepse Sheriati islam erdhi për t'i plotësuar këto vlera fisnike. Muhamedi a.s. ka theksuar vazhdimisht se qëllimi i misionit të tij është përmirësimi i moralit të njerëzve, siç thuhet në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejre r.a.: "Nuk jam dërguar për tjetër përpos për t'ua përsosur moralin".⁴

Virtytet e moralit janë porosi e fesë dhe në të njëjtën kohë ato bazohen në fe, dhe morali që bazohet në fe, i vetmi meriton të quhet moral i vërtetë. Parashtrohet pyetja, pse morali bazohet në fe dhe pse morali i tillë është më i shëndoshë dhe më i përsosur? Këtë e vërtetojnë shumë argumente, por më kryesore mund të jenë këto që do t'i përmendim në vijim.

-Morali që bazohet në fe është më i shëndoshë, sepse kur njeriu beson, jeton me vetëdije se atë e mbikëqyrë Allahu xh.sh., i Cili di, sheh dhe kontrollon çdo vepër të tij, qoftë ajo e fshehtë apo e hapur. Ai mund të fshihet nga të tjerët, por jo edhe nga Zoti Fuqiplotë. Ai mund t'i mashtrojë njerëzit, por jo edhe Allahun xh.sh..

-Besimtari beson në këtë botë edhe në botën tjetër. Besimi në botën tjetër-Ahiret, e bën njeriun më të moralshëm se kurdoherë, për arsye se ai një ditë do të vdesë, pastaj do të ringjallet dhe padyshim që do të japë llogari për veprat e bëra

dhe do t'i jepet shpërblimi vetëm në bazë të asaj që e ka merituar. Pra, frika që të mos dënohet për veprat e këqija si dhe dëshira për t'u shpërblyer, janë thellë të vendosura në zemrën e besimtarit dhe bën që ai gjithmonë të sillet në bazë të normave morale, qoftë në vetmi ku nuk e sheh askush, qoftë edhe haptazi.

FETARIA DHE VIRTYTET

Fetaria e vërtetë nuk është pretendim, por praktikë. Të qenit në pedestalin e besimtarëve më të mirë, nënkupton që duhet të dallohesh jo vetëm me përkushtimin për adhurime, por edhe për vlerat dhe virtytet. Kjo për faktin se këto të fundit janë fryt dhe produkt i adhurimeve, prandaj personaliteti i besimtarit vlerësohet sipas tyre. Virtytet morale tregojnë për nivelin e fetarisë dhe për pozitën që besimtari ka tek Allahu i Madhëruar.⁵ Muhamedi a.s., është shëmbëlltyrë, dhe na porosinë për vlerat morale duke na thënë: “Më i miri prej jush është ai që e ka moralin më të mirë.”⁶ Si dhe: “Robi më i dashur për Allahun është ai me moralin më të mirë.”;⁷ “Besimtari më i përsosur në besim është ai që ka moralin më të mirë.”⁸

Këto hadithe tregojnë qartë se morali nuk është diçka dytësore në Islam, por është thelbësorë për të qenë një mysliman i vërtetë dhe për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe të begatë. Pra, nga kjo mund të konkludojmë se nuk ka moral pa besim dhe as besim pa moral. Mu për këtë morali është pjesë e pandashme e fesë dhe ai që ka fe ka edhe moral. Mirëpo, fatkeqësisht, ka njerëz të cilët besojnë, por janë pak të moralshëm. Kjo është rezultat i mosbindjes dhe besimit të dobët. Sa më e fortë është bindja e njeriut në ekzistimin e Zotit xh.sh., aq më tepër rritet dhe forcohet moralisht njeriu.

ETIKA DHE ROLI I SAJ

Etika islame është pjesë thelbësore e fesë, e cila përfshin parimet morale dhe sjelljet e drejta që një mysliman duhet të ndjekë në jetën e përditshme. Ajo është e ndërtuar mbi mësimet e Kuranit dhe Sunetin e Muhamedit a.s.. Rolin e etikës islame e ka paraparë edhe enciklopedisti i njohur Volteri, i cili ka thënë: “Edhe sikur të mos ekzistojë, Zotin duhet ta paramendojmë”. “Vërtet roli i Zotit dhe jetës tjetër është shumë i madh, për shkak se këto dyja janë themele të platformës së moralit.”⁹ Gjithashtu do ta përmendim edhe fjalën e dr. Gustav Le Bon, kur thotë: “Vërtet bazat e moralit në Kuran janë aq të larta e sublime sa që ato janë lartësia e të gjitha vlerave morale që theksohen në të gjitha fetë tjera së bashku”. Kjo dëshmi e dr. Gustav Le Bon-it për vlerat morale në Islam ka domethënien e vet shkencore, ngase një gjë të tillë nuk ia

“Nuk jam dërguar për tjetër përpos për t'ua përsosur moralin”.

(Muhamedi a.s.)

ka dedikuar atij dashuria për principin ose urrejtja për tjetrin, por është një dëshmi për të vërtetën, dhe është kryerje e misionit shkencor të cilin ai i shërben. Vërtet fjala e tij është thënë vetëm pasi ai e ka studiuar Kuranin dhe është informuar me vlerat morale që gjinden në të. Dihet mirëfilli se dr. Gustav Le Bon i ka studiuar fetë dhe ai është argument ose referencë e qëndrueshme në sociologji, andaj dëshmia e tij ka vlerë të madhe në këtë fushë.¹⁰

GJËRAT E NDALUARA NË SHOQËRINË E VIRTYTIT DHE MORALIT

Është e natyrshme që shoqëria me virtyte të larta morale si shoqëria myslimane t'i ndalojë gjërat e këqija dhe karakteristikat e liga si: shtypja, tradhtia, gënjeshtria, mashtrimi, imoraliteti, pirja e alkoolit, bixhozi, shthurja morale, kamata, mos respekti ndaj prindërve, prishja e lidhjeve farefisnore, tallja me të tjerët, thirrja e njerëzve me nofka ofenduese, ngjallja e dyshimeve për ta dhe karakteristika tjera të këqija që instiktivisht të neveritin. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: “O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke e nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë. O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut, e Allahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin.”¹¹

Muhamedi a.s., është cilësuar nga Vetë Zoti Fuqiplotë me virtyte të larta, ku në Kuran thotë: “Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!”¹² si dhe “Mëshirë për të gjitha krijesat.”¹³ Ai na mëson për një qëndrim etik përtej mundësive të ndërsjella: vizitën e atij që s'të viziton, dhënien atij që s'të jep, faljen e tiranit, pra mëshirën në çdo rrethanë e kontekst. I Dërguari i Allahut synonte t'i largonte shokët e vet nga mënyra egoiste e jetesës, që mendon vetëm për rehatinë vetjake. Besimtarët nuk duhet që jetën e tyre ta sistemojnë në bazë të formulës: “Si mund të jetojë i qetë”, por sipas formulës tjetër, “si mund t'i bëj njerëzit të jetojnë të qetë”. Për besimtarin preokupimi me nevojat e vëllait besimtar, të qenët me të në ditët e telasheve, duhet të shndërrohet në mënyrë jetese. Sahabiu Bera ibën Azibi r.a., thotë se Pejgamberi a.s., ua



kishte mësuar shtatë gjëra: “Të vizitojmë të sëmurin, të përcjellim xhenazen, të lutemi për atë që teshtin, t’i ndihmojmë të dobët, t’i ndihmojmë atij që i bëhet padrejtësi, ta përhapim selamin, dhe ta përmbushim atë për të cilën dikush na është betuar.”¹⁴ Muhamedi a.s., i edukonte shokët e vet duke treguar praktikisht se sa i ndjeshëm ishte në edukimin konform kërkesave të jetës shoqërore. Sipas etikës pejgamberike, besimtarët e fuqishëm duhet të jenë në shërbim të të pafuqishmëve. Ai na ka treguar për vlerën e atyre që janë në shërbim të njerëzve duke thënë: “Ai që kujdeset për të venë dhe për nevojtarin është sikur ai që lufton në rrugën e Allahut, ose sikurse ai që falet natën dhe agjëron ditën.”¹⁵

Jeta shoqërore, njeriut bashkë me të drejtat i sjellë edhe përgjegjësi të ndryshme. Për këtë arsye njeriu duhet që po aq sa vetën të marrë parasysh edhe të tjerët, duhet të jetë i vetëdijshëm për kufijtë e vetë, duhet që në kontekstin shoqëror të veprojë sipas këtyre parametrave. Pejgamberi a.s., këtë ndjenjë të përgjegjësisë e ka shprehur përmes hadithit të anijes që përfaqëson shtresat e ndryshme shoqërore. Pra, një pjesë e udhëtarëve të anijes kanë fituar të drejtën të udhëtojnë duke qenë në pjesën e sipërme, e disa në atë të poshtme. Ata që janë në katin e poshtëm, meqë kanë nevojë për ujë, duke mos dashur të mos i shqetësojnë këta të katit të sipërm, hapin një vrimë në pjesën e poshtme të anijes. Dhe nëse këta të katit të dytë i lënë që të bëjnë atë që duan, të gjithë udhëtarët pa

dallim do të fundosen. Por, nëse e pengojnë aksionin e shpimit të anijes, i shpëtojnë edhe ata që duan të bëjnë dëmin dhe veten.¹⁶ Pejgamberi a.s., përmes këtij hadithi,¹⁷ në mënyrë shumë lakonike (të prerë) ka përshkruar proceset dhe shtresat shoqërore.

Anija tregon familjen, lagjen, katundin, qytezën, qytetin, shtetin dhe në kuptimin më të gjerë botën. Me shprehjen “ata të katit të sipërm”, nënkuptohen udhëheqësit, të pasurit, punëdhënësit, të fuqishmit dhe zotëruesit e dijes, kurse me sintagmën “ata të kati të parë”, nënkuptohen njerëzit që udhëhiqen nga të tjerët, të varfrit, punëtorët, të papunët, të pafuqishmit ose injorantët. Vrima e hapur në anije nënkupton veprimet që ndikojnë negativisht në jetën shoqërore, si: vjedhja, korrupsioni, ryshfeti dhe çdo gjë tjetër jo legjitime. Allahu xh.sh., i ka ngarkuar myslimanët të ndërtojnë një “shoqëri shembullore”, të vetëdijshme për përgjegjësitë e veta, prandaj në Kuranin famëlartë thotë: “*Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun...*”¹⁸

PËRFUNDIMI

Nga kjo që u tha mund të kuptojmë se një shoqëri e shëndoshë nuk ndërtohet vetëm mbi zhvillimin ekonomik apo fuqinë ushtarake, por mbi themelet e moralit dhe drejtësisë. Morali është ai që lidhë zemrat, ngjallë besim dhe krijon siguri dhe dashuri në marrëdhëniet shoqërore. Nëse çdo individ përpiqet të ndjekë moralin e porositur nga Kurani dhe Suneti i Muhamedit a.s., atëherë shoqëria do të lulëzojë në paqe, drejtësi dhe mirëqenie. Zoti na ndihmoftë në formimin e një shoqërie të tillë! Amin!

- 1 Afif Abdul Fet-tah Tabbareh, *Shpirti i fesë Islame*, Përktheu dhe përshtati nga arabishtja, Mr. Driton Arifi, Prishtinë, 2020, f. 276.
- 2 Shaqir Fetahu, *Feja fenomen i vërtetë*, Shkup, 1997, f. 74.
- 3 Dr. Muhammed Ali el Hashimi, *Shoqëria ideale*, Prishtinë, 2009, f. 401.
- 4 Muhamed Nasirud dijn el Albani, *El Xhamiu Es Sagjir ve zijadetu*, I. Botimi i tretë, Bejrut, 1988, H. 2833.
- 5 Sedat Islami, Takvim, 1446-1447. Kalendar, 2025. Prishtinë, *Veprat dhe vërtetë e njerëzve të mirë*, f. 112.
- 6 Sahihu i Buhariut, 3. Harfi, Prishtinë, 2024. Buhariu, 3559.
- 7 Sahih el Xhami, nr. 179.
- 8 Tirmidhiu, 1162.
- 9 Shaqir Fetahu, *Feja fenomen i vërtetë*, Shkup, 1997. f. 78.
- 10 Afif Abdul Fet-tah Tabbareh. *Shpirti i fesë islame*, Përktheu dhe përshtati nga arabishtja, Mr. Driton Arifi, Prishtinë, 2020, f. 277.
- 11 El Huxhurat, 11-12.
- 12 El Kalem, 4.
- 13 El Enbija, 107.
- 14 Buhariu, 6235.
- 15 Buhariu, 5353.
- 16 Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, Islami nëpërmjet haditheve, 4, f. 314.
- 17 Buhariu, 2493.
- 18 Ali Imran, 110.



Myslimanët në Perëndim në mes ruajtjes së identitetit dhe tëhuajësimit

Dr. Bashkim Aliu

HYRJJE

Myslimanët dhe popujt evropianë, nuk janë të pa njohur për njëri-tjetrin, edhe atë, qoftë ata të Evropës Lindore apo të Evropës Perëndimore. Myslimanët dhe evropianët, përgjatë historisë, kanë pasur takime direkte dhe indirekte, dhe takimet e tyre të para kanë ndodhur në tokën evropiane. Marrë parasysh se takimet dhe prezenca e myslimanëve në Evropën Lindore është një kapitull i rëndësishëm në vetë, ngase kemi të bëjmë me popullatë evropiane lindore autoktone, e cila ka kaluar në Islam, dhe për rrjedhojë kemi edhe myslimanë autokton, qasja jonë u referohet myslimanëve të Evropës Perëndimore.

Takimin e myslimanëve me popujt evropianë në Evropën Perëndimore, mund ta ndajmë në dy faza kryesore:

Faza e parë: Para shekullit XX. (Disa shekuj më parë – kur myslimanët erdhën në vendet e Evropës Perëndimore si tregtarë dhe përmes ekspeditave ushtarake; luftërat e kryqëzatave; shtrirja e shtetit osman në Evropë; kolonizimi i vendeve myslimane nga ana e shteteve evropiane. Nuk duhet harruar edhe lidhjet tregtare që kanë ekzistuar më herët, si dhe marrëdhëniet diplomatike të kalifëve myslimanë dhe mbretërve evropianë.) Në fakt, myslimanët dhe evropianoperëndimorët u takuan me rastin e çlirimit myslimanë të

Në fakt,
myslimanët
dhe
evropiano-
perëndimorët
u takuan me
rastin e
çlirimit
myslimanë të
Afrikës
Veriore,
depërtimit të
myslimanëve
ne Spanjë,
Sicili, nga
njëra anë, dhe
më pas edhe
gjatë luftërave
të kryqëzatave.

Afrikës Veriore, depërtimit të myslimanëve ne Spanjë, Sicili, nga njëra anë, dhe më pas edhe gjatë luftërave të kryqëzatave (Silajdzič, 2015:59).

Faza e dytë: Prej shekullit XX, gjegjësisht në gjysmën e dytë të shekullit XX, pas Luftës së Dytë Botërore (kur myslimanët arrijnë në Evropë, kryesisht si punëtorë krahë, e në numër më të vogël edhe si të përndjekur politik dhe studentë.)

RRUGA E INTEGRIMIT

Myslimanët, në rrugëtimin e tyre jetësor në Perëndim, ballafaqohen me sfida, por gjenden edhe para shumë mundësive. Të dy këto elemente kanë bërë që ata të gjenden ndërmjet dy dukurive: përpjekjes për ta ruajtur identitetin e tyre fetar dhe kulturor, si dhe tëhuajësimit, i cili përfundon me asimilim. Mbase asnjëra nuk imponohet si rrugë e vetme e ekzistimit të komunitetit mysliman në Perëndim, ngase është i mundur ndërtimi i një modeli të suksesshëm, i cili do të karakterizohej nga inkluziviteti shoqëror dhe përkushtimi fetar, gjegjësisht do të specifikohet nga përkushtimi i komunitetit mysliman që të jenë qytetarë aktivë në shoqëritë ku jetojnë, duke qenë besimtarë të përkushtuar në fenë e tyre. Në këtë mënyrë, përmes vetëdijes, edukimit dhe angazhimit të ndërsjellë, ata mund të bëhen shembull i ndërtimit të urave lidhëse mes kulturave, si dhe model i



suksesshëm i koekzistencës dhe bashkëjetesës paqësore në shoqëritë multikulturore dhe multireligjioze, si dhe në një botë gjithnjë e më të ndërruar. Shikuar në këtë dioptri, sfidave nuk duhet qasur si barriera të pakapërcyeshme, por si mundësi për të jetuar në shoqëritë multikulturore si myslimanë me identitet të etabluar fetar dhe qytetar.

NË EVROPË, KRYESISHT KA DY MODELE TË INTEGRIMIT:

Modeli anglez. Ky model është më tepër multikulturore për atë se pranon që ndonjëri t'i përmbahet një kulture që dallon nga ajo vendore, nëse i respekton ligjet vendore (Roy, 2004: 66; Caldwell, 2009: 123).

Modeli francez. Ky model thërret në integrim përmes asimilimit. Modeli francez kërkon që emigrantët të jenë francezë në lojalitetin e tyre kulturor (Caldwell, 2009: 123). Ky model bazohet në parimet laike të sekularizmit dhe asimilimit. Ky model beson në shoqëri homogjene, ndërkaq e përjashton multikulturalizmin (Laquer, 2009: 50).

Modeli më i mirë për shoqëritë multikulturore, kur janë në pyetje bashkësitë fetare, është modeli i integritimit, e jo modeli i asimilimit. Integrimi paraqet pasuri kulturore për shoqërinë multikulturore, e ndryshe është rëndë të jetë, për shkak se mjetet bashkëkohore të komunikimit, i afrojnë anëtarët e një bashkësie. Po ashtu, modeli i integritimit është tregues se respektohen të gjitha kulturat, përfshirë këtu edhe kulturat e bashkësive minoritare. Kjo kontribuon për fitimin e lojalitetit të pjesëtarëve të bashkësive minoritare dhe për nxitjen e tyre për participim të gjerë në shoqëri. Kësaj i shtohet edhe fakti se në shoqëritë multikulturore, ndryshimet nuk mund të

mos përfillen dhe as të eliminohen plotësisht nga realiteti. Nga ana tjetër, asimilimi si model për shoqëritë multikulturore, nuk është model adekuat, për shkak se njerëzit nuk janë të gatshëm që me lehtësi t'i braktisin kulturat e tyre, të cilat janë të rrënjësura thellë në jetën e tyre, e shumë prej tyre janë të lidhura ngushtë edhe me religjionin. Po ashtu, siç nënvizon edhe Bikhu Parekh, në modelin asimilues, zgjedhja e pakicave është e thjeshtë: Nëse duan që të bëhen pjesë e shoqërisë dhe të jenë të barabartë me të gjithë qytetarët e tjerë, duhet të asimilohen. Por, kjo shkallë e asimilimit nuk është e nevojshme për t'u siguruar uniteti politik i kombit, gjegjësisht të shtetit, të cilin mbështetësit e asimilimit e marrin si ideal të tyre, dhe as që kjo shkallë është parakusht për qytetari të barabartë (Parekh, 2000: 197).

NDËRMJET INTEGRIMIT DHE ASIMILIMIT

Integrimi është proces i cili dallon nga asimilimi. Integrimi nënkupton afrim në mes individëve dhe bashkësive, pa u dëmtuar identiteti personal dhe karakteristikat kulturore. Ndërkaq, asimilimi është proces i humbjes së identitetit personal dhe karakteristikave kulturore, si dhe shkrirje në një identitet tjetër. Zgjidhja nuk qëndron as në izolim, as në asimilim, por në një formë të integritimit të ndërgjegjshëm, që nuk e sakrifikon thelbin fetar. Studiues si Tariq Modood (2013), theksojnë rëndësinë e një modeli multikulturore, ku identitetet nuk kërkohet të zbehen, por të bashkëjetojnë.

Megjithatë, dallimi ndërmjet këtyre dy proceseve nuk kuptohet në këtë mënyrë nga të gjitha palët brenda komunitetit mysliman. Kështu, disa rryma myslimane, të cilat Roj i quan neofundamentaliste (Roj, 2004: 152),

integrimin e shohin si hyrje në asimilimin e komunitetit. Për ta, është e pa imagjinueshme që t'i qaset procesit të integritimit, pa përfunduar me asimilim, për shkak se nuk mund të flitet për integrim pa u bërë lëshime në disa elemente të cilat lidhen me identitetin (Ravi, 2011: 1, 17). Si rezultat i kuptimit të këtillë të procesit të integritimit, ata zhvillojnë një politikë izoluese për komunitetin mysliman, dhe këtë e shohin si garant për mbrojtjen e identitetit të tij fetar. Ata shkojnë edhe më tutje dhe sugjerojnë se nga aspekti fetar, për myslimanin është e ndaluar të ketë shtetësi të një shteti të huaj jomysliman, për shkak se kjo është rrezik potencial që myslimani i tillë të asimilohet në bashkësinë shumicë, dhe në këtë mënyrë të mos mund t'i plotësojë obligimet e tij fetare (Kardavi, 2007: 199; El Xhudaj'i, 2007: 148; Roj, 2004: 158).

Qëndrimi i këtillë është i ndërtuar mbi një hipotezë të pavërtetuar se integrimi është asimilim i identitetit personal dhe vlerave kulturore personale. Për këtë, pjesa më e madhe e mendimtarëve myslimanë dhe rrymave moderne në komunitetin mysliman, në veçanti ata të cilët jetojnë në Evropë, ose ata të cilët merren me problemet e komuniteteve myslimane në Perëndim, kanë qëndrim të ndryshëm. Sipas Jusuf el Kardavit, myslimanët duhet ta ruajnë identitetin e tyre, pa u izoluar nga tjerët, dhe duhet të jenë të hapur ndaj tjerëve, pa u asimiluar (Kardavi, 2007: 201). Po ashtu, edhe Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, u rekomandon myslimanëve të cilët jetojnë në Perëndim që të jenë komunitet aktiv dhe efektiv, i cili do t'i plotësojë detyrat e veta, t'u shërbejnë shoqërive të veta, të mos izolohehen dhe të mos tërhiqen prej shoqërive të veta, por të integrohen në shoqërinë evropiane me atë që do ta ruajnë identitetin e vet, pa u izoluar, dhe do të hapen ndaj tjerëve, pa u shkrirë.¹

PËRMBYLLJE

Zhvillimi i shoqërive të sotme në një botë të globalizuar, ku kërkohen gjithnjë e më shumë forma të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve dhe shoqërive, na jep të drejtën të pohojmë se integrimi përfaqëson një element kyç të të gjitha segmenteve të jetës në një shoqëri, të marrëdhënieve të shoqërive njerëzore me njëra-tjetrën, si dhe të rendit të ri botëror. Kjo është e qartë, kur merret parasysh se proceset integruese përfaqësojnë qëllim strategjik të organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe të politikave qeveritare pothuajse në të gjitha shtetet e botës.

Komuniteti mysliman në Perëndim sot nuk është ai që ishte në fillim të shpërnguljes. Që nga ajo kohë e deri më sot kanë ndodhur ndryshime të mëdha. Është ndryshuar statusi juridik i myslimanëve, pra sot ata nuk janë më vetëm punëtorë të përkohshëm, por janë qytetarë që kanë të drejtë qëndrimi të pakufizuar dhe shumë prej tyre kanë fituar edhe shtetësinë. Sot ata nuk janë më punëtorë të përkohshëm që jetojnë larg familjeve të tyre dhe punojnë për të fituar para

dhe pastaj të kthehen në vendet e tyre. Sot ata jetojnë në Evropë me familjet e tyre, i arsimojnë fëmijët e tyre në vendet evropiane. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, Evropa është bërë vendlindje e gjeneratës së dytë dhe të tretë të emigrantëve myslimanë në vendet evropiane, dhe me këtë është ndryshuar edhe qëndrimi i myslimanëve ndaj jetës së tyre në Evropë dhe të ardhmes së tyre. Ata tani nuk e shohin më veten vetëm si punëtorë të përkohshëm që janë këtu për të fituar para dhe për t'u kthyer në vendet e tyre të lindjes, por tashmë mendojnë për çështje shumë më thelbësore që kanë të bëjnë me fëmijët e tyre, me familjet e tyre si dhe me komunitetin e tyre – pra, ata mendojnë për integrimin e tyre në shoqëritë evropiane, sepse komuniteti mysliman sot përbëhet nga gjenerata të reja të lindura në Evropë, të cilat janë me besim islam, por me mentalitet evropian.

Ky realitet kërkon ndryshime thelbësore në mënyrën e të menduarit për identitetin, kulturën, përkatësinë fetare dhe përgjegjësinë shoqërore të komunitetit mysliman. Prandaj, sot flitet për një profil të ri të myslimanit në Perëndim – një “mysliman evropian”, i cili do të integrohet në shoqërinë evropiane në të gjitha fushat e saj.

Proceset integruese sot, përveç që kanë ndikim pozitiv në komunikimin ndërnjerëzor dhe në arritjen e mirëqenies në shoqëri, kanë ndikim edhe në shumë misione të tjera të rëndësishme me karakter ndërkombëtar, siç janë: paqja globale, të drejtat universale të njeriut, dialogu ndërmjet civilizimeve, etj..

LITERATURA:

- CALDWELL, Christopher. 2009. *Reflections on the Revolution in Europe*. London: Penguin Books Ltd.
- KARDAVI, Jusuf. (2007). *Ad-Din dhe es-Sijasa (Feja dhe politika)*. Dublin: Këshilli Evropian për Fetva dhe Kërkime.
- LAQUEUR, Walter. 2007. *The Last Days of Europe*. New York: St.Martin's Press.
- MODOOD, T. (2013). *Multiculturalism: A Civic Idea* (2nd ed.). Polity Press.
- PAREKH, Bhikhu. 2000. *Rethinking Multiculturalism: Cultural Diversity and Political Theory*. Cambridge, Massachusetts: Harvard University Press.
- RAMADAN, T. (2004). *Western Muslims and the Future of Islam*. Oxford University Press.
- RAVI, Ahmed. (2011). “Drejt një vizioni më të thellë për problemin e integritimit.” Botimi i parë. Seria “Horizontet Evropiane” 1. Bruksel: Federata e Organizatave Islame në Evropë.
- ROY, Olivier. 2004. *Globalizimi i Islamit*. Tiranë: IDK.
- SILAJDŽIĆ, Adnan. (2015). *Islami në zbulimin e Evropës krishtere-historia e dialogut ndër-religjioz*. Shqipëroi: Behxhet Jashari. Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A.
- EL-XHUDAJ'I, Abdullah bin Jusuf. (2007). *Ndarja e botës në të drejtën islame*. Dublin: Këshilli Evropian për Fetva dhe Kërkime.

1 Shih rekomandimet e Këshillit Evropian për Fetva dhe Gjurmime në: El Maxhal-la el ilmijja li el Maxhlis el urubij lil ifta ve-l-buhuth, (Dublin-Irlandë), nr. X-XI, maj (2007), f.313-316.

Sahabët – hallka e parë në themelimin e medhhebit hanefi

Dr. Muhamed Stublla

Zinxhiri i transmetimit përmes hallkave të pandërprera në fenë islame ka qenë dhe do të mbetet një veçori dalluese e shpalljes së fundit. Zoti xh.sh. zgjodhi më të dashurit e Tij për ta transmetuar këtë fe. Nga melaqet, zgjodhi Xhibrilin a.s. për të përcjellë mesazhin hyjnor te njerëzimi, e ky i fundit te më të zgjedhurit e njerëzimit, pejgamberët e Zotit xh.sh.. Me dëshirën dhe vullnetin e Zotit, pejgamberi më i dashur dhe më i zgjedhur për nga aspekti i nderimit të tij, por edhe për nga përgjegjësia, ishte Muhamed Mustafaja a.s.. Rugën e tij do ta përfaqësonin më të dashurit dhe më të diturit e misionit të tij, të cilët, përgjatë historisë, u quajtën dijetarë. Pra, dijetarët janë trashëgimtarët e pejgamberëve, në përgjegjësi, kompetencë dhe në të drejtën për ta interpretuar Islamin. Edhe shokët e Muhamedit a.s. nuk ishin të gjithë në të njëjtin nivel të dijes. Vetë Pejgamberi Muhamed a.s. kishte vlerësuar disa prej tyre në fusha të caktuara, dikë e kishte zgjedhur për ezanin, dikush ishte i veçantë në leximin dhe mësimin e Kuranit, tjetri ishte i besuar për ruajtjen e sekreteve të tij, dikush ishte ekspert i trashëgimisë, një tjetër ishte i dalluar në gjykim, e disa të tjerë në fusha të ndryshme. Sahabët janë hallka e parë, të cilët jetuan me Muhamedin a.s., e besuan, mësuan, mbrojtën dhe bartën mbi supe Islamin, duke e përcjellë atë te gjeneratat pasuese. Ata mësuan Islamin

Sahabët që bartën Islamin në Kufe ishin pikërisht ata që themeluan logjikën interpretuese të mësimave të Muhamedit a.s., e cila, në të ardhmen, do të merrte formë juridike dhe do të njihej si medhhebi hanefi.

drejtpërdrejt nga duart e Muhamedit a.s., ishin dëshmitarë të zbritjes së Kuranit, dhe njihnin më mirë se kushdo shkaqet e zbritjes dhe kuptimin e tij. Sahabët ishin jashtëzakonisht të kujdesshëm në bartjen e haditheve dhe të Islamit në përgjithësi. Pasimi i tyre mbetet mënyra më e saktë dhe gjithëpërfshirëse për të ndjekur Muhamedin a.s., jo vetëm në transmetimin e shprehjeve, por edhe në konceptin e kuptimit të shëmbëlltyrës së tij.

Numri i sahabëve-shoqëruesve të Muhamedit a.s., ishte 114.000.¹ Prej tyre, shtatë janë shumë të njohur në dituri e dhënie të fetfave, njëzet të tjerë janë relativisht të njohur. Ndërsa rreth 100 të tjerë kanë dhënë shumë pak opinione juridike, prandaj janë gjithashtu pak të njohur.² Ibrahim i en Nehaiu r.a., ka thënë: “Në Kufe kanë ardhur shtatëdhjetë (70) prej sahabëve që morën pjesë në luftën e Bedrit dhe treqind (300) që ishin pjesëmarrës në besëlidhjen e Err Rudvanit – nën pemë.”³ Numri i përgjithshëm i sahabëve që e vizituan apo jetuan në Kufe ishte rreth 1500.⁴

Sahabët që bartën Islamin në Kufe ishin pikërisht ata që themeluan logjikën interpretuese të mësimave të Muhamedit a.s., e cila, në të ardhmen, do të merrte formë juridike dhe do të njihej si medhhebi hanefi. Ky emërtim i atribuohet njërit prej dijetarëve

të shquar dhe shumë të njohur nga tabiinët. Emërtimi i medhhebit me emrin e tij nuk vjen sepse prej tij filloi ky drejtim juridik, por si rezultat i kontributit të tij të jashtëzakonshëm në formësimin shkencor të mësimave që ishin mbledhur nga dijetarët pararendës. Ky kontribut përfshinte aftësinë e tij për të studiuar në thellësi interpretimet dhe mendimet e dijetarëve të mëparshëm, të cilat i verifikonte në një mexhlis apo akademi të përbërë nga dhjetëra kuadro që i ngjanin atij në profesionalizëm. Po ashtu, merrnin pjesë edhe kuadro të specializuar në fusha të ndryshme, të cilët kontribuan në studimet që më pas u dokumentuan apo shkruan dhe u shpërndanë në formë të pakontestuar të saktësisë. Ky dijetar vizionar, strateg në studim dhe organizim, ishte Imam Ebu Hanife, emri i vërtetë i të cilit ishte Numan bin Thabit r.a..

Nga shumë sahabë që përbënin hallkën e pandashme me Muhamedin a.s. në Kufe, veçojmë:

Abdullah ibën Mesudi r.a., i cili ishte i deleguar nga udhëheqësi i besimtarëve, Omer ibën el Hatabi r.a., me qëllim që t'ua mësonte Islamin banorëve të Kufes.

Ai ishte një jurist i shquar dhe një ndër mendjet më të ndritura të të gjitha kohërave, prandaj Omeri e zgjodhi ndër të gjithë sahabët për ta përfaqësuar diturinë islame në Kufe. Abdullah ibën Mesudi r.a. ishte ndër sahabët më të afërt të Muhamedit a.s.. Vizitat e tij te Pejgamberi a.s. ishin aq të shpeshta, sa që krijonte përshtypjen se ishte pjesëtar i familjes së tij. Ai kishte mësuar mbi 73 sure drejtpërdrejt nga vetë Muhamedi a.s.,⁵ i cili ka thënë: “Kush dëshiron ta mësojë Kuranin ashtu siç ka zbritur, le ta lexojë sipas leximit të Ibën Mesudit.”⁶ Omeri r.a. nuk lejonte sahabët të largoheshin nga Medina, përveç atyre që ai i caktonte me detyra të veçanta. Ai kishte thënë: “E kam privuar veten nga Abdullah ibën Mesudi dhe ju kam privilegjuar juve me të.”⁷ Imam Mesruku r.a. ka thënë: “Dituria e sahabëve është përmbledhur tek Ibën Mesudi dhe Aliu r.a.” Kurse dijetari i shquar, Imam Esh Shabiu, ka thënë: “Abdullah ibën Mesudi r.a. ishte më i dituri ndër të gjithë shokët e Muhamedit a.s., ishte më i dituri pas Pejgamberit a.s.”⁸ Ky është një vlerësim i lartë dhe një thesar i çmuar për Abdullah ibën Mesudin r.a., por edhe për të gjithë ata që mësuuan dhe e pasuan atë. Abdullah ibën Mesudi r.a. la gjurmë të pashlyera në Kufe. Nga nxënësit e tij dolën rreth gjashtëdhjetë dijetarë, të cilët ishin shoqëruesit dhe bartësit e diturisë së tij.⁹

Ibën Mesudi ishte ndër të parët që e pranuan Islamin. Gjithashtu ishte ndër të parët që transmetuan mësimet e Muhamedit a.s. në Kufe, duke vendosur kështu themelet dhe bazat e mendësisë që më vonë do të njihej si medhhebi hanefi. Në një studim në nivelin master, të realizuar nga Ahmed Muhamed Hasan me titull “Sahabiu Abdullah ibën Mesudi dhe ndikimi i tij në Fikhun Hanefi”, janë analizuar rreth pesëqind (473) mendime juridike të Ibën Mesudit dhe janë



krahasuar me qëndrimet e medhhebit hanefi. Rezultati tregoi se 91%, ose 431 e mendimeve të tij, përputhen ose konsiderohen qëndrime të medhhebit.¹⁰ Kjo përqindje e lartë tregon se themelet e medhhebit hanefi përputhen me fillimet e Islamit. Një përputhje e tillë nuk gjendet as ndërmjet vetë Ebu Hanifes dhe shokëve të tij më të afërt. Ky është një argument i fortë shkencor se bazat e medhhebit hanefi kanë filluar që me Muhamedin a.s., i cili e kishte mësuar personalisht Ibën Mesudin r.a., duke e përgatitur për një të ardhme të ndritur. Për nivelin e lartë të dijes dhe devotshmërisë së Ibën Mesudit kemi një konsensus të gjerë nga vetë Pejgamberi a.s., sahabët e deri më sot. Kjo është vetëm një përmbledhje e shkurtër për figurën e tij të jashtëzakonshme. Por, nuk duhet harruar se shkenca nuk ndërtohet vetëm mbi një njeri, atë e përfaqësojnë edhe shumë personalitete dhe shokë të tjerë të Muhamedit a.s.. Vetë Abdullah ibën Mesudi hiqte dorë nga mendimi i tij personal, nëse ai binte në kundërshtim me mendimin e Omerit r.a..¹¹ Prandaj, me të drejtë thuhet se Omeri r.a. ishte një nga personalitetet më të spikatura që ndikuan në formimin e mendësisë hanefite, pasi referenca kryesore e hanefive është pikërisht Ibën Mesudi r.a., mendimet e të cilit shumë herë përputheshin ose përfshinin mendimet e Omerit r.a.. Për këtë arsye, ka nisur një studim universitar për të krahasuar mendimet e Omerit r.a. me qëndrimet shkencore të medhhebit hanefi, rezultatet fillestare flasin për një përqindje të lartë të përputhshmërisë të tyre. Nëse një sahabi dhe dijetar i nivelit të lartë si Ibën Mesudi e pasonte apo merrte për bazë mendimin e Omerit r.a., atëherë, cili duhet të jetë qëndrimi ynë ndaj pasimit të medhhebit hanefi, i cili përmbledh, përzgjedh dhe sistemon transmetimet dhe mendimet e të gjithë sahabëve, tabiinëve... duke i zhvilluar ato përmes rregullave apo parimeve shkencore? Të



pyesim veten, ku jemi ne me diturinë dhe devotshmërinë e tyre, si mund të kemi guxim për t'i refuzuar e ndoshta edhe sulmuar medhhebet?!

Ali ibën Ebu Talibi r.a., halifa i katërt i myslimanëve, ishte një nga ata për të cilët Pejgamberi Muhamed a.s. na porositi se suneti i tyre është suneti i tij.

Hyri në Islam që në fëmijëri, u rrit dhe u edukua në shtëpinë e Pejgamberit a.s., dhe më pas u martua me vajzën e tij, Fatimen r.a.. Për të, Pejgamberi a.s. kishte thënë: “Aliu është prej meje dhe unë jam prej tij.”¹² Si rezultat i shoqërimit të pandërprerë me Pejgamberin a.s. përgjatë 23 vjetëve të shpalljes, duke qenë dëshmitar i të gjithë procesit të plotësimit të Islamit, Aliu r.a. gëzonte një pozitë të veçantë dhe ishte ndër imamët-muxhtehidët më të dalluar. Shndërrimi i Kufes në kryeqytet të hilafetit i dha një rëndësi të veçantë qytetit, ndërsa prania e Aliut r.a. e ndriçoi atë me diturinë e tij. Atë e shoqëruan edhe shumë sahabë dhe dijetarë të tjerë të shquar. Abdullah ibën Mesudi dhe Aliu r.a. konsiderohen si lidhje e pandashme me Hz. Muhamedin a.s.. Ata nuk ishin thjesht transmetues të haditheve, por përfaqësonin shtyllat ideologjike dhe juridike të mësimave të Pejgamberit a.s.. Dijetari i shquar, Imam Mesruku, ka thënë: “I kam shoqëruar shokët e Muhamedit a.s. dhe kam vërejtur se e gjithë dituria e tyre përmbledhej te gjashtë prej tyre... pasi i shoqërova këta gjashtë, pashë se dituria e tyre përqendrohej tek Aliu dhe Ibën Mesudi r.a.”¹³

Një studim që është realizuar nga Ihab Akur në nivelin master, me titull: “Ndikimi i sahabiut, Alij ibën Ebu Talib r.a., në Fikhun Hanefij”, rezultatet e tij treguan se nga (376) mendime të tij, (89.6%) ose (337) përputhen ose konsiderohen qëndrime të medhhebit hanefi.¹⁴

Pra, studimet mbi mendimet e Ibën Mesudit r.a., tregojnë se: nga (473) mendime të tij, (431) përputhen me qëndrimet

e medhhebit hanefi. Ndërsa nga rreth (376) mendime të Aliut r.a. (337) përputhen me qëndrimet e medhhebit hanefi. Nga kjo rezulton se: nga gjithsej (849) mendime të Ibën Mesudit dhe Aliut r.a., (768) ose (90.3%), përputhen me qëndrimet shkencore të medhhebit hanefi.

Nga këto statistika të studiuara dhe të verifikuara përmes punimeve shkencore, të miratuara nga komisione shkencore universitare, kuptojmë se, themeluesit real të medhhebit hanefi – ose më saktë, të mendësisë dhe rregullave të tij – kanë qenë vetë sahabët, veçanërisht Abdullah ibën Mesudi dhe Ali ibën Ebu Talibi r.a.. Pra, ndikimi i sahabëve në themelimin e mendësisë dhe bazave të medhhebeve juridike aktuale është shumë i rëndësishëm. Nga studimet tona, bazuar në metodologjinë (usulin) e Imam Ebu Hanifes, kuptojmë se ai ka përzgjedhur mendimet e sahabëve dhe nuk ka dhënë mendim të ri për një çështje përderisa ka ekzistuar ndonjë mendim nga sahabët për atë temë.¹⁵ Dëshmi për këtë është fakti se jo të gjitha mendimet e një sahabin janë pranuar në medhheb – që do të thotë se medhhebi ka shqyrtuar dhe përfutur nga të gjithë sahabët, duke vlerësuar secilin rast me kujdes. Nëse këta sahabë, ky dijetar, Ebu Hanifeja – dhe kjo shkollë – me këto parime të sakta, nuk janë në përputhje me Sunetin dhe në rrugën e Zotit, atëherë nuk do të mund të jetë askush tjetër. E nëse këta konsiderohen si njerëz të bidatit, atëherë me të drejtë mund të thuhet se Kiameti nuk është larg!

Këto informacione të përmbledhura shkurt, për shkak të hapësirës së kufizuar, janë vetëm shkëndija për ata që kanë vullnet dhe mundësi të thellohen më tej. Ndër sahabët e tjerë që kanë ndikuar në këtë mendësi dhe në shtrimin e rrugës për formimin e kësaj shkolle juridike janë:

Sead ibën Ebi Vekas r.a. ishte i treti që pranoi Islamin, në moshën 17 vjeçare.¹⁶

Ai ishte çliruesi i Irakut dhe sunduesi i tij për një kohë të gjatë. Ishte i fundit që ndërroi jetë nga dhjetë sahabët e përgëzuar me Xhenet,¹⁷ dhe një nga gjashtë personalitetet e propozuara për halife.¹⁸ U shqua si një nga më të zgjedhurit dhe më të diturit e sahabëve.

Amar ibën Jasir r.a. ishte emëruar udhëheqës i Kufes dhe ishte një nga sahabët më të dalluar, pjesëmarrës në betejën e Bedrit.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “...Ndiqeni udhëzimin e Amarit...”¹⁹ Sahabiu Othman ibën Ebu el Asi ka thënë: “Kanë vdekur dy persona që i donte shumë Pejgamberi a.s.: Abdullah ibën Mesudi dhe Amar ibën Jasiri.” Po ashtu, kishte thënë: “Kush e urren Amarin, atë e urren Zoti, dhe kushdo që e armiqëson Amarin, armiqësohet me Zotin xh.sh.”²⁰

Ebu Musa el Esharij r.a. ishte një nga dijetarët e shquar sahabi. Ka qenë sundues i Kufes.²¹ Ishte në gjashtëshen e sahabëve më të ditur. Ahmed ibën Hanbeli kathënë: “Ishte prej tre sahabëve më të ditur.” Megjithatë, ai e pasonte mendimin e Aliut r.a., edhe nëse ndonjëherë kishte mendim tjetër.²²

Hudhejfe ibën el Jemani r.a. ishte një sahabi i veçantë. Tek ai gjendeshin sekretet e Muhamedit a.s., dhe ishte vizitor i shpeshtë i Kufes.²³ Ai që i njeh ato që të tjerët nuk i njohin, pa dyshim që është njohës i mirë edhe i atyre që të tjerët i dinë.

Selman el Ferisij r.a., ishte prej sahabëve të zgjedhur dhe i afërt me Pejgamberin a.s., urtësia, butësia dhe dituria, ishin virtyte të tij, jetoi dhe vdiq në Kufe.²⁴

El Bera ibën Azibi r.a. jetoi dhe vdiq në Kufe.²⁵ Ishte nga brezi i ri i sahabëve dhe u dallua si aktivist në çlirime. Qëndroi në krah të Aliut r.a. dhe e mbështeti atë.²⁶

Siç shihet nga kjo pasqyrë e shkurtër, lehtësisht kuptohet dhe konfirmohet se themeluesit e shkollës apo metodologjisë së Kufes, e konkretizuar në medhhebin hanefi, ishin sahabët e dalluar dhe të afërt të Muhamedit a.s., të cilët ishin edhe njohësit më të mirë të jetës së tij. Sikur vetëm këta sahabinjë të ishin referenca e medhhebit hanefi për të kuptuar fenë ashtu siç ka dëshiruar Muhamedi a.s., respektivisht Zoti xh. sh., do të mjaftonte. Nuk besoj se dikush mund të pretendojë se mbi një mijë e pesëqind sahabë, shokë të Muhamedit a.s., nuk e kanë transmetuar fenë drejt dhe tërësisht, duke mos harruar se mes tyre ishin edhe shumë shokë më të afërt dhe më të ditur të Pejgamberit a.s.. Megjithatë, medhhebi dhe dijetarët islam që ishin themelues dhe bartës të kësaj shkolle udhëtuan dhe mësuan në të gjitha qendrat e tjera islame. Këtë do ta verifikojmë në shkrimet e tjera, duke treguar se si dijetarët udhëtuan për të takuar sahabët dhe jo vetëm, në qytete të ndryshme. Këto qëndrime do të jenë të verifikuara nga literatura islame, që është një mundësi e hapur për verifikim nga çdokush. Andaj themi se mundet që një individ të mos i kujtohet ndonjë hadith gjatë shtjellimit të

ndonjë çështjeje, por nuk paramendohet që shkencës apo të gjithë përfaqësuesve të saj t’u mungojë ndonjë hadith. Nëse do të ishin hadithet e fshehura, ata do t’i gjenin, sepse ishin të sinqertë dhe seriozisht të angazhuar në kërkimin dhe hulumtimin e tyre. Për më tepër, hadithet ishin në dispozicion të secilit, ato u shkruan dhe u përhapën për të gjithë. Dijetarët ishin të parët që i pranuan, analizuan dhe përfituan nga hadithet.

Pra, mund të themi se sahabët ishin themeluesit e mendësisë dhe logjikës së medhhebit, ndërsa për ndërtuesit dhe zhvilluesit e tij do të flasim në temën vijuese.

- 1 Ibën Sallahu në Mukadimeh, 2/497. *Mugletaj bi Kulejxh bin Abdillahi bin el Bekxherij el Hanefij, El Isharatu Ila Sira el Mustafa ve Terih men badehu min el Hulefa*, 1/346.
- 2 Ibën Kajmi, Ebu Abdullah, *Ja'elam el Mukiaian an Rab el Alemin*, 2/18-20.
- 3 Ibën Mensur, Seid, *Sunen*, (Dar Esamiçij, 1997), 1/4. Ibën Es Sead, Muhamed, *Et Tabekat el Kubra*, (Bujrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 1990), 6/89.
- 4 Es Sehabi. Shemsuddin, *Feth el Mugith*, (Egjip, Mektebetu Es Suneh, 2003), 4/111.
- 5 Ibën Hambel, Imam Ahmed, *Musned*, (Bejrut, Musned err Risale) nr. 3906, 7/23.
- 6 Ibën Maxheh, Ebu Abdullah, *Sunen*, (Bejrut, Dar err Risaleh el Aleimijeh, 2009) nr.138, i sakt, 1/98.
- 7 Ibën Ebi Shejbeh, Abdullah, *El Musanef*, (Saudi, Riad, Dar Kunuz Ishbilja Li Nesher ve et Tvzië 2015) 17/161.
- 8 Esh Shirazi, Ebu Is'hak, *Tabekat el Fukaha*, (Liban, Bejrut, Dar err Rraid el Arabij, 1970) f.81.
- 9 Ibën Mensur, *Sunen*, 1/4.
- 10 Hasan, Ahmed Muhamed, *Es Sahabi Abdullah Ibën Mesud ve Etheruhu fi Fikh el Hanefij*, (kjo temë e masterit e mbrojtur në Jordan, në Universitetin e Shkencave Ndërkombëtare Islame, 2021, gjendet në Bibliotekën e Universitetit) f.544.
- 11 Hanbel, Ahmed, *El Illel ve Mearifetu err Rrixhal*, (Rijad, Dar el Hani, 2010) 2/162.
- 12 Et Tirmidhij, Ebu Isa, *Sunen*, (Bejrut, Der el Garb el Islami, 1996), nr. 3719, I pranuar, 6/83.
- 13 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 2/267.
- 14 El Akur, Ihab, *Ether es Sahabi Alij ibën Ebu Talib r.a., fi Medhhebi Hanefij* ((kjo temë e masterit e mbrojtur në Jordan, në Universitetin e Shkencave Ndërkombëtare Islame, 2025, gjendet në Bibliotekën e Universitetit) f.376.
- 15 El Krtubij, Ebu Omer, *El Intika fi fedail eth Theletheh el Eimeh el Fukaha*, (Bejrut, El Kutub el Ilmijeh), f.143.
- 16 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 3/103.
- 17 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/92.
- 18 Edh Dhehebij, Shemsudin, *Siratu el Alam en Nubelaë* (Egjip, Kajro, Dar el Hadith, 2006) 3/66.
- 19 El Hakim, Ebu Abdullah, *El Mustedrek Ala es Sahihajn*, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 1990), nr. 4590, hadith i sakt, 3/77.
- 20 El Bagdadi, El Hatib, *Terih Bagdad*, (Bejrut, Dar el Garb el Islami, 2002), 1/489, 490.
- 21 Ibën Sead, *Et Tabekat el Kubra*, 6/95.
- 22 Hanbel, *El Illel ve Mearifetu err Rrixhal*, 2/162.
- 23 El Asalani, Ibën Haxher, *El Isabeh fi et Temjiz es Sahabeh*, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 1415 h.) 2/39-40.
- 24 En Nevevij, Ebu Zekerija, *Tehdhib el Esmae ve el Lugat*, (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 1431 h.) 1/227.
- 25 Err Rrazi, Ibën Ebi Hatim, *El Xherh ve et Teadil*, (Indi, Dairatu el Mearif el Uthmanijeh, 1952), 2/399.
- 26 Es Safidij, Salahudin, *Nuketh el Hejman fi Nuketh el Amjan* (Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 2007) f.101.

Origjina e shkollave juridike islame

Mr. Hazir D. Selmani

Shkolla juridike islame në terminologjinë dhe literaturën fetare islame është medhhebi fikhor. Sot, nëpër botën islame dëgjohen fjalët si medhhebi hanefi, maliki, shafi, hanbeli, etj., dhe si zakonisht këto emërtime lidhen me dijetarin themelues të tyre. Por, çka realisht janë këto medhhebe dhe si erdhi deri te shfaqja e tyre?

1. HYRJE - DEFINIMET E NEVOJSHME

Fjala arabe “*medhheb*”, shumësi i së cilës është “*medhahib*” është një emër i veçantë foljor (ar.: *mesdar mimij*), që rrjedh nga rrënja e foljes “*dhehebe*” (shq.: vajti, shkoi, iku, nisi, udhëtoi, etj.). Kjo fjalë në këtë formë, d.m.th. vendin ku bëhet ky veprim i foljes ose dome-thënien e vetë konceptit të veprimit në fjalë.¹ Nisur nga kjo, fjala “*medhheb*” gjuhësisht mund të përkthehet si: vajtje, udhë, drejtim, etj.. Prandaj, rrugës shkencore të veçantë të një dijetari kompetent dhe metodologjisë që ai trason për të arritur në një përgjigje a rezultat, ose vetë rezultateve që ai i sjell konform kësaj rruge u themi medhheb (shq.: udhë, drejtim, etj.).

Nëse rruga në fjalë ka të bëjë me gjuhën arabe, atëherë kemi medhhebet gramatikore, ose siç njihen ndryshe si medrese p.sh. Medreseja gramatikore e Kufës, ajo e Basrës, Bagdadit, Misirit, Andaluzisë, etj.. Nëse rruga shkencore në fjalë ka të bëjë me bindjen-besimin (ar. *El Akideh*), atëherë kemi medhhebe akaidore, ose thënë më preciz sekte (ar. *El Firkah* ose *El Nihleh*) si p.sh. harihizmi, teshbihizmi, shiizmi, mutezilizmi,

Medhhebi fikhor është ajo rruga e mirësishtuar e mendimit dhe angazhimit të dijetarit kompetent për nxjerrje të normave nga burimet e legjislacionit islam ose rezultatet që ka sjellë dijetari kompetent (dhe tjerët pas tij duke ndjekur rrugën e tij) nga burimet e legjislacionit islam.

etj.. Për dallim nga tjerët, medhhebet akaidore nuk janë gjë e lëvdur. Pastaj, nëse rruga e trasuar ka të bëjë me udhën shpirtërore islame dhe kullimin e veprave dhe edukimin e shpirtit, atëherë kemi udhët islame të përshtatshme (ar. *El Tarikah*), si p.sh. Udhë e Xhunejdit, Udhë e Abdulkadir Xhilanit, etj..

E nëse kjo rrugë ka të bëjë me vënien në praktik të sheriatit ose ortopraktikës islame (ar. *El Fikh*), atëherë kemi ato që u themi medhhebe fikhere. Që d.m.th. medhhebi fikhor është ajo rruga e mirësishtuar e mendimit dhe angazhimit të dijetarit kompetent për nxjerrje të normave nga burimet e legjislacionit islam ose rezultatet që ka sjellë dijetari kompetent (dhe tjerët pas tij duke ndjekur rrugën e tij) nga burimet e legjislacionit islam. Ndërsa në terminologji medhhebi fikhor mund të definohet si: “*Rruga legjitime e trasuar si mënyrë për ta kuptuar Sheriatin dhe argumentet (burimet), të cilën e ka trasuar një imam prej imamëve të respektuar dhe që është njohur si metodë e tij e nxjerrjes së vendimeve (hukmeve)*.”² Kuptimi i fundit është synimi i medhhebit për çka po shkruajmë.

Lindja e medhhebeve fikhere nuk ishte diçka e rastësishme dhe as edhe një zbulim që doli ashtu në pah rastësisht. Lindja e medhhebeve fikhere (mendimeve dhe metodologjisë) ishte një rrugëtim i gjatë që në të vërtetë filloi me sahabët e mëdhenj dhe pastaj vijoi me nxënësit e tyre (ar. *tabiinë*) duke u zhvilluar me një proces të gjatë të zgjerimit dhe shkallëzimit të përpjetshëm të dijeve islame si dhe shtresimit e akumulimit



të dijeve (fikh) dhe metodologjisë nxjerrëse të dispozitave (usuli fikh) nga burimet e ligjit islam. Kështu në fund dolën në skenë medhhebet e mirësishtuara fikhore, ku një numër i tyre sot janë të pranishëm dhe të ndjekur anembanë botës. Për të kuptuar më mirë lindjen dhe zhvillimin e tyre, detyrimisht duhet të kthehemi te periudha e ndritur pejgamberike.

2. PERIUDHA E NDRITUR E PEJGAMBERIT A.S.

Allahu i Gjithëditur ka zgjedhur disa njerëz të veçantë (ar.: *rusul dhe enbija*) duke u zbritur atyre shpallje (ar.: *el vahj*), të cilën shpallje njerëzimi duhet ta besonin, ta pranonin dhe në praktikë ta zbatonin. Kjo shpallje është ajo që njihet me emrin *Sheriat*.

Kështu vijoi edhe me Pejgamberin e fundit, Muhamedin a.s.. Me fundin e jetës së tij u përmbyll *vahji* dhe *sheriati*. Dijetari i madh hanefi i Damaskut, dr. Nidal Aleh Rashi shprehet kështu: “Ligjvënës (ar.: El Musherrië) i vetëm është i Plotfuqishmi Allah. Ndërsa, Pejgamberi a.s., llogaritet si ligjvënës vetëm në mënyrë figurative (mexhazen), për shkak të detyrës së tij shpjeguese që kishte, siç thotë Allahu në ajetin 44 të sures Nahël: “*Ty ta zbritëm Dhikrin (Kuranin), që t’u shpjegosh njerëzve atë që iu është shpallur atyre, me shpresë se do ta meditojnë!*”³ Ai më tej vijon dhe shprehet se: “Detyra shpjeguese e Pejgamberit realizohej me fjalë, me vepër dhe me miratim. Kur ai pyetej për ndonjë gjë, ose i kërkohej diçka, atëherë nëse kishte diçka të shpallur rreth asaj, atë edhe ua kumtonte, përndryshe ishte i urdhëruar të priste vahjin e ri për dispozitën e çështjes deri në një periudhë të caktuar dhe pastaj nëse nuk i shpallej diçka, atëherë pas kalimit të kësaj periudhe ai kishte të drejtë ixhtihadi (shq.: përpjekje e veçantë nga njerëz të veçantë për të deduktuar një dispozitë

nga burimet e Sheriatit). Kjo që u tha është sipas mendimit të përzgjedhur dhe më të saktë të dijetarëve hanefi.”⁴

Pejgamberi gjatë jetës së tij -sidomos në periudhën medinase- edukoi shumë sahabë për *fetfa-kada* (shq.: dhënie vendimesh fetare dhe gjykime). Prej tyre përmenden: Ebu Bekri, Omeri, Othmani, Aliu, Muadhi, Abdurrahman bin Aufi, Ubej bin Kabi, Zejd bin Thabiti, etj..⁵ Madje, gjersa e përcolli Muadhin për në Jemen ia legjitimoi metodologjinë e tij në *ixhtihad*, e cila fillonte gjykimin me Kuran, pastaj me sunet dhe tek pastaj kalonte në kijas të matur. Kjo a nuk është farë fillestare e nisjes së një medhhebi?! Pastaj, në disa raste Pejgamberi i linte disa sahabë të gjykonin për disa çështje, madje edhe në prezencën e tij.

Ndërroi jetë Pejgamberi a.s. dhe pas vetes la *Sheriatin e Fundit*, i cili dilte në pah në Kuran si dhe shpjegohej në Sunet (jetesë, fjalë, veprime dhe miratime të Pejgamberit) si dhe la edhe një numër të madh shokësh të tij sahabë me nivele shumë të larta të dijes së marrë nga vetë ai a.s..

3. PERIUDHA E LINDJES SË MEDHHEBEVE TË PARË (PERIUDHA E SAHABËVE DHE TABIINËVE)

Me vdekjen e Pejgamberit a.s. u mbyll edhe dera e shpalljes. Tanimë tekstet fetare islame (ajetet dhe hadithet) kishin një numër ku përfundonin, e ndërsa ndodhitë, pyetjet dhe nevojat e njerëzve vetëm se shtoheshin. Prandaj, dikush nga sahabët duhej të gjente zgjidhje dhe përgjigje për këto gjëra. Numri i përgjithshëm i sahabëve nuk dihet saktësisht, edhe pse thuhet se ata ishin rreth 100-120 mijë sahabë. Ajo që më tepër ka rëndësi është numri i tyre në Medinë. Kjo, ngase këta qëndruan më së gjati me Pejgamberin dhe panë nga afër jetën e tij duke dëgjuar e mësuar drejt prej tij. Sipas Gazaliut, në vdekjen e Pejgamberit a.s. në Medinë ishin 20 mijë sahabë, sipas imam Ahmedit aty pari ishin 30 mijë dhe sipas Shafiut

ishin 60 mijë (30 mijë në Medinë dhe 30 mijë në fise e kabile të tjera përreth Medinës).⁶ Pastaj jo gjithë këta ishin kompetent për fetfa. Shiraziu në kronikat e tij të fukahave shprehet kështu: "...sahabët të cilët u dalluan në dhënien e fetvave dhe nxjerrjen e dispozitave duke diskutuar për hallall e haram ishin *një grup i caktuar*."⁷ Ibën Humami shprehet kështu: "...numri i sahabëve në vdekjen e Pejgamberit a.s. ishte 100 mijë, mirëpo prej këtyre numri i muxhtehidëve fukaha nuk kalonte në më shumë se 20, ndërsa pjesa tjetër e sahabëve ktheheshin te këta për fetfa."⁸ Ibën Hazmi këtë numër e dërgon deri në mbi 153 (ose 162) sahabë, mirëpo siç shprehet Keutheri se ai këtë gjë e ka bërë për të vështirësuar dëshminë e konsensusit (ar. *El Ixhma'a*), madje çuditërisht duke listuar edhe Maizin dhe Gamidijen në mesin e fukahave muxhtehidë të sahabëve!⁹

Në mesin e këtyre sahabëve të mëdhenj muxhtehidë janë: 1. Ebu Bekri, 2. Omeri, 3. Othmani, 4. Aliu, 5. Ibën Mesudi, 6. Ibën Omeri, 7. Ibën Abasi, 8. Zejd bin Thabiti, 9. Muadh bin Xhebeli, 10. Enes bin Maliku, 11. Ebu Hurejra, 12. Aisheja, 13. Ebu Musa Eshariu, 14. Ubej bin Kabi, 15. Ebu Derda, 16. Abdullah bin Amër bin Asi, 17. Abdullah bin Zubejri, etj..

Çdonjëri prej këtyre sahabëve filloi të jepte përgjigje për nevojat e njerëzve dhe ndodhitë e reja në shoqërinë islame. Tërë këtë e bënë duke medituar ajetet dhe hadithet me një mbështetje fillimisht në ajete, pastaj në hadithe dhe në jetën e Pejgamberit, si dhe në gjuhën e kulluar arabe, pastaj herë-herë me konsultime me sahabët e tjerë si dhe herë-herë duke rënë në ujdje e konsensus mes tyre (ar. *El Ixhma'e*) ose duke krahasuar (ar. *El Kijas*) ndodhitë e reja me ato që kishin ngjarë në periudhën e ndritur të shpalljes. P.sh. rasti i tubimit të Kuranit në një Mus'haf të vetëm, luftimi i fiseve që refuzuan dhënien e zekatit, namazi i teravisë, zekati për ata njerëz që duhej fituar zemrat e tyre, lënia e të drejtës për shpërndarje të zekatit të arit dhe argjendit te vendet (destinacionet) e zekatit në vetë dispozicionin e pronarëve, disa mesele të trashëgimisë, zgjedhja e halifit, tatimet për tokat e çliruara të Irakut dhe vendeve të tjera, etj..

Për një periudhë të shkurtër lindën disa medhhebe fikhere, të cilët edhe pse ishin shumë të ngjashëm me njëri-tjetrin, ata përsëri kishin ca dallime që mund të vërehen në librat e mëdha të divergjencave fikhere.

Për një periudhë të shkurtër lindën disa medhhebe fikhere, të cilët edhe pse ishin shumë të ngjashëm me njëri-tjetrin, ata përsëri kishin ca dallime që mund të vërehen në librat e mëdha të divergjencave fikhere (ar. *Ihtilafu'l-fukaha*). Dalëngadalë disa prej këtyre sahabëve vdiqën e disa të tjerë u shpërndanë nëpër qendra të ndryshme islame. Kështu, krahas Medinës në botën islame lulëzuan edhe disa qendra të tjera islame me mexhlise të dijes e fikhut, kjo falë shpërnguljes së një numri të këtyre sahabëve të mëdhenj atje pari, si p.sh. në Mekë lulëzoi mexhlisi i Ibën Abasit, në Medinë mexhlisi i Ibën Omerit, në Basra ai i Enesit dhe Ebu Musa Eshariut, në Kufe ai i Ibën Mesudit dhe Aliut, në Sham mexhlisi i Muadhrit, Ubadeh b. Samitit dhe Ebu Derdasë dhe kështu me radhë. Këta sahabë në mexhliet e tyre rreth vetes tërhoqën nxënës të tjerë prej sahabëve të vegjël dhe tabiinëve. Bukur mirë shprehet Bekër Ebu Zejdi kur thotë se: "Farat e para të medhhebeve fikhere filluan që herët në periudhën e sahabëve, ngase medinasit mbështeteshin në fetvatë e Ibën Omerit, mekasit në fetvatë e Ibën Abasit dhe kufianët mbështeteshin në fetvatë e Ibën Mesudit. Kështu u vendos fara e parë e konceptit të medhhebizmit me medhhebet."¹⁰

Zakonisht, nxënësit e sahabëve duke parë mënyrën se si vepronte mësuesi kur i paraqitonte ndonjë problem, mu ashtu edhe ata nisën të mendonin dhe gjykonin si mësuesit e tyre si dhe të krijonin një mënyrë të veçantë të të menduarit, gjykitimit dhe vlerësimit për arritje të një rezultati të iks çështjes a ndodhisë për të cilën lypej vendimi-gjykimi i Sheriatit islam. Këta tabiinë rreth vetes tërhoqën nxënës të tjerë dhe kështu në shesh dolën medhhebet e *tabiinëve të mëdhenj*, e që ishin një vazhdim i medhhebeve të mësuesve të tyre sahabë. Deri këtu medhhebet lindnin, zhvilloheshin pakëz dhe pastaj shuheshin me vdekjen e themeluesit edhe pse metoda e tij vijonte të zhvillohej e të perfeksionohej nga nxënësit brez pas brezi. Kështu në skenë dalëngadalë dolën medhhebet e *tabiinëve të vegjël*. Disa prej mendimeve të këtyre tabiinëve dhe të sahabëve muxhtehidë gjenden në *El Musannef* të Ibën Ebi Shejbes dhe atë të Abdurrazakut. Pastaj në *El Muveta'*, e sidomos

në versionin e Shejbanit, në *El Haraxh* të Ebu Jusufit, *El Umm* të Shafiut si dhe në shumë libra të tjera të llojit “*Ihtilafu’l-fukha*”. Duhet pasur parasysh se medhhebet e këtyre dy-tre brezave të muxhtehidëve sahabë, tabiinë dhe tabiinë të vegjël nuk kishin akoma terminologji precize të asaj që ne sot e njohim si fikh dhe rreth tyre nuk u shkruan libra medhhebove që do të ruanin mirë fikhun e tyre. Prandaj shumë dijetarë të vonshëm ndalojnë fetfadhënie sipas medhhebeve të këtyre, ngase opinionet dhe fikhu i tyre i plotë nuk na ka arritur i regjistruar, ku edhe pse gjenden opinione të tyre fikhere, mirëpo përsëri mungojnë shumë imtësia, e sidomos shartet, ruknet, sebetet, mufsidet e asaj meseleje fikhere. Edhe në lindjen e tërë këtyre medhhebeve, po edhe në shuarjen e tyre ndikuan shumë faktorë, mirëpo hapësira e studimit nuk mundëson zgjerimin në këtë pikë.

4. PERIUDHA E MEDHHEBEVE FIKHORE NË KUPTIMIN E MIRËFILLTË

Duke filluar nga gjysma e parë e shekullit të II hixhri, në shumë qendra islame ishin pjekur kushtet për dalje në shesh të medhhebeve të mirëfillta fikhere, të mirësistemuar dhe me metodologji shumë të qartë dhe të përpiktë. Kjo lindje nuk ishte aq e thjeshtë, por erdhi si rezultat i një rrugëtimi të gjatë që pati nisur me sahabët muxhtehidë. Në vijim do të ilustrim vetëm dy shembuj të rrugëtimit të fikhut nga medhhebet e thjeshtë të sahabëve e deri në medhhebet e mirëfilltë të fukahave të mëdhenj islam.

Në Kufe kryesisht u zhvillua fikhu i halifit të katër Ali bin Ebi Talib dhe ai i Abdullah bin Mesudit. Prej këtyre (njërit ose të dyve) mësuan Alkameja, Shabiu, El Esvedi, etj.. Pastaj nxënësi më i madh i këtyre ishte Ibrahim Nehaiu. Nxënësi më i madh i Nehaiut ishte Hammadi, mentori dhe mësuesi kryesor i Ebu Hanifes, prej të cilit rrjedh medhhebi ynë hanefi.

Në Medinë kryesisht u zhvillua fikhu i Omerit, Ibën Omerit, etj.. Prej brezit të sahabëve mësuan *shtatë fukahatë* e Medinës. Pastaj prej këtyre mësori Rabiati’r Ra’ji dhe shumë të tjerë. Prej Rabias mësori Malik bin Enesi prej të cilit rrjedh kjo që sot e njohim si medhhebi maliki.

Kështu në këtë formë në botën islame lindën: 1. Medhhebi hanefi, 2. Medhhebi maliki, 3. Medhhebi sufjani (theurij), 4. Medhhebi euzaij, 5. Medhhebi lejthij, 6. Medhhebi shafij, 7. Medhhebi hanbeli, 8. Medhhebi dhahiri (davudij), 9. Medhhebi i Ebu Theurit, 10. Medhhebi xheririj (taberij). Pastaj jashtë ehli’s-sunetit u zhvilluan disa medhhebe fikhere si: 11. Medhhebi zejdi, 12. Medhhebi xhaferij dhe 13. Medhhebi ibadij. Më tej, kryesisht nga gjiri i disa medhhebeve paraprake lindën edhe disa medhhebe si: 14. Medhhebi i Ibën Rahujes (Rahavejhit), 15. Medhhebi i Ibën Ujejes, 16. Medhhebi i Ibën Mundhirit, 17. Medhhebi i Ibën Huzejmes, 18. Medhhebi i Buhariut, etj..

Shumica e këtyre medhhebeve patën shtrirje gjeografike por edhe kohore, mirëpo pastaj pushuan së ekzistuari. Mbi numrin total të medhhebeve fikhere përgjatë historisë islame ka hapësirë diskutimi. Dr. Ali Xhumah shprehet se përgjatë historisë islame lindën rreth 90 medhhebe fikhere. Para tij, Ahmed Emini – i ndikuar nga orientalisti F. Kern – deklaroi se deri në krye të shekullit të III hixhri pushuan së ekzistuari rreth 500 medhhebe.¹¹ Ky numri i fundit duket tejet i stërmadhuar dhe hiperbolizues, ndërsa numri i dr. Xhumas është shumë më i mundshëm në kuptimin e medhhebeve të mirëfilltë siç e njohim sot.

5. SHTRIRJA E MEDHHEBEVE NË KOHËN E SOTME

Nga të gjithë 17 medhhebet fikhere të sipërpërmendur sot zyrtarisht ekzistojnë vetëm 8: *Medhhebi hanefi* shtrihet në shumicën e Azisë, gjysmën e Lindjes së Mesme, pjesërisht në Egjipt, pastaj në Turqi dhe në Ballkan. *Medhhebi maliki* shtrihet në pothuajse tërë shtetet e Afrikës Veriore dhe Qendrore si dhe në një pjesë të vogël të Saudisë, Kuvajtit dhe Emirateve. *Medhhebi shafi* gati-gati shtrihet në gjysmën e Lindjes së Mesme, një pjesë të Jemenit, një pjesë të Kaukazit, shumicën e shteteve të Bririt të Afrikës dhe në shumicën e Arkipelagut Malajindonezian. *Medhhebi hanbeli* shtrihet në Saudi dhe aty-këtu në Lindje të Mesme dhe Egjipt. *Medhhebi dhahiri* në pakicë të skajshme haset në Algjeri. Pastaj jashtë ehli’s-sunetit: *medhhebi xhaferi* kryesisht në Iran dhe një pjesë të Libanit, *medhhebi zejdi* kryesisht në Jemen si dhe *medhhebi ibadij* në Oman dhe ca zona të vogla të Afrikës.¹²

- 1 Shiko: Abdulfetah el Jafi’ij, *El Temeddhub*. (San’a: Merkezu’l-hajrat, 2018, botimi VI), f. 39.; <https://www.arabisht-shqip.com/fjala/41297-fjala:ذهب> (vizituar për herë të fundit më 12.07.2025).
- 2 Muhamed Sidki Burnu, *Meusuatu’l-kavaidi’l-fikhijeh*. (Bejrut: Muesesetu’r Risaleh, 2003, botimi I), v. IX, f. 387.
- 3 Nidal Aleh Rrashi, *Duraru Xhevahiri’l Bihar sherhu metni’l Menar*. (Stamboll: Daru Seman, 2019, botimi I), f. 15.
- 4 Po aty, f. 413.
- 5 Muhamed Salihi Shami, *Subulu’l-huda ve’r-rashad*. (Bejrut: Dki, 1993, botimi I), v. 11, f. 328.
- 6 Shemsudin Sehavi, *Fet’hu’l-mugith*. (Kajro: Mektebetu’s suneh, botimi I, 2003), v. 4, f. 110.
- 7 Ebu Is’hak Shirazi, *Tabekatu’l Fukaha*. (Bejrut: Daru’r-raidi’l-arabij, 1970, botimi I), f. 35-36.
- 8 Kemal Ibën Humam, *Fet’hul Kadir*. (Bejrut: Daru’l-kutubi’l-ilmiyeh, 2003), vëll. III, f. 453.
- 9 Zahid Keutherij, *El Ishfak ala ehkami’t Talak*. (Aman: Daru’l Fet’h, botimi I, 2022), f. 194.
- 10 Bekër Ebu Zejd, *El Med’halu’l-mufessal li medhhebi’l-imam Ahmed*. (Rijad: Daru’l aasimeh, 1996), v. 1, f. 34.
- 11 Hazir Selmani, *Tre shekujt e parë të medhhebit hanefi (historiku, personalitetet dhe literatura)*. (Prishtinë: Fakulteti i Studimeve Islame, tezë masteri e pabotuar, 2024), f. 3.
- 12 Malise Ruthven & Azim Nanji, *Historical Atlas of Islamic World*. (Massachusetts: Harvard University Press, 2004), f. 180.

Fikhu i prioriteteve në jetën e myslimanit

NGA FETVATË E DIJETARIT TË MADH DR. JUSUF EL KARDAVI:

PYETJE: Cilat janë çështjet për të cilat duhet të kujdesemi në jetën tonë si myslimanë, dhe në jetën e njerëzve si predikues të Allahut, pasi që çështjet e Islamit janë shumë, dhe ne nuk dimë se për cilat duhet të kujdesemi dhe cilave t'ju japim rëndësi para të tjerave?



Besimi në Allahun e Plotfuqishëm, besimi në shpalljet e Tij, te të dërguarit e Tij, besimi në botën tjetër dhe çështjet që lidhen me të, si shpërblimi dhe ndëshkimi, Xheneti dhe Xhehenemi.

PËRGJIGJJA:

Me emrin e Allahut, falënderimi qoftë për Allahun, bekimet dhe paqja qofshin mbi të Dërguarin e Allahut!

Kurani fisnik është kushtetuta e myslimanëve, që ua ndriçon atyre rrugën, dhe është e detyrueshme që myslimani të kujdeset për atë që u kujdes Kurani, siç janë bazat e besimit, morali fisnik, sjelljet e mira dhe bazat e tjera të adhurimit dhe transaksioneve.

Shejhu i nderuar dr. Jusuf el Kardavi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

Prej kriterëve të cilat duhet të shqyrtohen me rastin e shpjegimit të çështjeve që janë më prioritare dhe më të merituar që të kujdesemi dhe t'ju japim rëndësi para të tjerave, është:

- Kujdesi për një çështje, ashtu siç është kujdesur për të edhe Kurani fisnik. Ato çështje, të cilave Kurani u ka kushtuar kujdes të madh, të cilat i ka përsëritur në suret dhe ajetet e tij, të cilat i ka potencuar në urdhrat dhe ndalesat e tij, në premtimet dhe kërcënimet e tij, po ato çështje, duhet të kenë përparësi, prioritet dhe kujdes edhe në mendimin tonë, në sjelljen tonë dhe në vlerësimin tonë. Këto çështje, që meritojnë këtë kujdes janë:



- Besimi në Allahun e Plotfuqishëm, besimi në shpalljet e Tij, te të dërguarit e Tij, besimi në botën tjetër dhe çështjet që lidhen me të, si shpërblimi dhe ndëshkimi, Xheneti dhe Xhehenemi.

- Bazat e ibadeteve dhe ritualeve si: falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi, haxhillëku, dhikri - përmendja e Allahut të Madhërishëm, lavdërimi i Tij, falënderimi i Tij, kërkimi i faljes nga Ai, pendimi tek Ai, mbështetja në Të, shpresa në mëshirën e Tij, frika nga dënimi i Tij, falënderimi për begatitë e Tij, durimi për sprovat e Tij, e të tjera prej ibadeteve të fshehura të zemrës deri te pozitat e larta hyjnore

- Bazat e virtyteve dhe moralit, cilësitë e bukura si: sinqeriteti dhe ndershmëria, qëllimi dhe dëlirësia, turpi dhe përlulesia, sakrifica dhe bujaria, turpi ndaj besimtarëve dhe krenaria ndaj jobesimtarëve, mëshira ndaj të dobëtëve, mirësia ndaj prindërve, lidhja familjare, nderimi i fqinjit, kujdesi ndaj të varfrit, ndaj jetimit dhe ndaj udhëtarit.

Ndërkaq, për çështjet që Kurani është kujdesur më pak, edhe ne atyre çështjeve duhet t'ju kushtojmë vëmendje të tillë dhe mos ta teprojmë. Si shembull për këtë mund ta theksojmë 'Isranë' e Pejgamberit a.s., të cilën Kurani e ka përmendur vetëm me një ajet, ndryshe nga marshimet (luftërat) e tij, të cilave iu janë kushtuar sure të plota. Sa i përket *mevludit* – lindjes së Pejgamberit, Kurani nuk i ka kushtuar vëmendje. Kjo tregon se ai nuk është një çështje e rëndësishme në jetën islame, pasi që nuk është shoqëruar me ndonjë mrekulli sikur që ishte shoqëruar lindja e Krishtit (Isait a.s.), as me ndonjë

vepër ose ibadet i cili kërkohet nga myslimanët, qoftë në mënyrë të detyruar ose në bazë vullnetare.

Ky është standard i pagabueshëm, sepse Kurani është shtyllë e besimit, rrënjë e fesë dhe burim i Islamit. Suneti vjen për ta shpjeguar dhe qartësuar. Allahu i Lartësuar thotë:

"Me të vërtetë, ky Kuran udhëzon kah ajo që është më e drejtë..." (El Isra, 9);

"Prej Allahut ju erdh juve dritë (Pejgamberi) dhe Libri i qartë (Kurani). Me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin kënaqësinë e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësirat në dritë me lejen e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë." (El Maide, 15-16);

"Na ta kemi dërguar ty Librin, - shpjegim për çdo çështje dhe si udhërrëfyes, mëshirë dhe sihariq për myslimanët." (En Nahl, 89).

Kjo do të thotë që Ai ka sqaruar fundamentet e domosdoshme; që feja të bazohet në themel të fuqishëm, kështu që çdo njësi nga tërësia totale që i duhen jetës islame rrjedh nga Kurani, ose në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi. Transmetohet se kalifi i parë, Ebu Bekri r.a., ka thënë: *"Nëse më humbet një litar i devesë, unë do ta gjeja atë në Librin e Allahut."*

Allahu e di më së miri!

Përkthim nga arabishtja: Miftar Ajdini

Mysafirët e vegjël të xhamisë

Nexhat Ibrahim

HYRJJE

Fëmijët janë gëzimi dhe bukuria e çdo shtëpie, fshati dhe qyteti; stolia e rrugës; shpresa e vendit. Prania e tyre i jep gjallëri dhe kuptim jetës. Mungesa e tyre është shenjë ndjellakeqe e një vendi. Kur dëgjojmë se si shumë nëna e baballarë nuk formojnë familje, apo nuk lindin fëmijë për shkak të karrierës, për shkak të ruajtjes së vijës së trupit, për shkaqe absurde, dhe të tillët përkrahen nga politika zyrtare dhe OJQ-të, atëherë të vjen të vajtosh.

Në rrafshin fetar, nuk është e mjaftueshme kur ata fëmijë që kemi, i aftësojmë me kurse për kompjuter, për anglisht, për qitje me armë, për bërje muzikë në piano apo kitarë, për kujdesin ndaj shtazëve (qenve, maceve dhe bishave të tjera), por nuk i edukojmë që duhet të krijojnë familje, të kenë fëmijë dhe t'i duan ata, kjo është fundi i absurdit. Shikoni Perëndimin, ku gjysma e popullsisë janë pensionistë, me nga një qen apo mace në dorë, por shume rrallë i shohim me nipër apo mbesa për dore.¹ Kjo ka filluar të ndodh edhe te shqiptarët. Fëmijët për një jetë më të mirë braktisin prindërit dhe mësojnë botën perëndimore. Çfarë t'i thua mjekut që ik në Gjermani, kur këtu është "mbret" e atje bëhet "çolë". Prandaj, shkollat po zbrazen, por edhe xhamitë po. Xhemati i ri po ik në Evropë pas

Shkollat po zbrazen, por edhe xhamitë po. Xhemati i ri po ik në Evropë pas Iphon-it apo Samsung-ut, ndërsa po e harron prindin dhe vendlindjen për pak gjë. Mendojmë se faji kryesor bie mbi prindërit, sepse i edukuan si materialist e jo si mysliman.

Iphon-it apo Samsung-ut, ndërsa po e harron prindin dhe vendlindjen për pak gjë. Mendojmë se faji kryesor bie mbi prindërit, sepse i edukuan si materialist e jo si mysliman. Prindërit harruan fjalët e Pejgamberit a.s.: "Secili prej jush është bari dhe secili është përgjegjës për kopenë e tij. Burri është bari për shtëpinë e tij dhe përgjegjës për kopenë e tij. Gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit të saj dhe përgjegjëse për kopenë e saj."²

Fëmijët në xhami, po apo jo, nuk mund të shtrohet si pyetje! Patjetër po! Ne mund t'i diskutojmë modalitetet e pranisë së tyre në xhami: sipas moshës, mendësive, formave, mënyrave etj.. Xhamia është e të gjithëve dhe dera e së cilës nuk i mbyllet askujt, drita e saj nuk i privohet askujt! Është vendi, ku fëmijët janë më të privilegjuarit, sidomos kur shoqërohen me prindër të pjekur, që e njohin mirë frymën e xhamisë dhe kufijtë e etikës së saj dhe kufijtë e mirësjelljes në të. Xhamia është vendi ku Resulullahu a.s. zbriti nga minberi për të marrë në krahë nipin e tij dhe për t'u rikthyer së bashku me të në minber, si hatibi më i mëshirshëm dhe gjyshi më i mirë i krejt njerëzimit. Xhamia është vendi ku Resulullahu a.s. zgjati sexhden në një namaz me xhematë, sepse nipi i tij kishte hipur mbi shpinën e gjyshit. Xhamia është vendi ku Resulullahu a.s. shkurttoi namazin, sepse dëgjoi të qarat e një foshnje, e ëma e së



cilës falej së bashku me xhematin, pas të Dërguarit të Allahut. Enes ibën Maliku r.a. na tregon se Resulullahu a.s. ka thënë: “E filloj namazin dhe dua ta zgjas atë, kur dëgjoj të qarat e fëmijës, e shkurtoj, sepse e di dhembshurinë e nënës për të qarat e tij!”³ Xhamia është vendi ku Resulullahu a.s. mbante në prehër, në njërën anë vogëlushin Usame ibën Zejdin dhe në tjetrin nipin e tij, Hasanin, të cilët i përqafonte dhe lutej: “O Allah, ki mëshirë për këta të dy, sepse edhe unë kam mëshirë për ta!”⁴ Xhamia është vendi, ku ndër të tjera mësojmë se, fëmijët janë amanet i shtrenjtë, bekim nga Zoti dhe se, edukimi i tyre i shëndoshë, është shërbimi më i mirë për të sotmen dhe të ardhmen tonë si shoqëri islame.⁵

SHEMBUJ NGA JETA E PEJGAMBERIT TË ALLAHUT

Burejde b. Husejb r.a., sahabiu (shoku) që me Pejgamberin e Allahut a.s. mori pjesë në 16 beteja, ka rrëfyer:

“Derisa Pejgamberi i Allahut a.s. ka mbajtur hytben, Hasani dhe Husejni, me këmisha të kuqe, duke zënë në thua, hynë në mesxhid. Duke i parë ata, Pejgamberi i Allahut a.s. menjëherë zbriti nga minberi, i mori në krahë dhe sërish u ngjiti në minber, duke i vënë të ulen para tij.” Pastaj tha: “Dhe, dijeni se pasuria e

juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë, dhe se tek Allahu është shpërblimi i madh.” (El Enfal, 28).

Siç përcjellin transmetuesit e hadithit, Pejgamberi i Allahut

a.s., edhe pse duke mbajtur hytbe, zbret nga minberi, mori fëmijët në krah dhe vazhdoi misionin e tij pejgamberik. Prandaj, Muhamedi a.s. ishte shembull në çdo aspekt, me bujarinë dhe bashkëdhimbjen e tij. Ai i donte fëmijët, iu kushtonte vëmendje, u jepte rëndësi dhe iu bënte me dije që i do ata. Këtë sjellje të tij e vënin edhe fëmijët e tjerë të qytetit e jo vetëm ata familjarë. Këtë sjellje ai e bënte si drejtpërdrejt, kur i takonte në rrugë, ashtu edhe nëpërmjet prindërve, dhe këshillave të përgjithshme. Më së shpeshti fëmijët i takonte në xhami, ku ata silleshin që të përshtateshin e mësoheshin me mësimet islame. Xhamia ishte vendi kryesor për formimin e personalitetit të fëmijëve, si njerëz, si prindër, si punëtor, si luftëtar. Aty edhe arsimoheshin me dije të ndryshme, varësisht nga ligjëruesi, por edhe prirja e tyre.

Fëmijët duke ndjekur xhaminë, mësonin fenë, mësonin dijet kryesore të kohës, ambientoheshin në rrethana heterogjene sociale, racore, ish-fetare, ish-gjuhësore. Thjesht, bëhej një ambientim social duke thyer moshat, ngjyrat, racat, bindjet, pasanikët, varfanjakët, të fuqishmit, të dobët, liderët dhe njerëzit e zakonshëm. Fëmijët

Xhamia ishte vendi kryesor për formimin e personalitetit të fëmijëve, si njerëz, si prindër, si punëtor, si luftëtar. Aty edhe arsimoheshin me dije të ndryshme, varësisht nga ligjëruesi, por edhe prirja e tyre.

radhiteshin në rreshta në namaz, bëheshin pjesëmarrës si dëgjues të bisedave të të rriturve për tregti, bujqësi, blegtori, përgatitjet për luftë etj..⁶

Me fëmijët duhet të punohet sinqerisht dhe thellësisht. Sjellja jonë e tërbuar dhe e ngurtë, do t'i largojë nga ne, do t'i largojë nga xhamia dhe Kurani. Mos ndjekja e Muhamedit a.s. në edukim do të na asimilojë në popull që meriton ndëshkimin. Mos ndjekja e rrugës së Pejgamberit të Allahut a.s. është shtypja e fëmijëve, shkelja e dinjitetit të tyre, dëbimi nga vetja, dashuria e devijuar. Ata që pengojnë fëmijët në xhami, duhet të mendojnë se fëmijët i pret alternativa tjetër, rruga, alkooli, prostitucioni, pijet narkotike, mashtrimi, vjedhja, korrupsioni dhe shumë marifetllëqe që po i përjeton tashmë edhe koha jonë. Fëmijëve duhet t'i japim rast të rriten mirë, të arsimohen e edukohen, ta dëshmojnë veten në përgjegjësitë që do t'ua besojmë konform moshës së tyre. Bërja e tyre pjesë e familjes, e bashkësisë, i bën ata të ndërgjegjshëm, të kalitur dhe potencialisht të aftë t'i marrin përgjegjësitë e tyre kur të rriten.⁷

Fëmijët ndonjëherë edhe shfaqin çapkënlleqe, tregojnë çaste jo fortë të mira për ambientin e xhamisë, por largimi nga xhamia si parim, është i papranueshëm. Të mos harrojmë, xhamia është Shtëpi e Zotit, dhe edhe vetë ne jemi mysafirë në të, andaj si e largojnë dikë nga shtëpia e huaj, sidomos fëmijët, brezin e ardhshëm, xhematin e 5-6 dekadave të ardhshme. Së pari imami i xhamisë, pastaj edhe xhematlinjtë më të rregullt dhe familja duhet të jenë shtylla të edukimit të fëmijëve. Njëra ndër veprimet e para është durimi ndaj fëmijëve, sepse as ne të rriturit nuk jemi engjëj dhe kemi dobësitë tona. Së dyti, duke i afruar e duke iu dhënë afërsi, ata i përvetësojmë. Pastaj, duhet t'i marrin në namaze të shkurtra, në tubime ku ata nuk do të bezdisen dhe gjithnjë të jenë nën kujdesin e të rriturve.⁸

Këshilla jonë që fëmijët duhet të jenë në xhamia nuk nënkupton që ne t'i marrim në xhami edhe foshnjat, edhe fëmijët krejt të vegjël, të cilët do të qajnë, do të bëjnë zhurmë. Xhamia nuk është çerdhe, e as kënd lojërash. Nuk do të preferonim që në xhami të sillen fëmijët më të vegjël se pesë vjet. Duhet ta kemi parasysh si prindër edhe llojin e fëmijës. Ata fëmijë që janë të urtë, nuk ka problem, mund ta vizitojnë xhaminë, por ata fëmijë që janë të gjallë, pak edhe të mbrapshtë, lozonjarë, duhet t'i frenojmë dhe me punë më të veçantë t'i përgatisim për xhami. Hadithi i cili thotë: "Shmangini fëmijët tuaj nga xhamitë tuaja", është hadith specifik, që rregullon një rast dhe një çast, ose një kategori fëmijësh, e jo si parim në përgjithësi.⁹

Në vazhdim do t'i cekim edhe dy hadithe, edhe si ilustrim, edhe si provë, por edhe si përfundim se si duhet të sillemi në rastin tonë, ose si shoqëri:

1. Sheded i r.a., ka thënë: "Doli te ne i Dërguari i Allahut a.s. në një prej dy namazeve, në atë të drekës apo ikindisë, duke mbajtur Hasanin ose Husejnin (dy djemtë e vegjël të Fatimes r.a., vajzës së Pejgamberit a.s.). Pejgamberi a.s. erdhi dhe e vendosi fëmijën te këmba e tij dhe pastaj mori tekbinin fillestar për namaz, u fal dhe kur ra në sexhde e zgjati sexhden. Unë e ngrita kokën ndër njerëz dhe pashë një fëmijë të vogël mbi shpinën e të Dërguarit të Allahut a.s., ndërkohë që ai gjendej në sexhde. Menjëherë u ktheva në pozicionim tim në sexhde. Kur i Dërguari i a.s. e kreu namazin, njerëzit thanë: "O i Dërguar i Allahut! Bëre një sexhde të cilën e zgjate aq sa ne menduam se të ka ndodhur diçka ose se po të zbriste shpallje hyjnore." Pejgamberit a.s. tha: "Asgjë nga kjo e gjitha nuk ka ndodhur, porse djali im ishte i hipur mbi mua dhe nuk preferova ta ngucja derisa ta bënte atë që donte."¹⁰

2. "I Dërguari i Allahut a.s. po falej dhe kur binte në sexhde, Hasani dhe Husejni, i kërcenin në shpinë. Nëse njerëzit i pengonin ata të dy, Pejgamberi a.s. ua bënte njerëzve me shenjë që t'i linin. Pasi e mbaroi namazin, ai i mori ata të dy në prehër."¹¹ Hadithe të tilla ka përplot.¹²

1 Është i llahtarshëm lajmi nga OBSH 2020 kur pohon se shumica e të vdekurve nga Korona-Virusi në Perëndim janë pleq nga azilet. Shiko: <https://a2news.com/2020/04/23/obsh-gjysma-e-viktimave-ne-evrope-jetonin-ne-azil/>; Gjithashtu: <https://www.flashnews.al/e-frikshme-nuk-vdesin-ne-spitale-shumica-e-viktimave-te-koronavirusit-jane-shenuar-ne-keto-qendra/>.

2 Buhariu, *Sahih*; Muslimi, *Sahih*.

3 Imam Buhariu, *Sahih*.

4 Imam Buhariu, *Sahih*.

5 Shiko: <https://muhamedsytari.net/?p=2398>.

6 Janë të mrekullueshme fjalët e dr. Mehmet Gormez, derisa ishte kryetar i Bashkësisë Islame në Turqi: "Zëri i fëmijëve në xhami nuk është zhurmë, por është begati e Allahut." Gjithashtu dr. Gormez tha: "Atyre që iu pengon zhurma e fëmijëve në xhami, lirisht le të falen në shtëpi."

7 Vendimi mbi sjelljen e fëmijëve në xhami, në: <http://www.revista-familja.com/vendimi-mbi-sjelljen-e-femijeve-ne-xhami/amp/>.

8 Sipas: <https://semerkand.ba/za-procitati/magazin/br-104/mali-gosti-allaha-dz-s/>.

9 Vendimi mbi sjelljen e fëmijëve në xhami, në: <http://www.revista-familja.com/vendimi-mbi-sjelljen-e-femijeve-ne-xhami/amp/>.

10 Nesaui dhe Hakimi, hadith i saktë.

11 Ibën Huzejme, hadithi i saktë.

12 Ebu Katade r.a., ka thënë: "E kam parë të Dërguarin e Allahut a.s. me Umemen, të bijën e Zejnebes, vajzës së të Dërguarit të Allahut a.s. të hedhur mbi supe. Kur ai binte në ruku e vendoste atë (në tokë) dhe kur ngrihej nga sexhdja e kthente sërisht (në supe)." (Buhariu, *Sahih* dhe Muslimi, *Sahih*. Hadith i saktë.) I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Unë hyj në namaz duke dashur ta zgjas atë, por në ndërkohë dëgjoj të qarat e fëmijës së vogël dhe bëj lehtësime në namazin tim pasi e di lëndimin e madh që ndien nëna për shkak të qarjes së të voglit të saj." (Buhariu, *Sahih*, Hadith i saktë.)

Suksesi i femrës së mbuluar si përgjigjja më e mirë për paragjykimet ndaj saj

Nada Dosti

Në një botë ku shpesh vlerësohet më shumë pamja sesa thelbi, dhe ku bindjet fetare paragjykojnë si kufizime, gruaja me hixhab vazhdon të shihet me sy dyshues (për aftësitë e saja) ose paragjyket. Edhe pse jemi në vitin 2025, ende në ditët e sotme gruaja muslimane shihet si një figurë në mos pasive, jo e fuqizuar, përkundër

simotrave të saj. Dikur diskursi sillej rreth faktit se ishte pasive, nuk ishte e përfshirë në jetën publike, nuk ishte prezente në media apo nuk amplifikohesh zëri i saj në aktivizmin e shoqërisë civile. Sot, më aktive se kurrë, më e pranishme se kurrë ajo ende paragjyket për çdo lloj vendimi që ajo merr dhe për çdo fjalë që thotë. Dhe kjo, nuk ka të bëjë shumë me pozicionimin që ajo zgjedh, por ka të bëjë thjesht me një neuron të pranishëm në trurin e paragjykesëve i cili është gjithmonë aty gati për të ndërmarrë verdikte.

MBULESA: ZGJEDHJE ME VETËDIJE DHE BESIM

Pavarsisht çfarë jemi mësuar të shohim nëpër filma, apo çfarë realisht ndodh nëpër shoqëritë patriakale që në disa raste kanë qëlluar të jenë dhe shoqëri muslimane, të mbuloresh në Islam nuk është as shenjë nënshtrimi e as imponim. Është një vendim i thellë, që lind nga dashuria dhe respekti për Zotin. Shumë vajza e gra që mbulojnë kokën, e bëjnë (ose duhet ta bëjnë) këtë me bindje të plotë, si një mënyrë për të treguar besimin dhe vlerat që bartin. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: “O Profet! Thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve, të lëshojnë mbi trupin e tyre mbulesat e tyre. Kjo

Të mbuloresh në Islam nuk është nënshtrim. Është një vendim i thellë, i lindur nga dashuria dhe respekti për Zotin.



është më e përshtatshme që ato të dallohen dhe të mos shqetësohen.” (*el-Ahzab*, 59)

Pra, hixhabi nuk është (ose nuk duhet të jetë) një kufi, por është një zgjedhje personale që pasqyron identitetin dhe bindjen. Në librin e saj “Duke rimenduar Gratë muslimane dhe mbulesën: Sfida ndaj stereotipeve historike dhe moderne” Katherine Bullock liston arsye të ndryshme të grave nëpër botë se përse ato e vendosin hixhabin, përkatësisht shtatë arsye kryesore, ku vetëm dy prej tyre janë arsye disi të imponuara nga normat (arsye zakonore) dhe ligji (kërkesat ligjore të vendit përkatës), por kjo përsëri mbetet një pakicë pra nuk mund të merret si normë por si përjashtim, edhe pse në Perëndim shitet si arsyeja kryesore.

Nga ana tjetër lind pyetja: a është suksesi i një gruaje muslimane e ndërlikuar me hixhabin, dhe nëse po a është pasojë apo faktor? Kjo ndoshta varet nga individi në individ dhe nga kushtet dhe rrethanat që ky individ vepron, pra: nëse për të arritur diçka në jetë, për të realizuar ëndrrat dhe qëllimet e saja, një grua muslimane i duhet të punojë dhjetëfish se sa një grua pa hixhab në një shoqëri diskriminuese atëherë suksesi vjen si pasojë e përpjekjeve të shumta dhe punës së vazhdueshme. Në rrethana të kundërta, një grua me hixhab e cila i përkushtohet fesë së saj, si parim fetar ka

Sipas studiueses Katherine Bullock, vetëm 2 nga 7 arsye që gratë përmendin për vendosjen e hixhazit janë të ndikuara nga ligji apo zakonet – shumica e bëjnë këtë me bindje të lirë dhe personale.

zbatimin e filozofisë profetike e cila na nxit që punën që e bëjmë ta bëjmë në formën më të duhur dhe më të mirë të mundshme. E duke e disiplinuar veten me këtë lloj botëkuptimi, suksesi nuk ka se si mos të vijë. Por mund të ndodhin edhe të dyja bashkë, pra të punuarit fuqishëm sepse rrethanat konkurruese të detyrojnë ta bëshë atë, dhe njëkohësisht të punuarit fuqishëm sepse feja na nxit për një punë të tillë, dhe kjo e fundit do të ishte idealja.

PARAGJYKIMET DHE SFIDAT

Në shumë vende të botës, edhe në ato që shfaqen si më demokratike e mendjehapura si dhe të barabarta, gruaja e mbuluar përballet me gjykime dhe përjashtime. Në punë, në shkollë, në jetën publike. Shpesh përshkruhet si e shtypur, e prapambetur. Madje media dhe zëra islamofobë e shfrytëzojnë imazhin e saj për të ushqyer stereotipe negative. Dhe kjo, pa e njohur as jetën, as përpjekjet, e as vlerat e saj. Kufizimet ligjore në arsimim apo punësim ende prezente në disa realitete të trojave tona, e kthejnë çështjen e hixhazit në një sfidë për ato që e mbartin. Shtu këtu paragjykimet, stereotipizimet dhe islamofobinë.

Por realiteti i përditshëm e thyen këtë paragjykim. Sot kemi gra të mbuluara që janë në të gjitha sferat e jetës dhe të karrierës... Të gjitha me suksese të admirueshme. Të tilla nuk janë vetëm të suksesshme për veten e tyre, por janë edhe shembuj të fuqishëm për të tjerët, shembuj që tregojnë se besimi nuk të ndalon, përkundrazi, të jep forcë.

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “Kush ndjek një rrugë për të kërkuar dije, Allahu do t’ia lehtësojë atij rrugën drejt Xhenetit.” (*Muslim*, 2699)

Për shumë prej grave me hixhab, mbulesa nuk është pengesë, por pikënisje. Është një pjesë e identitetit që u jep qëndrueshmëri në botën e sotme të pasigurt. Dhe në vend që të shihen si të përjashtuara, duhet të shihen si gra të forta që ecin përpara me bindje e përkushtim. Por a ka qenë hixhabi pengesë për të tjerët? Pra për ta punësuar; për t’i dhënë një pozicion lidhësi, apo për t’i drejtuar mikrofonin një gruaje me shami?



Po ka qenë. Pra thellë thellë hixhabi është pengesë, por jo për personin që e mbart por për të tjerët që i qasen me paragjykim. A është vendimi për të mbajtur hixhabin një sfidë më vetë? Po është, dhe ndoshta do vazhdojë të jetë. Por si të gjitha sfidat e tjera janë vetëm një mënyrë për të na kalitur dhe ridrejtuar drejt asaj për të cilën jemi destinuar të pozicionohemi.

HIXHABI: PJESË E QENIES, JO KUFIZIM

Hixhabi nuk është vetëm një copë pëlhurë në kokë. Është një zgjedhje që i jep kuptim jetës. Gruaja që mbulohet, e bën këtë jo për të fshehur veten, por për ta treguar atë që ka më të shtrenjtë: vlerat, mendimet, moralin.

Ajo mbështetet në fjalët e Allahut që thotë: “Thuaju besimtareve të ulin shikimin e tyre dhe të ruajnë nderin e tyre dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre...” (en-Nur, 31)


Kur një grua e mbuluar shkëlqen në profesionin e saj, sillet me ndershmëri, me urtësi, me dije: ajo nuk ka nevojë të mbrohet me fjalë. Sepse vepra e saj është argument më i fortë se çdo shpjegim.

ISLAMI DHE FUQIZIMI I GRUAS

Islami nuk e kufizon gruan: Islami e nderon atë. Historia islame është e mbushur me emra grash që kanë kontribuar në dije, në shoqëri, në familje, në besim. Prej Hazreti Hatixhes, një grua tregtare-sipërmarrëse, e pasur dhe mbështetëse e Profetit, e deri te Hz. Aishja, dijetarja që transmetoi më shumë se 2000 hadithe. Duke pasuar me dhjetra dijetare të tjera, shkencëtare e filantrope të cilat kanë themeluar univeristete, xhami; medrese dhe vakëfe të ndryshme si çezma, spitale, menza për të varfërit etj. Gruaja e mbuluar nuk është grua e mbyllur, por është grua që ecën me besim në rrugën që ka zgjedhur. Në një kohë kur shoqëria po përballlet me rrënimin e vlerave morale, ajo është një kujtesë e gjallë për pastërtinë, qëndrueshmërinë dhe sinjeritetin.

Përveç një pasqurimi të realitetit perëndimor sjellur nga Katherin Bullock, në hulumtimin e saj, “Identitetet femerore, feministe dhe muslimane. Kontekstet post-socialiste në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë” autorja Zilka Spahić-Šiljak e sqaron shumë mirë lidhshmërinë e islamit me fuqizimin e gruas sidomos në realitet ballkanasë veçanërisht në Kosovë dhe BeH. “Me pozicionimet e tyre të shumëfishta

Gruaja e mbuluar që përparon me dinjitet, që arrin me mund dhe dije, është përgjigjja më e mirë ndaj atyre që paragjykojnë. Ajo nuk është e shtypur: ajo është e përkushtuar. Ajo nuk është e kufizuar, por e lirë në besimin e saj.



si muslimane, feministe, aktiviste, si dhe mbrojtëse të të drejtave të njeriut, shumica e këtyre grave e perceptojnë Islamin si fe përfshirëse që nuk i kuizon ato, por iu jep liri dhe paqe të brendshme. Për gratë praktikuese që mbajnë mbulesë, është pjesë e identitetit të tyre, shenjë e devotshmërisë dhe paqes së tyre të brendshme, e përfundimisht edhe diçka që i çliron dhe i fuqizon të jenë aktive dhe të angazhuara në publik.” shprehet ajo.

Nuk ka nevojë për fjalë të shumta kur vepra flet vetë. Gruaja e mbuluar që përparon me dinjitet, që arrin me mund dhe dije, është përgjigjja më e mirë ndaj atyre që paragjykojnë. Ajo nuk është e shtypur: ajo është e përkushtuar. Ajo nuk është e kufizuar por e lirë në besimin e saj.

Dhe pikërisht kjo është fuqia e saj më e madhe, dhe suksesi i saj përgjigjja më e mirë për paragjykimet ndaj saj.

Rinia dhe identiteti islam në kohën e rrjeteve sociale

Armida Plumbi

Ballafaqohemi me fenomenin e imitimit të tjerëve dhe shkrirjen e vlerave autoktone pa vetëdije, ndërkaq imitimi symbyllazi në çështjet jo produktive është dukuri negative e cila synon tjetërsimin e njeriut dhe sjell dëme të ndryshme për individët dhe shoqëritë.

Të rinjtë kanë qenë gjithmonë bartësit e thirrjeve të të dërguarve të Allahut xh.sh.. Shumë prej shokëve të Pejgamberit a.s. kanë qenë të rinj. Më i madhi prej tyre ishte Ebu Bekri r.a., i cili, kur e pranoi Islamin, ishte në moshën 38 vjeçare. Në mesin e tyre ka pasur edhe të rinj që nuk kishin mbushur as dhjetë vjeç, si Ali ibën Ebu Talibi r.a..

Ishin të rinjtë ata që e mbështetën dhe e ndihmuan Islamin, e përkrahën Pejgamberin a.s. dhe qëndronin pranë tij kundër atyre pleqve që nuk dëshironin të braktisnin rrugën që e kishin ndjekur të parët e tyre. Prandaj, nuk është çudi që në ditët e sotme e

gjejmë se shumica e atyre që e bartin misionin e Islamit, të jenë të rinj.

Koha në të cilën jetojmë me plotë të drejtë do të mund të cilësohet periudhë e luftës së njeriut për ta gjetur vetveten dhe për ta mbajtur në jetë origjinalitetin e vet, ngase mjetet e komunikimit bashkëkohor sa kanë anë pozitive, aq ndikojnë edhe negativisht duke u mundësuar elementeve djallëzore destruktive njerëzore që ta ushtrojnë ndikimin dhe influencën e vet mbi njerëzit dhe shoqëritë, ashtu që do të formojnë nga propagandat e tepërta dhe të vazhdueshme qenie njerëzore që nuk e njeh veten, e ka humbur identitetin dhe vrapon pas modës së





tjetrit pa diskutuar fare për dobinë ose jo të asaj që imiton.

Pra, thënë shkurt dhe qartë ballafaqohemi me fenomenin e imitimit të tjerëve dhe shkrirjen e vlerave autoktone pa vetëdije, ndërkaq imitimi symbyllazi në çështjet jo produktive është dukuri negative e cila synon tjetërsimin e njeriut dhe sjell dëme të ndryshme për individët dhe shoqëritë.¹

Të rinjtë myslimanë në epokën digjitale po përjetojnë si mundësi, ashtu edhe sfida. Mediat sociale dhe platformat online ofrojnë qasje në njohuritë fetare, nxisin lidhjet brenda komunitetit global mysliman dhe ofrojnë rrugë për aktivizëm dhe angazhim shoqëror. Megjithatë, ato gjithashtu përballen me çështje si ekspozimi ndaj përmbytjes negative, dezinformimit dhe presionit për të pajtuar vlerat islame me trendet online dhe pritjet shoqërore. Epoka digjitale ka transformuar mënyrën se si të rinjtë myslimanë lundrojnë në besim, identitet dhe komunitet.

Ja një vështrim më i detajuar:

MUNDËSITË

Mësim i përmirësuar fetar:

Platformat digjitale ofrojnë qasje në një gamë të gjerë burimesh islame, duke përfshirë leksione shkencore, tekste dhe mjete mësimore interaktive, duke lejuar një angazhim më të thellë me besimin.

Mediat sociale lidhin të rinjtë myslimanë përtej kufijve gjeografikë, duke nxitur një ndjenjë përkatësie dhe solidariteti brenda komunitetit global mysliman (ymetit).

Ndërtimi i komunitetit global:

Mediat sociale lidhin të rinjtë myslimanë përtej kufijve gjeografikë, duke nxitur një ndjenjë përkatësie dhe solidariteti brenda komunitetit global mysliman (ymetit).

Daveti digjital:

Platformat online ua mundësojnë myslimanëve të rinj të ndajnë besimin e tyre dhe të angazhohen në diskutime rreth Islamit me një audiencë më të gjerë, duke promovuar mirëkuptimin dhe dialogun.

Aktivizimi social:

Interneti i fuqizon myslimanët e rinj të marrin pjesë në aktivizmin shoqëror dhe politik, duke rritur ndërgjegjësimin për çështjet që prekin komunitetet e tyre dhe duke avokuar për ndryshime pozitive.

Sipërmarrja digjitale:

Programet që kombinojnë aftësitë teknike me udhëzimin islamik po i pajisin të rinjtë myslimanë me mjetet për të lundruar në ekonominë digjitale në mënyrë etike dhe efektive.

SFIDAT

Dezinformimi dhe ekstremizmi:

Përhapja e lajmeve të rreme dhe ideologjive ekstremiste në internet paraqet një sfidë të rëndësishme, që potencialisht çon në konfuzion dhe kequdhëzim.

Ekspozimi ndaj përmbajtjes negative:

Të rinjtë myslimanë hasin përmbajtje të papërshtatshme, duke përfshirë pornografinë dhe gjuhën e urrejtjes, të cilat mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien e tyre mendore dhe emocionale. Varësia lidhet me ndjenjën e fajit, depresionin dhe dobësimin e imanit (besimit).

Lundrimi i mesazheve kontradiktore:

Bota digjitale paraqet një peizazh kompleks idesh dhe narrativash konkurruese, duke e bërë sfiduese për të rinjtë myslimanë që të pajtojnë besimin e tyre me trendët në internet dhe presionet shoqërore.

Shqetësimet për shëndetin mendor:

Përdorimi i tepërt i mediave sociale mund të kontribuojë në ankth, depresion dhe probleme të tjera të shëndetit mendor, veçanërisht kur kombinohet me presionin për të ruajtur një personalitet të përsosur në internet.

Balancimi i traditës dhe modernitetit:

Të rinjtë myslimanë përballen me sfidën e integritetit të vlerave të tyre islame me realitetet e epokës digjitale, duke lundruar në pritjet kulturore dhe normat shoqërore.

Identiteti dhe vetëvlerësimi online:

Natyrë e kuruar e profileve online dhe presioni për t'u përshtatur me trendët online mund të ndikojnë negativisht në vetëvlerësimin dhe formimin e identitetit.

Shqetësime për privatësinë:

Sasia e madhe e të dhënave të mbledhura online ngre shqetësime në lidhje me privatësinë dhe sigurinë për të rinjtë myslimanë, veçanërisht në dritën e mbikëqyrjes në rritje dhe shkeljeve të të dhënave.

Ndërveprimet jo-mahram: Tabu digjitale

Mediat sociale i turbullojnë kufijtë midis gjinive. Dërgimi i mesazheve në DM, duetet në TikTok dhe përgjigjet në historitë e Instagram shpesh çojnë në marrëdhënie jo-mahram (të ndaluara nga Islami). Një sondazh i vitit 2024 zbuloi se 41% e adoleshentëve myslimanë janë angazhuar në biseda private me të huaj të gjinisë së kundërt.

Identiteti i dyfishtë digjital: Vetja e kuruar vs. autentike

Të rinjtë myslimanë shpesh i ndajnë identitetet e tyre online dhe offline. Për shembull, Aisha, një studente 19-vjeçare kolegji, ndan këshilla modeste për modën në Instagram, por fsheh hixhabin e saj në rrjetet sociale në Snapchat për të shmangur paragjykimet në vendin e punës. Ky dualitet nxit ankthin, pasi algoritmet i japin përparësi angazhimit mbi autenticitetin.

Hibriditeti kulturor: Balancimi i botëve të shumëfishta

Të kapur midis pritjeve tradicionale familjare dhe normave laike perëndimore, shumë prej tyre përqafojnë një identitet të "kulturës së tretë". Platforma si TikTok e amplifikojnë këtë

hibriditet, me krijues si @DeenAndDunya që përziejnë kujtesat islame me humorin e kulturës pop.²

ADRESIMI I SFIDAVE**Njohuri kritike mediale:**

Zhvillimi i aftësive të të menduarit kritik dhe njohurive mediale është thelbësor për të lundruar në peizazhin digjital dhe për të dalluar informacionin e besueshëm nga dezinformimi.

Promovimi i përmbajtjes pozitive online:

Krijimi dhe ndarja e përmbajtjes pozitive, informuese dhe tërheqëse që pasqyron vlerat islame është thelbësore për të kundërshtuar ndikimet negative.

Mbështetja e shëndetit mendor:

Ofrimi i aksesit në burimet e shëndetit mendor dhe sistemet e mbështetjes të përshtatura për nevojat unike të të rinjve myslimanë është jetik.

Udhëzimi dhe edukimi prindëror:

Komunikimi i hapur midis prindërve dhe fëmijëve në lidhje me sigurinë online, përdorimin e përgjegjshëm të mediave sociale dhe rëndësinë e të qëndruarit të lidhur me besimin është thelbësor.

Angazhimi i komunitetit:

Forcimi i rrjeteve të mbështetjes së komunitetit dhe nxitja e ndërveprimeve pozitive brenda komunitetit mysliman mund t'i ndihmojë të rinjtë të përballojnë sfidat dhe të ndërtojnë rezistencë.

Kornizat etike:

Integrimi i parimeve islame në arsimin digjital dhe promovimi i udhëzimeve etike për sjelljen online mund t'i ndihmojë të rinjtë myslimanë të marrin vendime të informuara dhe të përgjegjshme.

Rinisë myslimane në epokën moderne të rrjeteve sociale i takojnë disa përgjegjësi dhe detyrime:

- Mbrojtja e identitetit mysliman

Përgjegjësia e parë është që të vazhdojnë ta mbrojnë identitetin e tyre mysliman, ta ruajnë ekzistencën e tyre islame dhe të mos shkrihen në këtë shoqëri, të humbasin veten dhe ta dëmtojnë ekzistencën e tyre. Çfarë vlere ka, nëse merr ndonjë titull shkencor, e i humb shkallët e larta tek Allahu xh.sh.? Asgjë s'ka vlerë nëse nuk e mbrojmë identitetin islam: duke u falur, duke dhënë zekatin, duke agjëruar, duke hequr dorë nga të ndaluarat (haramet), duke u kujdesur për fenë kudo ku jemi. Allahu adhurohet në çdo vend: "Frikësoju Allahut kudo që të jesh". (Tirmidhiu nga Ebu Dherri r.a. dhe Muadh ibën Xhebeli r.a.).

- Mbrojtja e familjes dhe e pasardhësve

Nuk kërkohet ta mbrosh identitetin tënd mysliman vetëm për vete, por, nëse je i martuar, duhet ta mbrosh identitetin edhe të familjes sate. Mbroje dhe ki kujdes për Islamit dhe identitetin e gruas sate e të fëmijëve tu, nëse ke fëmijë. Mos



lejo që fëmijët tu të asimilohen e të treten në shoqëri, ashtu siç tretet akulli nën rrezet e diellit. Allahu xh.sh. thotë: *“O ju që besuat, ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët”* (Et Tahrim, 6).

Kam lexuar sesi një njeri e kishte studiuar Islamin dhe kishte lexuar për të, e pastaj e kishte thënë këtë fjalë: *“Sa fe e bukur qenka kjo, sikur të kishte burra!”* Dëshirojmë të kemi burra si sahabët për Islamin, dëshirojmë sahabë të rinj që e bartin bindjen dhe guximin e sahabëve, vendosmërinë dhe shpirtmirësinë e tyre.

E kush janë sahabët? Ata janë njerëz të ngjashëm me ne. Dallimi ndërmjet nesh dhe atyre është se ata janë rritur në politeizëm e injorancë të çiltër, ndërsa ne jemi rritur në shoqëri islame. Obligimi ynë është që t'i imitojmë ata, t'u ngjajmë atyre, dhe sërish ta ndihmojmë Islamin, e ndoshta do të kemi shpërblim më shumë se kanë pasur shumë nga sahabët, edhe pse së kemi pasur fatin ta shihnim të Dërguarin e Allahut xh.sh. ashtu siç kanë qenë të nderuar ata që e kanë parë, dhe ndoshta kjo do të na bëjë dobi.³

-Interesimi dhe kujdesi për çështjet e myslimanëve

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër” (El Huxhurat, 10).

Obligimi ynë është që ta dimë se ne nuk mund ta mbrojmë identitetin tonë dhe të familjeve tona, as të kryejmë thirrjen tonë, e as t'u ndihmojmë vëllezërve tanë, nëse çdonjëri nesh jeton për vetveten, i pavarur dhe i veçuar prej të tjerëve. Jo, nuk mund të punosh vetë, e as mund ta mbrosh vetë Islamin tënd, se do të të gëlltitë rryma e do të të hedhë në këtë det të madh, do të jesh i tretur (i asimiluar) dhe i zhdukur.

Islami ka qenë këmbëngulës në largimin e rinisë nga çdo gjë që e njollos personalitetin dhe e zhduk identitetin e saj. Me një fjalë, Islami punon në drejtim të përqendrimit të rinisë në atë që është burimore dhe autoktone si dhe e arsyeshme, dhe e qorton atë person që imiton diçka pa dije dhe analizë të mirëfilltë të dukurisë përkatëse.

Misioni i Pejgamberit të fundit të Allahut, Muhamedit a.s. ka qenë jetësimi më i qëlluar i luftës kundër imitimit dhe humbjes së vlerave autoktone. Kështu, Pejgamberi a.s. nuk u ndikua nga klima ekzistuese dhe dominuese në atë kohë në aspektin ideor, siç ishte zhytja e njeriut të atëhershëm në idhujtari dhe injorancë, nuk u pengua që t'i thërrasë njerëzit në besimin e pastër të Tevhidit dhe flakjes së paditurisë e injorancës së të gjitha ngjyrave.

Mustafa Tahhan ka thënë: *“Bojkoti i qytetërimit modern paraqet një humbje tejet të madhe. Krahës kësaj, edhe rrëshqitja në humnerat e tij konsiderohet humbje tejet e madhe. I riu i arsimuar dhe mendjemprehtë arrin që ta ketë të qartë mesataren në fenë e tij. Ai, në mënyrë konsekuente kujdeset për personalitetin e tij islam, e në të njëjtën kohë arrin të përfitojë dobi nga zhvillimet dhe arritjet më moderne të qytetërimit modern.”*⁴

Kultivimi i vlerave autoktone kulturore dhe mos imitimi i tjerëve ka qenë përcaktim parimor i gjeneratës së parë dhe më të ndritshme të Islamit, shokëve të të Dërguarit të Allahut, të cilët çdoherë në arenën ndërkombëtare u shfaqën me vlerat dhe kulturën origjinale nga Kurani dhe Suneti, por kjo nuk ka qenë rezultat i mosekzistimit të civilizimit botëror që do të mund të imitohej, siç mund të paragjykojnë shumë, por kjo ka qenë fryt i vetëdijes së lartë fetare dhe kuptimit të drejtë të Islamit.

1 <https://www.islamgjakova.daku-media.com/artikulli.php?id=3742>

2 <https://www.islamicity.org/104380/7-critical-challenges-facing-muslim-youth-in-the-digital-age-and-how-to-overcome-them/>

3 “Predikimet e Shejh El Kardavit”, përgatitur nga Halid Essa'd, Mektebetu Vehbeh, Kajro, 2001, vëllimi IV, f. 214-227.

4 “Aftësimi edukativ Islam”, f. 226.

Të ushqyerit e shëndetshëm gjatë ditëve të verës

Nderim Rexhepi, nutricionist
Urata Rexhepi, nutricioniste,
Agron M. Rexhepi, MD, PhD, MSc

Ditët me temperatura të larta gjatë stinës së verës na imponojnë që të ndryshojmë dhe të adaptojmë menynë tonë ditore të të ushqyerit. Është më se e sigurt se gjatë këtyre ditëve të nxehta organizmi ynë nuk ka nevojë për marrjen e ushqimeve hiperkalorike – hiperenergjetike dhe që treten vështirë (yndyrat, mishi i kuq, ëmbëlsirat). E një rëndësie primare gjatë ditëve të nxehta të verës është të bëhet hidratimi i rregullt i organizmit (marrja e sasisë së mjaftueshme të lëngjeve) dhe marrja e ushqimeve që lehtë treten dhe absorbohen nga organizmi.

Pas oksigjenit, sigurisht se uji është elementi më i rëndësishëm dhe esencial për jetën e njeriut – përderisa pa ushqim (vetëm me ujë) njeriu mund të jetojë mbi 55 ditë pa ndonjë problem shëndetësor, pa ujë njeriu nuk mund të jetojë më shumë se disa ditë.

Vetë fakti se 75% e sipërfaqes së Tokës përbëhet nga uji (oqeanet, detet, liqenet, lumenjtë), respektivisht 2/3 apo 55


– 70% të peshës trupore të njeriut përbëhet nga uji tregon për rëndësinë e këtij elementi (nutrienti) për ekzistencën e njeriut. Me kalimin e moshës, p.sh. te mashkulli i moshës 60 vjeçare, për shkak të zvogëlimit të masës muskulore dhe shtimit të masës dhjamore, zvogëlohet sasia e përgjithshme e ujit të trupit në vetëm 50% të peshës trupore.^(3,4)

Rëndësia e ujit për organizmin e njeriut është e shumëfishtë:
termorregullues i organizmit;
eliminim produktet e fundit përmes veshkave;
siguron lëvizshmërinë e trupit (sasia e ujit në nyjëtime-artikulacione);

përbën pështymën, ndihmon tretjen e ushqimit, ndihmon absorbimin e materieve ushqyese nga zorrët, si dhe lehtëson largimin e produkteve të fundit nga zorrët, duke penguar zhvillimin e kapsllëkut;

furnizon qelizat me materie ushqyese dhe me oksigjen;
të gjitha proceset biokimike ndodhin në ambient ujor;
mban tonusin e muskujve dhe të lëkurës, si dhe zvogëlon dhimbjen e muskujve gjatë dhe pas aktiviteteve fizike;
Sasia e mjaftueshme e ujit në organizëm e mbron organizmin nga shumë sëmundje.

Nëse brenda ditës pihen deri tetë gota ujë, për 45% zvogëlohet mundësia e paraqitjes së kancerit të zorrës së trashë, ndërsa për 50% zvogëlohet mundësia e paraqitjes së kancerit të fshikëzës së urinës. Po ashtu, zvogëlohet mundësia e dëmtimit të veshkave dhe e shfaqjes së kokëdhimbjes, ndërkaq, sipas disa hulumtimeve, sasia e mjaftueshme e ujit



zvogëlon edhe mundësinë e paraqitjes së kancerit të gjirit;⁽⁴⁾

Sasia e nevojshme ditore e organizmit për lëngje varet nga disa faktorë, siç janë: rritja dhe zhvillimi i organizmit, gjinia, lloji i ushqimit që konsumohet, gjendja psikike, dhe niveli i aktiviteteve fizike ditore.⁽⁴⁾

Vlerësohet se afërsisht 75-80% të njerëzve kanë humbje të lehtë dhe kronike të lëngjeve të organizmit (dehidrim të shkallës së lehtë). Zvogëlimi i sasisë së lëngjeve në organizëm për 2% të peshës së përgjithshme trupore, mund të ketë efekt dëmtes për organizmin (ndjenjë e lodhjes gjatë ditës, ndjenjë e etjes, turbullimi i memories, vështirësi në fokusim për kryerjen e detyrave të thjeshta p.sh. matematikore, pengim i dritës, kokëdhembje, dhe marramendje). Zvogëlimi i sasisë së lëngjeve trupore për 4-5% zvogëlon aftësitë e organizmit për 20-30% për të kryer punë efikase, ndërsa ndikon të humbë 25-30% të energjisë së përgjithshme. Zvogëlimi i sasisë së lëngjeve trupore për 10% rrezikon seriozisht shëndetin e njeriut, ndërkaq mosmarrja e lëngjeve për disa ditë (më së shumti një javë) shkakton vdekjen e njeriut, respektivisht humbja e lëngjeve trupore për 11%, pa kompensim adekuat, do të shkaktojë vdekjen.

Se çfarë sasi të ujit duhet konsumuar që të arrijmë nivelin e duhur të lëngjeve në organizëm mund të bazohemi në disa masa orientuese të preferuara nga asociacione të rëndësishme botërore të nutricionistëve. Sipas Këshillit Australian për Hulumtime Mjekësore dhe për Shëndet Kombëtar, meshkujt e rritur, varësisht nga kushtet klimatike dhe niveli i aktivitetit fizik që bëjnë, duhet të pinë së paku 2.6 litra ujë, ndërsa femrat e rritura së paku 2.1 litra ujë në ditë.⁽³⁾ Propozim tjetër është të pihen të paktën 6-8 gota ujë brenda ditës, por si masë diçka më precize për marrjen e sasisë së mjaftueshme të ujit brenda 24 orëve preferohet sasia 30 ml ujë për kg të peshës trupore.⁽⁴⁾

Meqenëse shumë ushqime përmbajnë sasi të madhe të ujit, afërsisht 40% e sasisë ditore të ujit merret pikërisht nga këto ushqime të lëngëta. Gabim i madh do të ishte po që se tentohet që etja të shuhet me këto ushqime të lëngëta, të cilat, përveç ujit, organizmit do t'i

Zvogëlimi i sasisë së lëngjeve në organizëm për 2% të peshës së përgjithshme trupore, mund të ketë efekt dëmtes për organizmin (ndjenjë e lodhjes gjatë ditës, ndjenjë e etjes, turbullimi i memories, vështirësi në fokusim për kryerjen e detyrave të thjeshta p.sh. matematikore, pengim i dritës, kokëdhembje, dhe marramendje).



jepnin edhe sasi të tepërta të kalorive (gjë që nuk do të ndodhte nëse etja shuhet vetëm me ujë), me çka do të rrezikohet çrregullimi i peshës trupore (do të bëhej prishja e raportit ndërmjet energjisë hyrëse dhe energjisë dalëse). Po ashtu për arsye të njëjta nuk preferohet që etja të shuhet as me lëngje tjera të sheqerosura – çfarëdo qofshin ato. Rimbushja më e shpejtë dhe më efikase e organizmit me lëngje bëhet me ujë të thjeshtë, brenda një ore, nga zorrët, mund të absorbohen rreth 1000 ml ujë.⁽⁴⁾

Konform haditheve të të Dërguarit të Allahut Muhamedit a.s., për shuarje të etjes nuk preferohet të pihet uji i ftohtë, për arsye se do të vështirësonte tretjen e ushqimeve. Ndërkaq në freskinë 15-20 minutëshe që do ta ndienim pas pirjes së ujit të ftohtë, organizmi ynë në ftohjen momentale të brendshme do të bëjë reagim fiziologjik me rritje të qarkullimit të gjakut në vendet e ftohura dhe si rrjedhojë do të gjenerohet temperatura në ato vende deri në arritjen e vlerave normale apo edhe më shumë. Për qëllime rehidruese mund të preferohet pirja e çajrave të ndryshme të luleve (pa sheqer, ose në vend të sheqerit mund të përdoret mjalti).

Gjatë ditëve të nxehta ushqimi ditor duhet të jetë i rregullt, në sasi të paktë dhe i shpërndarë në tri racione kryesore (kujdes mëngjesin – mos ta lëmë anash në asnjë mënyrë) dhe dy shujta ndërmjetëse, dhe të përbëhet kryesisht nga drithërat, pemët dhe perimet (përmbajnë mineralet dhe elektrolitët që organizmi i nxjerr jashtë përmes djersitjes gjatë ditëve të nxehta), që mund të



konsumohen ashtu të freskëta apo të ziera, por në asnjë mënyrë të fërguara. Nga produktet e qumështit preferohet të përdoret kosi, jogurti dhe djathi i ri me pak yndyrë. Mishi i kuq, për shkak se përmban yndyra dhe proteina që më vështirë treten, mjafton të hahet një herë në javë apo edhe më rrallë, ndërsa mishi i shpezëve dhe i peshkut mund të hahen 2-3 herë në javë. Në përgjithësi, gjatë ditëve të nxehta të verës, duhet zvogëluar sasinë e mishrave, yndyrave dhe natriumit në menynë tonë të ushqimit për shkak të veprimit të tyre stimulues në rritjen e temperaturës trupore.⁽¹⁾

Pemët dhe perimet që nuk janë shumë kalorike, por që kanë efekt freskues dhe rehidruues për organizmin gjatë ditëve të verës janë: shalqiri, pjepri, dardhat, mollët, kumbullat, pjeshkat, trangujt, kungujt, domatet, specat, sallatat e gjelbra, etj.. P.sh. një kg shalqi që mbi 90% përmban ujë, jep afërsisht 300 kcal.^(5,6) Prania e shumë vitaminave dhe e mineraleve, e sidomos e kaliumit, në përbërjen e këtyre frutave bënë që këto ushqime të kenë veprim freskues dhe regjenerues në organizëm, si dhe fitim të një ndjenje “lehtësimi të organizmit”, e po ashtu ndihmojnë në mbarëvajtjen e punës së zemrës, mbajtjen e shtypjes së gjakut në kuadër të vlerave normale, funksionimin normal të sistemit nervor, sistemit osteo-muskulor, dhe sistemeve tjera të organizmit tonë.

Gjatë muajve të nxehtë nuk preferohet përdorimi i mëlmesave pikante për shkak të nxehtësisë së organizmit (rritet metabolizmi), ndërkaq aq sa ka mundësi duhet reduktuar pirjen e çajit të zi, kafes dhe koka-kollës, për shkak të veprimit të tyre të fuqishëm diuretik. Po ashtu preferohet të mos konsumohen pijet e gazuara dhe ato artificialisht të ëmbëlsuara.⁽²⁾ Sa për alkool dhe duhan, aty nuk ka asnjë dyshim rreth ndalesës së konsumimit të tyre. Të gjithë nutricionistët dhe punëtorët shëndetësor janë të një mendimi se organizmi i njeriut nuk është krijuar nga Krijuesi për të

metabolizuar alkoolin dhe duhanin, andaj me plotë të drejtë edhe trajtohen si toksina të jashtme me veprim të fuqishëm shkatërrues për organizmin.^(2,4)

Nëse veç dëshirojmë që ditëve të nxehta të freskohemi me akulllore duhet pasur kujdes që të përcaktohem për akulllore që për bazë kanë frutat e jo vezët (rreziku nga infeksioni alimentar, hiperkaloritë dhe kolesterolit).

Një porosi e përgjithshme kishte për të qenë që gjatë ditëve të verës të kemi shumë kujdes në marrjen e mjaftueshme të lëngjeve, të konsumojmë ushqime lehtë të tretshme dhe të lëngshme të bazuara kryesisht në drithëra, pemë, perime dhe produkte të lehta të qumështit, si dhe gjithsesi, gjithsesi dhe prapë gjithsesi ta bëjmë jetën sa më shumë fizikisht aktive. Ku të vije koha e pushimeve verore të mundohemi që ato pushime të jenë pushime aktive, që karakterizohen me lodhje fizike, por me relaksim shpirtëror, të ndihmuara me ushqyeshmërinë e shëndosh. Vetëm në këtë mënyrë më së miri do të mund ta “shkarkojmë” tërë stresin e grumbulluar gjatë përditshmërive tona dhe të arrijmë një ribalansim ideal të homeostazës sonë bio-psiko-sociale.

Referenca

- Best foods to beat the heat this summer. <http://www.foxnews.com/health/2013/06/19/best-foods-to-beat-heat-this-summer/>
- Food During Summer Season
- <http://makesmarter.hubpages.com/hub/Food-During-Summer-Season>
- Sports Nutrition Corner.
- <http://www.nismat.org/nutricor>
- Rexhepi A. Nutricioni dhe sportistët, Mozaiku, Prishtinë, 2010.
- Top 5 Healthiest Summer Vegetables. <http://www.fitday.com/fitness-articles/nutrition/healthy-eating/top-5-healthiest-summer-vegetables.html>
- Trimarchi M. 10 Foods for Great Summer Nutrition.
- <http://health.howstuffworks.com/wellness/food-nutrition/facts/10-foods-for-summer-nutrition.htm>

Autochthonous

Nuredin Nazarko

Historia e njerëzimit, është histori e lëvizjes së njeriut mbi sipërfaqen e tokës. Njeriu, si i huaj në të dhe me mallin për shtëpinë e parëhershme të humbur prej zbritjes në tokë, do të jepej pas përpjekjeve për të njohur shtëpinë e re të përkohshme. Lëvizja prej një vendi në tjetër ka qenë dhe mbetet një nga karakteristikat e pandryshueshme të njeriut. Edhe pse me kristalizimin dhe zhvillimin e jetës së qëndrueshme lëvizja u reduktua, sërish vazhdon të jetë prezente për arsye nga më të ndryshmet.

Jeta e qëndrueshme, zhvillimi teknik, zgjerimi i diturive prej një epoke në një epokë tjetër përgjatë historisë solli lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve, kristalizimin e popujve me gjuhë dhe tipare kulturore të dallueshme nga njëri-tjetri. Qytetërimet, pavarësisht shkallës së tyre të zhvillimit, kontributit në zhvillimet e shoqërisë njerëzore, mbartin karakteristika të cilat janë pasuri historike të popujve që i kanë krijuar, zhvilluar dhe ruajtur deri në ditët e sotme.

Qytetërimet janë ndërtuar mbi marrjen dhe dhënien. Lëvizja e njerëzve nuk është vetëm lëvizje në kërkim të të mirave materiale. Është edhe shkëmbim kulturor. Shkëmbim vlerash. Ndikim që merret apo çohet nga një vend, popull, kulturë dhe sillet ose çohet në vendin ku jeton. Nëse në ditët e sotme këto ndikime vijnë përmes teknologjisë, në të kaluarën historike ndikimet janë përcjellë përmes dyndjes së popujve, tregtisë, luftërave.

Në hapësirën mesdhetare ku gjenden historikisht shqiptarët, janë vendosur dhe kanë kaluar shumë popuj. Një nga popujt më të vjetër i vendosur në hapësirën ballkanike mendohet të jenë pellazgët, pasardhës direkt të të cilëve mendohet të jenë shqiptarët përmes linjës pellazgë – ilirë – arbër – shqiptarë. Ka që mendojnë se shqiptarët nuk janë pjesë e kësaj linje trashëgimie. Tek e fundit çështjet historike janë gjithmonë të debatueshme, aq më tepër kur ato shtrihen thellë në kohërat historike kur dokumentimi dhe ruajtja e historisë nuk ishte në nivele të ditëve të sotme.

Por nuk ka vetëm dokumente historike. Ka edhe trashëgimi arkeologjike, gjuhësore, etnografike. Të gjitha bashkë shërbejnë për dokumentimin e historisë së një populli, i madh a i vogël qoftë në hartën e qytetërimeve botërore. Vazhdimësia e jetës e elementit shqiptar në hapësirën ballkanike, e dokumentuar përmes këtyre burimeve, tashmë është një fakt që vështirë se mund të zhbëhet, edhe pse ata që na cilësojnë ardhacakë dhe pa ndonjë identitet të qartë më shumë se sa fakte historike, shfaqin besimin e tyre se jemi kështu për interesa të caktuara, të cilat historia i ka dëshmuar si ekspansioniste në raport me hapësirën shqiptare në Ballkan dhe elementin shqiptar në të.

Që jemi që nga lashtësia këtu, që kemi qëndruar e nuk jemi asimiluar në rrjedhën e historisë është fakt. Flasim dhe sot e kësaj dite gjuhën shqipe, e vjetër dhe e veçantë. Kemi tradita, të cilat edhe pse nuk janë ruajtur në formën e tyre primitive kanë shumëçka prej rrënjës nga janë zhvilluar. Kemi pasur dhe kemi ndikime nga fqinjët apo popujt që kanë ardhur e ikur nëpër këto territore, por sërish kemi mbetur po shqiptarë. Marrjet dhe dhëniet me popujt fqinjë kanë qenë dhe do të vazhdojnë të jenë prezente, se i mirë a i keq fqinji, nuk ta ndërron kush, përderisa në realitetin e sotëm bashkëndajmë të njëjtën hapësirë gjeografike, Ballkanin. Jo vetëm në Ballkan, por kudo në botë ka pasur ndryshime të



vazhdueshme kufijsh edhe kur bashkësitë njerëzore ishin të organizuara mbi baza fisnore e gjeografike dhe jo territoriale, politike, gjuhësore, kulturore. Mesdheu është ndoshta hapësira më e shkelur nga fise e popuj të ndryshëm, prandaj në territorin e një vendi do të gjesh gjurmë historike të lëna nga ata që kanë qenë transit, apo që kanë ardhur e janë vendosur në rrjedhën e historisë, duke na dhënë një Ballkan ashtu siç e kemi në ditët e sotme.

Ngjashmëritë në gjurmët historike nuk janë argument se kush janë më të vjetrit e më të vonshmit në popullimin e Ballkanit. Atë e përcakton materiali arkeologjik, elementi vendas dhe jo vendas në art, kulturë, arkitekturë, etnografi, toponimi, onomastikë, numizmatikë dhe siç e përmendëm elementi më shquës dhe themelor gjuha, dhe në rastin e shqiptarëve, gjuha shqipe. Sot kemi mjaftueshëm studime historike që të provojnë lashtësinë e shqiptarëve në Ballkan, një nga popujt e vjetër të Evropës dhe jo se nuk duhen pasuruar më tej këto studime, por shqetësimi kryesor duhet të mbetet se si e reflektojmë në këtë trashëgimi historike në ditët e sotme.

Të qenit autokton, të qenit një nga popujt më të vjetër në hapësirën evropiane e ballkanike nuk të bën automatikisht të vlefshëm, më të mirë, më të vyer, më të virtytshëm. Lashtësia është kohore. Vendndodhja është hapësinore. Janë dy elementë që nuk i zgjedh njeriu dhe nuk janë elementë që bëjnë diferencën automatikisht me popujt e tjerë. Sot jemi të vetëdijshëm se diferencën e bën puna, bashkëpunimi me njëri – tjetrin në drejtësi, dashuria për virtytet, përpjekja për të mos qenë në përkrahje të së keqes, mosbraktisja e përpjekjeve për të zhvilluar vetveten kulturalisht dhe bashkë me të edhe familjen e shoqërinë. Elementë të caktuar historikë nuk duhet t'i kthejmë në mite dhe mbi këto mite të presim që Evropa dhe bota të na japin hapësirën që duam në tryezën e familjes evropiane pa u lodhur e pa u djersitur. Lashtësia, autoktonia, mbijetesa, ardhjet dhe ikjet e popujve të tjerë, pavarësia, shteti, diktatura, tranzicioni demokratik duhet të jenë pika refleksioni për të kuptuar çfarë ka shkuar keq dhe çfarë ka shkuar mirë në historinë tonë si popull autokton.

Ashtu sikundërse nuk mund thjesht të krenohemi me autoktoninë dhe lashtësinë, ashtu duhet edhe të mos e vendosim popullin shqiptar në tehun e kritikës duke e zhvlerësuar në tërësi meqë nuk ka arritur të lërë gjurmë të mëdha në historinë e botës. Jemi të mendimit se vlera e një populli nuk mund të matet me

çfarë i ka dhënë njerëzimit, por se më çfarë virtytesh e cilësi është i pajisur njeriu që është pjesë përbërëse e atij populli. Të qenit shqiptar nuk të bën automatikisht të mirë e të drejtë, po dhe as të keq. Popullin nuk mund ta zhvlerësojmë, por as ta miklojmë dhe të mos e shohë realitetin në sy. Jemi autoktonë, por të jemi dhe autentikë.

Fund e krye shqetësimi ynë në ditët e sotme nuk duhet të jetë që t'i provojmë botës se sa të vjetër jemi e se sa padrejtësi na janë bërë, e se sa na është dashur të përpiqemi për mbijetesë. Nuk jemi vetëm ne që kemi kaluar plot peripeci në rrjedhat e historisë. Kjo përpjekje për t'i rënë në sy Evropës, Perëndimit dhe pastaj të presim lëmoshë prej tyre është sjellje fëmijërore. Nuk i ka hije një populli që është nga më të vjetrit të presë lëmoshë. Autoktonia nuk të shpëton nga e keqja. Autoktonia nuk të bën superior, as inferior. Lartësimi si popull nuk vjen pse je autokton. Shteti nuk ngrihet e forcohet me institucione që të qeverisin me drejtësi vetëm pse je autokton. Zhvillimet kulturore nuk mbijnë e zhvillohen vetvetiu se je autokton. Mirëqenia shpirtërore dhe materiale nuk vijnë me lëmoshë se je autokton. Zëri nuk të dëgjohet se je autokton.

Varësia ndaj së kaluarës dhe lidhja e çdo suksesi a dështimi me të në ditët e sotme është tejet shqetësuese. Duhet të vlerësojmë realitetin ku jetojmë dhe nuk duhet të presim të tjerët nga jashtë nesh që të vijnë e të na rregullojnë shtëpinë tonë, sepse jemi të zënë gjithë kohën me diskutime për të kaluarën e lavdishme që na e kanë grabitur dhe prandaj jemi kështu si jemi. E kaluara është për të nxjerrë mësim. E tashmja është për të punuar me drejtësi. Nëse e duam vendin tonë, kombin tonë, virtytet që lartësojnë njeriun nuk është koha për të vazhduar me krenarinë e autoktonisë duke ndenjur në hije në pritje të shpëtimit që na vjen nga jashtë.

Duhet të përveshim llërat e t'i shtrohemi punës, të mos pajtohemi me ligësinë dhe të përpiqemi për mirësinë, të lemë mënjane krenarinë dhe të edukojmë me virtyte rininë, të duam shenjtërinë dhe të përhapim arsimin e diturinë. Kjo është rruga që t'i japim vlerë autoktonisë, pozitës sonë në hapësirën ballkanike dhe evropiane. Vetëm kështu do të dëshmojmë se kemi reflektuar dhe kemi kuptuar se pozitën fitohen, meritohen me punë e seriozitet dhe jo me përgjërime e lëmoshë në dyert e kancelarive evropiane me kartën e autoktonisë në dorë.

Elementë të caktuar historikë nuk duhet t'i kthejmë në mite dhe mbi këto mite të presim që Evropa dhe bota të na japin hapësirën që duam në tryezën e familjes evropiane pa u lodhur e pa u djersitur.



KULTURË

Dëshmitari i gjenocidit të Srebrenicës

(KRONOLOGJIA E KUJTESËS)

Dr. Azmir Jusufi

Srebrenica është që të shkosh në Potoçare-Srebrenicë; të qëndrosh në heshtje dhe të shikosh bardhësinë e nishaneve e të lësh që heshtja të të shpjegojë mësimin e dhimbshëm të historisë...

Srebrenica është shembull i vuajtjes dhe mbijetesës, i sprovave dhe vuajtjeve boshnjake, por edhe i çnjerëzimit, mjerimit dhe turp të serb që nuk mund të lahen kurrë nga fytyrat dhe duart e tyre të përgjakshme, as nuk mund të harrohen. Kjo është një histori e treguar në

mënyrë njerëzore, në një mënyrë që mbahet mend, që mësohet, se mbetet dëshmitare për kohët dhe brezat që do të vijnë, të cilët do ta mbajnë historinë e Srebrenicës vetëm në kujtime të mjegullta. Srebrenica është një plagë që hapet çdo korrik, plaga e çdo boshnjaku dhe çdo qenieje njerëzore që ka sado pak ndjenjë njerëzore në vete.

Libri “Dëshmitari i gjenocidit të Srebrenicës”, është një rrëfim autentik i Srebrenicës dhe ferrit të saj, i treguar me shpirtin dhe fjalët e

Sado që dimë për Srebrenicën dhe sado libra të jenë shkruar për të, dhe sado fate njerëzore janë treguar, kjo histori e re është tmerrësisht e dhimbshme, tronditëse dhe papërshekrueshëm udhëzuese.





Mevludin ef. Hrnjiqit, i cili, me caktimin e Allahut, ishte dëshmitar i drejtpërdrejtë i krimit të tmerrshëm serb në Podrinjën boshnjake dhe gjenocidit kundër boshnjakëve të Srebrenicës, një zonë e mbrojtur e Kombeve të Bashkuara. Sigurisht se ka shumë libra të shkruara për Srebrenicën, por secili është i veçantë në mënyrën dhe frymën e vetë.

Libri përbëhet nga kapitujt e mëposhtëm: Historia e jetës së dhomës së pritjes së vdekjes; Jeta kalon, vitet thuren njëri pas tjetrit; dhe 6 kapituj: *Çfarë i parapriu; Në luftën në toprakun e vetë; Srebrenica – streha dhe vdekja; Ditët e lirisë dhe Kur mbaj mend Srebrenicën*. Dhe në fund, ka një *pasthënie*.

Kapitulli i parë sjell një histori për jetën e zakonshme njerëzore, të lindur dhe rritur në një familje fshatare boshnjake, e cila jeton nga puna e saj e rëndë, duke gjetur kuptimin e jetës, forcën, gëzimin dhe shpresën në Islam. Jeta e përditshme e kësaj familjeje harmonike tregohet rrjedhshëm, në mënyrë të kuptueshme dhe idilike, mënyra se si rrjedhë jeta.

Kapitulli i dytë i librit flet për shpalljen e agresionit serb, pasojat e tij shkatërruese dhe luftën mbinjerëzore për mbijetesën e popullit boshnjak me duar të zhveshura.

Sado që dimë për Srebrenicën dhe sado libra të jenë shkruar për të, dhe sado fate njerëzore janë treguar, kjo histori e re është e tmerrshme dhe dhimbshme, tronditëse dhe papërshtetshme udhëzuese. Pas pushtimit çetnik të Kamenicës, Cerskës dhe Konjeviq Poles, Mevludin ef., gjeti strehë në Srebrenicë, me prindërit, vëllezërit dhe motrat e tij, një vend shprese dhe mbijetese. Srebrenica, në të cilën u dynd, e gjithë Podrinja, ishte, në fakt, një dhomë pritjeje për vdekjen. Kjo ishte nga marsi 1993 deri në korrik 1995. Dhe pastaj erdhën ditët e pritshme të Golgotës. Një dramë Potoçare dhe një nisje

drejtë *Rrugës së Shpëtimit*. Një udhëtim që zgjati plot tetëdhjetë ditë, nga Shushnjari në Panjevë afër Kalesisë, kur autori e pa diellin e lirisë. Rruga ku kockat e tre vëllezërve të tij dhe kockat e babait të tij u lanë në varre masive.

Me vullnetin e Allahut – Mevludin ef., përjetoi një ribashkim me nënën e tij Mejren, ditë lirie, punësimi dhe krijimi i një familjeje, për të cilat ai flet në kapitujt e titulluar: *Ditët e lirisë dhe Kur e mbaj mend Srebrenicën*. Por, kujtimi i Srebrenicës nuk është zhdukur kurrë, as nuk është zbehur. Srebrenica është një plagë e gjallë që nuk është shëruar dhe nuk do të shërohet kurrë.

Është e habitshme se si autori kujton emrat e njerëzve, emrat e vendeve, me çfarë lehtësie dhe sa gjallë dhe me besnikëri i përshkruan ngjarjet, duke dhënë detaje kaq të habitshme për ta dhe njerëzit në to, sikur të mos kishte ndodhur ngjarja njëzet e pesë vjet më parë, dhe disa edhe shumë kohë më parë. Është e vështirë të besohet se autori ka regjistruar gjithçka që po ndodhte me të dhe rreth tij në momentet më të vështira.

Pavarësisht së keqes që autori dëshmoi dhe dhimbjes së papërshtetshme për më të afërmit, ai nuk u nis në rrugët e urrejtjes dhe hakmarrjes. Megjithatë ai ende shtrihet dhe zgjohej me fotografi të përbindëshave të shthurur, por edhe me fotografi të më të lindurve të tij, autori i virtytshëm ia kushtoi jetën besimit, duke punuar si imam, duke rritur fëmijët e tij dhe brezat e komunitetit të tij në Snijezhnicën e butë, për të cilën ai thotë se është atdheu i tij i dytë.

Besojmë se libri do ta gjejë vendin e tij, si në raftet e shumë bibliotekave dhe koleksionistëve publikë (të përgjithshëm dhe të specializuar) dhe privatë, ashtu edhe në duart e çdo shqiptari dhe boshnjaku, qoftë ata që jetojnë në Kosovë, apo jashtë atdheut të tyre – në diasporë.

Gjithashtu, jemi të bindur se ky libër mund të kontribuojë shumë edhe në mirëkuptimin më të madh midis popujve, në këtë rast midis boshnjakëve dhe shqiptarëve, duke pasur parasysh të kaluarën e përbashkët të hidhur që ata përjetuan.

Duhet të përpiqemi të lidhim urat e prishura, të afrohemi me njëri-tjetrin, të duam njëri-tjetrin dhe të jetojmë në mirëkuptim dhe prosperitet, gjithçka që dikur ishte e pranishme dhe jetohej në të.

Së fundi, këtë libër ua rekomandojmë për lexim të gjithëve, veçanërisht të rinjve, që e njohin gjuhën shqipe - në Kosovë e Diasporë dhe duan të dinë të vërtetën e vërtetë për gjenocidin në Srebrenicë në atë korrik të përgjakshëm dhe fatal të vitit 1995. Kjo duhet të dihet, të mbahet mend dhe të mos harrohet kurrë, sepse, për fat të keq, historia është dëshmitare se ajo përsëritet shpesh, veçanërisht në këto treva të Ballkanit.

Azmir Jusufi

Lëvizja e Deçanit – mes Lëvizjes Kombëtare dhe Lëvizjes për përcarje ndërvëllazërore

Dr. Shkodran Imeraj

Deçani, simbol i rezistencës dhe i sakrificës për lirinë e Kosovës, është bërë në vitet e fundit objekt manipulimi nga individë e grupe që, përmes një zhurme të organizuar mediatike, përpiqen të shtrembërojnë të vërtetën historike dhe ta zëvendësojnë atë me versione të fabrikuara, që nuk kanë as mbështetje në fakte, as në kujtesën kolektive.

Ajo që shpesh paraqitet si një “lëvizje e re”, në thelb nuk është gjë tjetër veçse një platformë përcarjeje, ndarje ndërvëllazërore mes shqiptarëve myslimanë, katolikë e ortodoksë, dhe sulmesh të motivuara politikisht kundër institucioneve që kanë pasur një rol jetik në shtetndërtimin e Kosovës.

Kjo analizë synon të nxjerrë në pah një propagandë, e cila nuk është gjë tjetër veçse mbjellje e ndasive mes shqiptarëve, në pikën që asnjëherë nuk i ka ndarë shqiptarët nga vëllazëria e tyre shekullore dhe besimi, që me shekuj ka jetuar në një rreth e shoqëri, pra, te përcarja fetare.

Tentimi për të manipuluar në emër të fesë, duke pretenduar se më i mirë është një shqiptar katolik e ortodoks sesa një mysliman shqiptar, apo se më patriot është të jesh katolik sesa mysliman, dhe se më shumë duhet vlerësuar shqiptaria dhe kombi duke qenë katolik sesa mysliman shqiptar, janë premisa

Ajo që shpesh paraqitet si një “lëvizje e re”, në thelb nuk është gjë tjetër veçse një platformë përcarjeje, ndarje ndërvëllazërore mes shqiptarëve myslimanë, katolikë e ortodoksë, dhe sulmesh të motivuara politikisht kundër institucioneve.

të mbjelljes dhe më pas korrjes së një ndasie të cilën as armiq të shekullorë nuk kanë mundur ta fusin, apo ta mbjellin dhe të korrin një ndasi të tillë. Pra, shqiptaria dhe kontributi për atdheun nuk maten me kutin e fesë, por me kutin e kontributit dhe angazhimeve krah popullit dhe për popullin shqiptar.

Për të arritur këtë qëllim të ndasisë mes fetare të shqiptarët, armiq të shqiptarëve, në vazhdimësi si ata serbë, rusë, grekë, kinezë e iranianë janë munduar të fusin hundët në këtë mes, por gjithsesi kanë dështuar.

Kanë dështuar për shkak se elita e Rilindjes sonë kombëtare, e cila u ka vënë themelet historisë sonë kombëtare dhe nga ajo i ka nxjerrë figurat më fundamentale të identitetit tonë kombëtar dhe fetar, ka vendosur themele aq të forta, sa që as tërmetet dhe magnitudat më të mëdha që kanë regjistruar sizmologët nuk do të mund ta shkatërronin.

Ymer Prizreni, si myderriz i njohur mysliman; vëllezërit Frashëri, si bektashinj; dom Nikoll Kaçorri, si katolik; Fan Noli, si ortodoks; e shumë figura të tjera të kombit tonë, i kanë vendosur themelet e shëndosha të identitetit kombëtar dhe fetar të shqiptarëve andej e këndej kufijve të shtetit amë shqiptar, apo në gjithë arealin shqiptar.



Shqiptarët e besimit islam, katolik e ortodoks ishin bashkë në bërjen e Shqipërisë shtet më 1912. Shqiptarët, pa dallime, ishin bashkë në Komitetin Mbrojtja Kombëtare e Kosovës. Shqiptarët pa dallime fetare ishin bashkë në përpjekje për liri e çlirim kombëtar edhe gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Shqiptarët pa dallim fetar ishin bashkë edhe në Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare, e cila udhëhoqi rezistencën më të shquar të shqiptarëve të Kosovës kundër okupimit serb e jugosllav. Shqiptarët pa dallime fetare ishin bashkë në demonstratat e vitit 1968, 1981, në lëvizjen gjithëpopullore të viteve '90 të prirë nga ideologu i pavarësisë dhe arkitekti i saj, dr. Ibrahim Rugova. Shqiptarët pa dallim feje ishin bashkë edhe në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 1998-1999. Pra, të kota janë tentimet për përçarje mes vëllezërve të një kombi.

DEÇANI DHE MANIPULIMI NË EMËR TË TIJ

Emri i Saim Tahirajt nuk figuron në asnjë nga faqet më të lavdishme të historisë së luftës sonë çlirimtare. Ai nuk pati kontribut gjatë gjithë viteve të luftës 1998-1999, as në aspektin logjistik, politik apo ushtarak. Pavarësisht kësaj, sot përpiqet të imponojë veten si “zë i pastërtisë kombëtare”, ndërsa godet në mënyrë të vazhdueshme figurat dhe institucionet themelore të rezistencës kombëtare dhe shtetndërtimit.

Duhet nënvizuar se pjesa më e madhe e shokëve të Saim Tahirajt nga fillim vitet '90 janë sot dëshmorë të kombit ose kanë qenë pjesë e drejtpërdrejtë e luftës çlirimtare të UÇK-së. Krahastuar me ta, angazhimi i tij i përkohshëm dhe episodik në periudhën e hershme të rezistencës, i ndjekur nga largimi dhe mospjesëmarrja në luftë, tregon më shumë mungesë pjekurie patriotike sesa përkushtim real ndaj çlirimit të Kosovës.

Pra, emri i Deçanit nderohet nga Tahir efendi Lluka, themeluesi i mejtepit të Llukës dhe i shkollës së parë shqipe, nga Jusuf Gërvalla si figura unifikuese e ilegales shqiptare, nga mësuesit heronj si Ismail Balaj dhe Metë Alaj, të cilët u vranë për të shkruar shqip, si dhe nga shumë figura të tjera që i kanë dhënë emër Deçanit dhe historisë sonë kombëtare.

KUSH ËSHTË PAJAZIT JASHARI, NJË NGA IDEATORËT E “LËVIZJES SË DEÇANIT”?

Edhe më shqetësues është fakti se bashkëthemelues i “Lëvizjes së Deçanit” është vetë Pajazit Jashari, një figurë e njohur për lidhjet e tij me organizata me ndikim serb e malazez, dhe për deklaratat publike që bien ndesh me të vërtetën historike dhe interesin kombëtar.

Kjo përbën një kontradiktë të thellë, sepse një lëvizje që pretendon të mbrojë “vlerat kombëtare” nuk mund të ndërtohet mbi themele të përziera me bashkëpunime të dyshimta, që i shërbejnë narrativave armiqësore ndaj Kosovës.

Pajazit Jashari ka pasur lidhje të dokumentuara me organizata joqeveritare me origjinë ose ndikim nga Serbia dhe Mali i Zi. Në një prononcim publik në RTV21, në emisionin “Echo”, më 3 maj 2024, ai pranoi se kishte themeluar një OJQ me emrin “Budučnost-Ardhmëria”, ku ishte bashkëthemelues me disa serbë e malazezë lokalë të veriut të Kosovës.

ROLI I DISKUTUESHËM I PSEUDO-HISTORIANIT MUHAMET SHABANI?

Në këtë analizë nuk mund të lihet pa përmendur figura si ajo e Muhamet Shabani, i cili, sipas disa burimeve, jo vetëm ka pasur lidhje me sistemin komunist jugosllav dhe lidhej drejtpërdrejt me kreun e komunistëve të Serbisë, por ka

zhvilluar edhe fushata shpifëse dhe të dëmshme kundër krerëve të UÇK-së.

Veprime të tilla, të dokumentuara edhe në librin e tij “Degradimi i Pavarësisë së Kosovës”, përbëjnë jo vetëm falsifikim, por edhe tradhti ndaj së vërtetës historike, si dhe akt dëmprurës për kohezionin shoqëror në një vend që ka kaluar një luftë të përgjakshme çlirimtare.

Nuk ka “Islam politik” në Kosovë – përpjekje për përçarje të sponsorizuara nga shtete armike të Kosovës

Një prej aksioneve më të rrezikshme të kësaj “Lëvizjeje”, por edhe eksponentëve të saj si Pajazit Jashari, Saim Tahiraj e Muhamet Shabani, është përpjekja për të promovuar idenë e një “islamizmi politik” në Kosovë.

Kjo është një narrativë e rreme, që nuk gjen mbështetje në realitetin e vendit tonë. Pretendimet për ekzistencën e një “Islami radikal” apo “politik” nuk janë as origjinale, as të bazuara në fakte: ato janë të importuara nga propagandat serbo-ruse, kineze dhe iraniane.

Janë pikërisht këto shtete që në forumet ndërkombëtare përpiqen ta paraqesin Kosovën si vatër të ekstremizmit, për të minuar legjitimitetin e saj dhe për të ndikuar opinionin ndërkombëtar.

Lëvizjet që ushqejnë këto narrativa brenda Kosovës bien në shërbim të agjendave anti-kombëtare. Kosova është vend me shumicë myslimane, i cili u çlirua falë rezistencës kombëtare të popullit të saj dhe ndihmës së pamohueshme të ShBA-ve.

ShBA-të e kanë çliruar Kosovën duke ditur se mbi 90% e popullsisë janë myslimanë. Kosova ka qëndruar gjithmonë në krah të ShBA-ve dhe ka qenë pjesë e çdo nisme amerikane kundër grupeve dhe shteteve terroriste.

Ajo është dhe mbetet pjesë e aleancës perëndimore kundër çdo radikalizmi fetar, ekonomik, politik apo kulturor.

Mbi të gjitha, Kosova është ndër vendet më pro-perëndimore dhe më pro-amerikane jo vetëm në Ballkan, por edhe në gjithë Evropën dhe më gjerë.

Kjo nuk është thjesht një qëndrim politik momental, por një orientim i rrënjosur thellë në ndërgjegjen kombëtare, që buron nga historia jonë e afërt, nga aleancat e gjakut dhe nga mirënjohja e thellë për rolin vendimtar që

ShBA-të dhe Perëndimi kanë pasur në çlirimin, mbështetjen dhe shtetndërtimin e Kosovës.

PSE SULMOHET BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS – INSTITUCIONI I SHTETNDËRTIMIT

Sulmet ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës janë të pabaza dhe të padrejta. BIK-u ka qenë një ndër institucionet më të rëndësishme në mbështetjen e proceseve kombëtare dhe në ruajtjen e stabilitetit shoqëror në Kosovë.

Gjatë viteve '90, kur regjimi serb kishte suprimuar çdo institucion shqiptar, Medreseja “Alauddin” në Prishtinë u shndërrua në një vatër të vërtetë të rezistencës intelektuale dhe kombëtare. Në këtë medrese u mbajt Kuvendi i parë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i parë nga dr. Ibrahim Rugova. Po aty zhvilluan aktivitetet e tyre Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Instituti i Historisë dhe Instituti Albanologjik. Veprimtarinë e zhvilloi edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Janë të evidentuara mbi 1200 ngjarje dhe aktivitete të zhvilluara në

këtë medrese. Në këtë mes nuk duhet harruar roli kombëtar i drejtorit të atëhershëm të Medresesë, myftiut aktual Naim Tërnavë.

Për veprimtarinë kombëtare të BIK-ut dhe Medresesë “Alauddin”, këto dy institucione janë nderuar me dekorata shtetërore nga presidenti Hashim Thaçi dhe presidentja Vjosa Osmani-Sadriu.

Që nuk ka islam radikal në Kosovë dhe as ndasi ndërvëllazërore, vërtetohet lehtësisht: Rexhep Boja, kryetar i atëhershëm i BIK-ut, ishte ndër bashkëpunëtorët më të afërt të presidentit historik dr. Ibrahim Rugova. Së bashku me Mark Sopin, udhëheqësin e Kishës Katolike në Kosovë, ishin pjesë thelbësore e lëvizjes gjithëkombëtare paqësore që hodhi themelet e pavarësisë së vendit.

Gjatë luftës çlirimtare, BIK-u dhe Medreseja ishin krah popullit dhe rezistencës kombëtare. Nga kjo organizatë kombëtare, shumë imamë iu bashkuan UÇK-së; mbi 37 prej tyre janë dëshmorë të kombit.

FUSHATA “KOSOVA – VEND ISLAMIST”: NJË NARRATIVË E VJETËR ANTISHQIPTARE

Ideja se shqiptarët e Kosovës janë “islamistë” dhe përfaqësues të një “radikalizmi islamik” nuk është as e re, as spontane. Kjo fushatë

Sulmet ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës janë të pabaza dhe të padrejta. BIK-u ka qenë një ndër institucionet më të rëndësishme në mbështetjen e proceseve kombëtare dhe në ruajtjen e stabilitetit shoqëror në Kosovë.

është e vjetër dhe lidhet ngushtë me propagandën jugosllave, veçanërisht atë serbe.

Kjo fushatë arriti kulmin në vitet '90, veçanërisht gjatë luftës çlirimtare të UÇK-së. Serbia përhapri gënjeshtren se UÇK-ja kishte lidhje me grupime islamiste dhe priste ndihmë nga Irani, me qëllim njollosjen e qëndresës shqiptare.

Një rast domethënës është se Irani, mik tradicional i Serbisë dhe kundërshtar i pavarësisë së Kosovës, kishte ofruar ndihmë për luftën, por kjo ndihmë u refuzua nga strukturat atdhetare të UÇK-së, me udhëzime të qarta edhe nga miqtë tanë.

Kjo fushatë serbe nuk u ndal as pas luftës. Serbia, në çdo forum ndërkombëtar, përpiqet ta paraqesë Kosovën si vend islamik dhe të rrezikshëm për Perëndimin, duke nxitur frikë dhe dyshime.

Edhe në kohën kur Kosova u përball me dhunë ndaj objekteve fetare ortodokse, veçanërisht në mars 2004, Serbia tentoi ta paraqiste këtë si dëshmi të “radikalizmit islamik shqiptar”. Por kjo propagandë dështoi.

Së fundmi, prej dy vitesh, po tentohet të ringjallet kjo narrativë, në një formë më të sofistikuar: disa individë, nën maskën e “shqetësimit kombëtar”, promovojnë idenë se shqiptarët e Kosovës janë antiamerikanë për shkak të besimit të tyre islam. Kjo është gënjeshtër e pastër dhe përpjekje e rrezikshme për ndarje dhe përçarje shoqërore.

Për ShBA-në, Islami nuk është problem, as Kosova nuk është problem për shkak të përkatësisë fetare të qytetarëve të saj. Amerika ka marrëdhënie strategjike me shumë shtete myslimane, duke përfshirë Arabinë Saudite, me të cilën ka marrëveshje të shumta, përfshirë kontrata armatimi me vlera milionëshe.

EKSTREMI I TË ASHTUQUAJTURËS “LËVIZJE E DEÇANIT”

Në Kosovë ka pasur dhe ka ekstremizëm politik, partiak, e ndonjëherë edhe rajonal. Për shembull, gjatë dhe pas luftës, janë regjistruar rreth 400 vrasje me motive politike, ku individë dhe parti kanë akuzuar njëri-tjetrin për këtë.

Ky është ekstremizmi i vërtetë, ndërsa pretendimet për ekzistencën e ekstremizmit islam apo “Islam politik” janë të pabazuara. Në Kosovë nuk ka asnjë vrasje të regjistruar për shkak të ekstremizmit islam. Ideja “Kosova shtet islam” nuk buron nga realiteti, por nga agjenda të jashtme dhe brenda vendit. Kosova është shtet laik, me ndarje të qartë të fesë nga shteti dhe me shumicë popullsie myslimane.

Kjo ide është shpikje politike, e shtyrë nga qarqe serbe, ruse dhe greke, dhe e përvetësuar nga disa individë shqiptarë me prirje ideologjike që duan të ndryshojnë natyrën shtetformuese të Kosovës.

Qendra kryesore propagandistike janë qarqet serbo-ruse, me ndihmën e Kishës Ortodokse dhe shërbimeve inteligjente që e paraqesin Kosovën si vatër të “islamizmit radikal”. Disa figura publike shqiptare dhe grupime pseudointelektuale po përhapin këtë narrativë përçarëse.

KOHA E TË VËRTETËS DHE PËRGJEGJËSISË HISTORIKE

Kosova ka nevojë për një diskurs të matur, të bazuar në fakte dhe unitet kombëtar, jo për zëra që përçajnë dhe krijojnë ndasi të rreme. Çdo përpjekje për rrëzimin e rolit të institucioneve që kontribuuan në shtetndërtim, si BIK-u, për të etiketuar pa fakte dhe për të ringjallur ndasi ideologjike, është hap prapa në ndërtimin e shtetit dhe shoqërisë.

Në Deçan dhe më gjerë kemi nevojë për kujtesë të pastër, jo për zëvendësim të historisë me mitologji personale. Kosova e ka në vetëdijen e saj bashkëjetesën ndërfaqetare si vlerë të trashëguar nga Rilindja Kombëtare Shqiptare, e cila theksoi unitetin, jo ndarjen, bashkimin pa dallim feje.

Prandaj, as Pajazitët, as Saimët, as Muhametët, me përpjekjet e tyre për ndarje, nuk mund të prishin themelet e bashkëjetesës ndërfaqetare që është vlera dhe vullneti i trashëguar brez pas brezi.

Bashkëjetesa ndërfaqetare në Kosovë është provë e qytetarisë sonë dhe armë kundër propagandave armiqësore. Duhet theksuar se qarqet serbe tashmë në shkrime e tyre, po përdorin këtë narrative të kësaj fushatë nga individë të pa adrese, se Kosova është “islame e radikale”, me qëllimin e vetëm për të ndryshuar imazhin e Kosovës dhe për ta paraqitur atë si një shtet islamist.

Kjo është shumë e dhimbshme, pasi disa individë, qoftë me vetëdije apo pa vetëdije, po bien në kurthin e historisë së keqe dhe po përfundojnë në “koshin e plehrave” të saj, duke lejuar që ide apo lëvizje të tilla të keqpërdoren për qëllime armiqësore ndaj Kosovës.

E ashtuquajtura “Lëvizja e Deçanit” do të mbetet një pikë e vogël në rreshtat e historisë, një përçarëse dhe një episod i shkurtër, por i dhimbshëm, i disa personaliteteve.

Shqiptarët, as në të kaluarën, as tash e as në të ardhmen nuk do t'i ndaj feja. Të gjithë jemi vëllezër dhe një komb i pandarë.

Krejt në fund, këtë analizë dua të përfundoj me mendimin së: të jesh historian është nder, por njëkohësisht edhe përgjegjësi e madhe, ngase mbi supë bart përgjegjësinë që brezave që do të vijnë t'u lihet e shkruar historia ashtu siç ka ndodhur, pa mitizime dhe pa shtrembërime, në mënyrë që brezat e rinj të kuptojnë se rruga jonë për shtet, pavarësi, liri e çlirim ka qenë e gjatë dhe e mundimshme.

Objektet e kultit si ruajtëse të kujtesës historike – rasti i Teqesë së Radës

Dr. Eduart Caka


Feja ka pasur dhe vijon të ketë një rol qendror në jetën e individit dhe shoqërisë. Ndonëse sot ky do të dukej një mendim relativ, nuk ka asnjë dyshim se deri para dy shekujsh, kjo qe një e vërtetë absolute. Jeta politike, kulturore, shoqërore, madje edhe ekonomike e qyteteve vërtitej rreth kishës apo xhamisë, të cilat simbolizonin pushtetin hyjnor, që në tokë përfaqësohej prej mbretit apo sulltanit. Këtë devizë e gjejmë të përmendur në njërën prej mbishkrimeve të portës kryesore të pallatit të Topkapisë, përkatësisht asaj që njihet edhe si *Bâb-ı Humâyun* ku shkruhej “Es Sultânu dhillullâhi fi’l-ard”.¹

Një peshë të tillë e kishin edhe objektet e kultit, si mjediset ku përshfaqej në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimi i dedikimit fetar të njeriut, adhurimi. Por jo vetëm kaq, është i njohur gjerësisht fakti se xhamitë dhe teqetë shërbenin edhe si vende të socializimit, arsimimit e kuvendimit. Udhëtari i njohur osman i shek. XVII, Evlija Çelebiu, në përshkrimet e tija të qyteteve shqiptare gjatë vizitave që ai kreu në këtë hapësirë gjatë viteve

Është i njohur gjerësisht fakti se xhamitë dhe teqetë shërbenin edhe si vende të socializimit, arsimimit e kuvendimit.

1660-1670, e thekson qartësisht këtë element, duke na dhënë detaje e hollësi të sakta mbi rolin dhe funksionin që këto objekte kultive kishin në jetën komunitare, kulturore e intelektuale të vendit. Kështu, kur përshkruan xhaminë e Sinan Pashës në Elbasan, kronisti osman thekson se muret e saj qenë të mbushura me shkrime e shënime të udhëtarëve e poetëve që qenë ndalur këtu, tekste të cilat qenë shkruar në gjuhë të shumta, përfshirë këtu edhe turqishten, arabishten, persishten e greqishten.²

Pikërisht këtu del në pah edhe një funksion tjetër i këtyre objekteve të kultit, përkatësisht ai i shërbimit të këtyre ambienteve si mjedise ku shënohej, ruhej dhe transmetohej kultura e shkruar, ajo letrare, fetare, madje edhe historike. Ky nuk është një rast i kufizuar, por nëse do të kemi parasysh nivelin e shkrim-këndimit, mungesën e një shtypshkronje, por edhe faktin se xhamitë shërbenin si shkolla, ambiente të tilla janë domosdoshmërisht të pranishme. Kjo, jo vetëm në qendrat e mëdha e të zhvilluara urbane, por edhe në zonat më rurale. Një shembull i tillë, është edhe ai i



Teqesë së Radës në afërsi të Durrësit, e cila na paraqet një rast të veçantë se si këto objekte me karakter fetar kanë shërbyer si qendra të përcimit të dijes, kulturës e historisë gjatë periudhës osmane.

TEQEJA GYLSHENIJE NË RADË TË DURRËSIT

Në hulumtimet e tija në vitin 1959 mbi mbishkrimet në gjuhën osmane dhe arabe që gjendeshin në zona të ndryshme të Shqipërisë, Vexhi Buharaja na jep informacione edhe mbi një teqe “interesante” në fshatin Radë të Durrësit.³ Sipas autorit të veprës, teqeja i përkiste tarikatit Gylshenije, i cili është një krah i halvetizmit dhe i atribuohet Ibrahim Gylsheniut, që e ngriti teqenë fillimisht në Kajro, ndërsa murshidët e tij do të përhapeshin në të gjithë hapësirën osmane pas shek. XVI.⁴ Për rrjedhojë, teqe gylshenije do të vërejmë edhe në hapësirën shqiptare, ku përveç asaj të Radës, një të tillë e hasim edhe në Gjirokastrë.⁵

Në lidhje me historinë e teqesë nuk kemi informacione të hollësishme, ndërsa mbishkrimet që i kanë rezistuar kohës deri në kohën kur u mbajtën shënim prej Buharasë, i përkasin kryesisht shek. XIX. Megjithatë, këtu nuk do të ndalemi te veçoritë e gylshenive apo aspekte të ndryshme të teqesë së Radës, por nisur nga mbishkrimet që Buharaja ka mbledhur në këtë objekt, do të përpiqemi të nxjerrim në pah disa elemente që i shërbejnë historisë dhe kulturës shqiptare, detaje të cilat i mësojmë nga shënimet e dervishëve, poetëve, kalimtarëve dhe njerëzve të ndryshëm që qëndruan në këtë objekt kulturi.

TEQEJA SI OBJEKT I ADHURIMIT

Pjesën kryesore të mbishkrimeve të teqesë e përbëjnë ato me karakter fetar, të shkruara prej dervishëve që shërbyen

këtu, në të cilat del në pah edhe përkatësia gylsheniane e këtij objekti, sikurse e vërejmë në tekstin e mëposhtëm:⁶

Mos u bëj mohues, hapi sytë dhe shiko rrotullimin e botës!

O Zot, mbaje gjithmonë në këmbë këtë vend të shenjtë!

Eja dhe hyr me dashuri e me mall në mejdanin e Gylsheniut!

Atë që vjen dhe ulet këtu, çliroje o Zot nga brenga!

Tekstet e tjera në muret e objektit, u referohen fjalëve të profetit Muhamed, ku shprehet: “Kërkojeni dijen nga djepi deri në varr”, ndërsa disa prej shkrimeve na japin informacione edhe mbi dervishët që qëndruan këtu. Sikurse është rasti i dervish Ademit nga Elbasani, i cili në vitin 1851 shkruante:⁷

Qabe e dashnorëve është ky vend (teqeja e Radës).

Cilido njeri me të meta që vjen këtu, bëhet i plotë.

E shkroi fakiri (i vorfni) që i pohon dobësitë e veta,

dervish Ademi nga Elbasani.

Të dyja mbishkrimet e paraqitura më lart, krahas elementit fetar, përmbajnë edhe aspekte të vjershës dhe poezisë që lëvrohej gjatë shek. XIX, formën shumë më të zhvilluar të së cilës e gjejmë te vjershat me karakter mistik të Naim Frashërit në fundin e të njëjtit njëqind vjeçar.

MBISHKRIMET ME KARAKTER ESKATOLOGJIK

Nisur prej marrëdhënies që sufizmi dhe tarikatat kanë me mistiken, në muret e teqesë vërejmë tekste të cilat jo vetëm që e nxjerrin në pah këtë element, por tentojnë të bëjnë lidhje e interpretime të fenomeneve natyrore, duke u përpjekur ta shpjegojnë materialen me atë të padukshmen, gjë e cila i shtyn të shkojnë drejt eskatologjikes. Në këtë kontekst vlen të



përmenden disa mbishkrime, të cilat dervishët e këtushëm i kanë komentuar si lajmës të ngjarjeve të kobshme e fatkeqësive që mund të ndodhnin në të ardhmen. Shënimi i parë i përket vitit 1831, ku banorët shprehen se kanë parë të kalojnë tri hardhuca gjigande që ecnin njëra pas tjetrës. Një fenomen të tillë ata e kanë parë sërish dhjetë vjet më vonë, në vitin 1841, por këtë herë numri i hardhucave që trembëdhjetë. Ndërsa më 1869 sërish banorët kishin parë tetëmbëdhjetë hardhuca të tilla.⁸

SHËNIMI I NGJARJEVE HISTORIKE

Në muret e teqesë vërejmë të jenë shkruar edhe ngjarje me rëndësi lokale, të cilat qenë shënuar prej dervishëve me synimin për t'u përcjellë te brezat e mëvonshëm. Një rast i tillë që ai i tërmetit të fuqishëm që kishte rënë këtu në vitin 1825. Mbishkrim të cilin Buharaja e ka kopjuar kështu:

“Në vitin 1240, natën e dymbëdhjetë të hënës dhulkade, në orën tre e një çerek pas akshamit ra një tërmet i fortë. O Zot, na ruaj nga të gjitha fatkeqësitë!”

Nga teksti i mësipërm del në pah edhe data e saktë e ngjarjes, e cila përkon me 28 qershorin e vitit 1825, duke na dhënë kështu një informacion mbi historinë e kësaj zone,

Rasti i teqesë së Radës nuk është i veçantë, por ai nxjerr në dritë rëndësinë që patën objektet e kultit në ruajtjen dhe përcimin e dijes e kulturës përgjatë brezave.

por edhe të aktiviteteve sizmike në hapësirën ku bënte pjesë edhe teqeja në fjalë.

Rasti i teqesë së Radës nuk është i veçantë, por ai nxjerr në dritë rëndësinë që patën objektet e kultit në ruajtjen dhe përcimin e dijes e kulturës përgjatë brezave. Kështu, nëse në bodrumet, çatitë apo kthinat e xhamive, teqeve, manastireve e kishave janë gjetur dorëshkrime, korpuse me dokumente, kodikë e vepra të rralla, në të tilla si ajo e xhamisë së Sinan Pashës në Elbasan apo Teqesë Gylshenije në Radë, këto shenja të qytetërimit i gjejmë të gdhendura edhe në muret e këtyre objekteve.

1 “Sulltani është hija e Allahut në tokë”. Shih: Semavi Eyice, “Bâb-ı Humâyûn”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. IV, İstanbul: TDV Yay., 1991, f. 359-361.

2 Evliya Çelebi *Seyahatnamesi*, C. VIII, İstanbul: Orhaniye Matbaası, (pa vit botimi), f. 721.

3 Arkivi i Institutit të Historisë (AIH), A-III-435, Vexhi Buharaja, “Mbishkrime të marra nga xhamitë në rrethet Krujë, Lezhë, Shkodër, Vlorë, Tiranë, Përmet etj.”, Tiranë 1959, f. 31.

4 Mustafa Kara, “Gülşeniyçe”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C.X IV, İstanbul: TDV Yay., 1996, f. 256-259.

5 Eduart Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social në Shqipërinë e periudhës osmane*, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2021, f. 362.

6 V. Buharaja, *Mbishkrime turko-arabe*, f. 118.

7 Për shënimet në fjalë, shih E. Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre*, f. 371.

8 E. Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre*, f. 370-371.

Gjenocidi i shtetit serb ndaj shqiptarëve gjatë luftës së Kosovës (1998-1999)

Mr.sc. Adnan Qaka

Veprimet dhe krimet e Serbisë¹ gjatë luftës së fundit në Kosovë, me shumë fakte dhe dëshmi, lirshëm mund të cilësohen se janë gjenocid. Nëse i referohemi vuajtjeve të mëdha të popullit shqiptar, sidomos në vitet 1998-99, të cilat i shkaktoi regjimi i Millosheviçit (shteti) ndaj shqiptarëve të Kosovës, pastaj dhe dëshmive të sakta, përjetimeve dhe rrëfimeve të vetë qytetarëve të Kosovës, të dëshmuara para mjeteve të informimit, reporterëve të luftës dhe organizatave dhe organeve vendore apo ndërkombëtare gjatë viteve 1999, shtoj kësaj edhe libri “Gjenocidi në Kosovë” nga Tilman Zulch (Gotingen, 1999); libri Lexikon der Volkermorde të autorit Gunnar Heisohnit (bot.II, 1999), dokumentit të publikuar nga ish-ministri i Mbrojtjes së Gjermanisë Rudolf Scharping, Haufeisen (Patkoi) 1999, si dhe shume autorë dhe dokumente të tjera ndërkombëtare, dëshmohet qartë se regjimi i Milloshoviçit, shteti i vetëshpallur jugosllavi (Serbi dhe Mali i Zi), në Kosove kanë provuar dhe kanë kryer krimin e gjenocidit ndaj

Krimet e gjenocidit dhe format e tjera të dhunës seksuale që janë përdorur në Kosovë nga forcat e armatosura serbe gjatë luftës së fundit, janë përdorur edhe si armë lufte dhe instrumente të spastrimit etnik.

popullit shqiptar, veprime të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet dhe dispozitat që kanë të bëjnë me parandalimin dhe ndëshkimin e gjenocidit të Konventës së vitit 1948.

Gjatë luftës së Kosovës,² Serbia nuk i ka respektuar ligjet dhe zakonet e të drejtës humanitare. Një argument tjetër që dëshmon se Serbia ka bërë gjenocid në Kosovë është fakti i dhunimeve seksuale. Statutet dhe tribunalet e Nurembergut dhe Tokios e kishin konsideruar përdhunimin një krim lufte. Krimet e gjenocidit dhe format e tjera të dhunës seksuale që janë përdorur në Kosovë nga forcat e armatosura serbe gjatë luftës së fundit, janë përdorur edhe si armë lufte dhe instrumente të spastrimit etnik, me qëllim të shkatërrimit të shqiptarëve si të tillë. Përdhunimet nuk ishin akte të rralla dhe të izoluara të kryera nga forcat e armatosura serbe dhe jugosllave, por u përdoren qëllimisht si një instrument për të terrorizuar popullsinë civile, të rrëmbyera nga familjet, dhe të shtyjë shqiptarët të largohen nga shtëpitë e tyre. Dihet se dhuna seksuale ka



pasoja të renda për viktimën. Por kur dhuna seksuale hyn në funksion të strategjisë së shkatërrimit të një grupi, siç ishin dhunimet e shqiptarëve në Kosovë, atëherë qëllimi i dhunimeve seksuale nuk është vetëm shkatërrimi i viktimave të drejtpërdrejta, por, nëpërmjet dhunimeve, synohet të lëndohej integriteti mendor edhe i të afërmeve të viktimave, i tërë grupit, i të gjithë shqiptarëve.³ Sipas ish-sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, George Robertson, në një intervistë për “DER SPIEGEL”, më 14.2.2000, kishte thënë: “Në Kosovë mbretëronte një gjenocid i pastër dhe ishte i organizuar nga shteti.”

Serbia gjatë luftës⁴ në Kosovë ushtroi një dëbim masiv ndaj shqiptarëve, pra spastrim etnik, me qëllim të qartë, shkatërrimin e plotë apo të pjesërishtë të shqiptarëve si të tillë. I ngarkuari për zbatimin e këtyre ideve në Kosovë ishte gjenerali Sreten Llukic, oficer i lartë i sigurisë së shtetit dhe mik personal i Millosheviçit. Operacioni “Patkoi” ishte një plan ushtarak i përpunuar dhe realizuar nën mbikëqyrjen e shtabit të përgjithshëm të Beogradit.

Sipas ish-ministrit Federal të Mbrojtjes së Gjermanisë,⁵ Rudolf Sharping, planin “Patkoi” e zbuloi së pari shërbimi informativ austriak, i cili pastaj i është dhënë ministrit të Jashtëm gjerman Joska Fisher.

Duhet të kujtojmë se vetëm brenda një dekade,⁶ që domethënë brenda viteve 1990-1999, Beogradi ka dekretuar 4 projekte që kanë pasur si qëllim jo vetëm luftën propagandistik-agjenturore, përçarjen, survejimin, kriminalizim, por edhe gjenocidin e shpopullimin e shqiptarëve:

Projekti “Gërshtërit”, i cili kishte objektiv infiltrimin dhe kontrollin e jetës dhe të skenës politike të Kosovës;

Projekti “Kafshimi i miut”, i cili kishte objektiv infiltrimin dhe shkatërrimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

Projekti “Patkoi”, i cili kishte qëllim gjenocidin dhe shkatërrimin e shqiptarëve si të tillë;

Si dhe planin e njohur me emrin “Leopardi”, përmes këtij plani zbatohet një metodë e sinkronizuar nga forcat e armatosura serbe, frikëso dhe sulmo, fut nëpër bodrume njerëz të pambrojtur, një fshat ose një lagje të qytetit, në mënyrë që të lëvizë pastaj nga frika e tërë popullsia, pra ky plan u zbatua më 1999.

Vlen të theksohet se me spastrimet etnike nëpërmjet operacionit “Patkoi” në Kosovë duhej të mbeteshin 400,000-500,000 shqiptarë dhe me kolonizimin e ri serb, në Kosovë synohet të krijohet një përqindje proporcionale e popullatës.

Struktura e shërbimit sekret të Millosheviçit⁸ kishte organizuar forcat e armatosura serbe e zyrtarë të tjerë shtetëror serb për shkatërrimin e provave, të cilat mund të çonin në zbulimin e përgjegjësve të varrezave masive, sidomos të atyre të operacionit “spastrimi”.

Sipas dëshmimeve të prezantuara në gjyqin ndërkombëtar për krime lufte në Hagë, nga prova materiale “Ditar” e komandantit të policisë serbe, Obrad Stevanoviçit, rezultojnë se krimet ndaj shqiptarëve ishin të planifikuara deri në fshehjen e gjurmëve. Pas përmytjes së pushtetit të Slllobodan Millosheviçit, kryeministri i ri serb, Zoran Gjingjiq, bëri publike operacionet e fshehjes së fakteve lidhur me krimet e gjenocidit serb të bëra në Kosovë. Po ashtu vlen të potencohet se një mënyrë tjetër për fshehjen e gjurmëve të krimeve të gjenocidit ndaj shqiptarëve, Serbia bëri djegien e kufomave të shqiptarëve. Një pjesë e kufomave digjeshin nëpër furrat e shkretoreve, si në Zvečan, në kompleksin Trepça, në fabrikën e Maçkaticës etj.. Një metodë tjetër për zhdurjen e gjurmëve të krimeve ishte edhe hedhja e kufomave të shqiptarëve të vrarë në liqene ose lumenj. Për t'i fshehur krimet e gjenocidit të kryera mbi shqiptarët, forcat e armatosura serbe fillimisht

viktimat e tyre i varrosën në varreza masive anembanë Kosovës. Mirëpo, më vonë, duke kuptuar se mund ta humbnin Kosovën dhe varrezat mund të zbuloheshin, ata i zhvarrosen trupat e shqiptarëve të vrarë dhe i dërguan në Serbi, kur u rivarrosen në varreza masive si në: Petrovo Sello, Batajnicë etj.. Në vitin 2004, Nenad Čanak, lideri i Lidhjes Socialdemokrate të Vojvodinës, pati deklaruar se në territorin e Serbisë ekzistonin 17 varreza masive me kufomat e shqiptarëve. Këtë shifër e kishte pohuar edhe Dushan Mihajloviq (ish-ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë), i cili deklaronte se pushteti serb përpigjeq t'i fshihte këto dëshmi. Që në kontaktet e para të kryeprokurores se Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, Carla Del Ponte me pushtetarët e rinj në Beograd pas përmbysjes së Slobodan Millosheviqit, ajo iu kërkoi atyre arkivat e Këshillit Suprem të Mbrojtjes së Jugosllavisë. Mirëpo hasi në refuzim kategorik, sepse siç pohon zëdhënësja e prokurores Del Pontes, Florence Hartmann, “Zyrtarët serbë ishin të bindur se arkivat e Këshillit Suprem të Mbrojtjes së Jugosllavisë mund të shpinin deri te dënimi i Serbisë për gjenocid.” Për të ilustruar këtë pohim, zëdhënësja Hartman sjell qëndrimin e ministrit serb të Punëve të Jashtme, Goran Svilanović, i cili në zyrën e kryeprokurores Del Ponte në Hagë, më 3 tetor 2003, përpigjeq të arsyetonte shkaqet e refuzimit të dorëzimit të arkivit të Këshillit Suprem të Mbrojtjes së Jugosllavisë. Në këtë takim, Goran Svilanović kishte deklaruar se: “Nëse ju ndihmojmë ta dënoni Millosheviqin për gjenocid atëherë edhe shteti ynë do të dënohet nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për gjenocid dhe do të duhet të paguajmë miliarda dollarë dëmshpërblim.”

Florence Hartmann e denoncoi publikisht marrëveshjen mes tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavi dhe Ministrisë se Punëve të Jashtme të Serbisë, të arritur në 2003 për ta falur Serbinë nga dënimi për krimin e gjenocidit, dhe për herë të parë, nxori në shesh të dhëna të sakta lidhur me hipokrizinë e drejtësisë ndërkombëtare. Vërtetësinë e marrëveshjes mes Gjykatës së Hagës dhe Serbisë, që Florence Hartman ia zbuloi publikut, nuk e kundërshtoi askush. As Gjykata e Hagës, që

Fshehja e krimin të gjenocidit të kryer në Kosovë nga forcat e armatosura serbe dhe drejtimi i gishtit te grupet “paramilitare” është pjesë e strategjisë se Serbisë për t’i ikur përgjegjësisë si shtet.

ngriti akuzë kundër saj për publikimin e dokumenteve konfidenciale, nuk e mohoi vërtetësinë e strategjisë së fshehjes së provave të krimin të gjenocidit. Përkundër fakteve që Serbia, në kundërshtim me obligimet që kishte si shtet, nuk i dorëzoi pjesët e arkivit, që do të dëshmonin në mënyrë të qartë se ky shtet kishte zbatuar gjenocid kundër shqiptarëve të Kosovës dhe se heqja dorë që të akuzohen udhëheqësit shtetërorë të Serbisë për gjenocid ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe statutin e Gjykatës së Hagës.⁹ Dihet se Serbia, vazhdimisht e ka mohuar pjesëmarrjen e ushtrinë serbe (jugosllave) në luftën në Kosovë. Me këtë akt, sekretari i shtetit në Ministrinë Serbe të Mbrojtjes, Igor Jovičević, zyrtarisht pranoi pjesëmarrjen e ushtrisë serbe në luftën e Kosovës dhe atë prej 23 marsit 1998 deri më 26 qershor 1999. Serbia vazhdon t’i dekoroj ata kriminel që gjatë luftës në Kosovë terrorizuan dhe vranë e masakruan shumë shqiptarë, me qëllim të shkatërrimit të shqiptarëve si të tillë, duke realizuar kështu krimin e gjenocidit, veç kësaj i shkaktuan miliarda dollarë dëme materiale Kosovës.

Nuk ka dyshim se gjenocidi serb¹⁰ në Kosovë është bërë me përkrahjen e shtetit të Serbisë nga strukturat policore, ushtarake dhe organizatat terroriste ortodokse serbe. Që të gjitha kanë qenë pjesë e forcave të armatosura serbe, dhe kanë qenë të krijuara dhe financuara nga shteti i Serbisë.

Te ashtuquajturat forcat “paramilitare”¹¹ serbe, që në fakt kanë qenë organizata terroriste ortodokse serbe si pjesë e forcave të armatosura serbe, ku me aktive në Kosovë, kanë qenë “Tigrat e Arkanit”, “Shqiponjat e bardha të Sheshelit” dhe “Forcat delta”. Këto grupe, thonë burimet, operonin nën kontroll të drejtpërdrejtë të Beogradit. Organizata terroriste ortodokse serbe “Crena Ruka” ka vepruar edhe gjatë luftës së fundit në Kosovë, duke marrë pjesë në krimet e gjenocidit, masakrat e shumta ndaj shqiptarëve, me qëllim të qartë, shkatërrimin e plotë, apo të përsëritshëm të shqiptarëve si të tillë. Ish-zëvendësministri i Punëve të Brendshme të Serbisë dhe shefi i resorit për siguri publike, Vlastimir Gjordjević, ka pranuar publikisht se në Kosovë, më urdhër politik janë bërë krime



kundër shqiptarëve të Kosovës dhe deklarën se ndihet përgjegjës pse nuk i është kundërvënë strategjisë së fshehjes së krimeve të bëra në Kosovë.

Me kërkesë të shërbimeve të fshehta ushtarake dhe policore serbe,¹² gjykata serbe liron nga burgjet shumë kriminelë të dënuar për vrasje gjatë luftës në Kosovë.

Në gjykimin e Sllobodan Millosheviçit në Hagë,¹³ prokurori Xhefer Najs, më 20 korrik 2003, theksoi se Sllobodan Millosheviçi e formoi komandën e përbashkët për Kosovën që t'u shmangej zinxhirëve ligjor të komandimit. Edhe ushtrinë edhe policinë e vuri nën kontroll të njeriut të vet të besueshëm Nikolla Shainoviç.

Millorad Ulemek-Legija,¹⁴ i cili mori detyrë nga Millosheviçi për ta eliminuar Stomboliçin, në mars të vitit 1999, personalisht kishte urdhëruar bartjen sekrete të tashmë trupave të dekompozuar të viktimave të tij nga Kosova në rrethinën e Beogradit. Dihet qartë se fshehja e krimeve të gjenocidit të kryer në Kosovë¹⁵ nga forcat e armatosura serbe ishte preokupim kryesor i shtetit serb. Meqenëse vrasja e civileve shqiptarë në Kosovë ishte një fakt që askush nuk mund ta mohonte. Pushteti i Beogradit zbatoi strategjinë e mohimit të implikimit të ushtrisë dhe policisë serbe në vrasjet e civilëve të pa armatosur. Duke qenë të vetëdijshëm se nocioni grupe "paramilitare" si struktura jashtë forcave të armatosura të një shteti, është shndërruar në instrument të manipulimit me opinionin publik në funksion të fshehjes së përgjegjësisë së strukturave politike dhe ushtarake të një shteti në kryerjen e krimeve të caktuara, propaganda serbe futi në përdorim këtë nocion. Fshehja e krimit të gjenocidit të kryer në Kosovë nga forcat e armatosura serbe dhe drejtimi

i gishtit të grupet "paramilitare" është pjesë e strategjisë së Serbisë për t'i ikur përgjegjësisë si shtet.

Ndërsa kur është fjala për pjesëmarrjen e ashtuquajturve grupe "paramilitare"¹⁶ në krimet e gjenocidit në Kosovë, përmendim faktin se gjatë procesit gjyqësor kundër Sllobodan Millosheviçit në Hagë, më 13 shkurt 2003, Aleksander Vasiljeviç, zëvendës shefi i drejtorisë së sigurisë së ushtrisë jugosllave deklaroi se "Tigrat" e Arkanit ishin nën kontrollin e drejtpërdrejtë të kolonelit të policisë speciale serbe Goran Radosavljeviç-Guri. Organizatat terroriste ortodokse serbe¹⁷ ku që të gjitha ishin pjesë e forcave të armatosura serbe dhe nën komandën shtetërore serbe, pa marrë parasysh emërtimet e tyre të ndryshme.

Gjatë viteve 1998-1999, shteti serb kreu gjenocid në shkallë të gjerë mbi shqiptarët. Forcat e armatosura serbe, në zbatim të urdhrave të marra nga drejtuesit më të lartë shtetërorë përdorën mjetet më çnjerëzore për të shkatërruar çdo gjurmë shqiptare në Kosovë. Plaçkitjet, hedhja e helmeve nëpër puse, përdorimi i helmeve kimike dhe disa armë të tjera të ndalura nga konventat ndërkombëtare, fshirja e identitetit; zhdukja e dokumenteve pronësore dhe targave të automjeteve; torturimi i civilëve; puna e dhunshme; përdhunimet; shtatzënia e dhunshme; sterilizimi i dhunshëm; vrasjet, masakrat, fshehja (djegia) e kufomave etj., ishin të planifikuara nga Serbia, prandaj të gjitha krimet e kryera kishin karakter institucional. Të gjitha këto veprime që ndërmori Serbia ishin në funksion të gjenocidit dhe politikës së saj për serbizimin e Kosovës. Pra, pas gjithë kësaj që u argumentua, nuk ka asnjë dyshim se në bazë të shumë fakteve dhe dëshmiqe që ekzistojnë, së atë çfarë e ka bërë shteti serb në vitet e luftës 1998-1999 është gjenocid i pastër dhe se duhet të dënohet dhe të shpallët fajtor për krimet e bëra.

1 Ibrahim Gashi, *Kosova rruga të Pavarësia*, Tiranë 2012, f. 77.

2 Diana Skrapari, *Lufta e Kosovës*, Tetovë 2018, f.83-84.

3 Sylë Ukshini, *Lufta për Kosovë*, Prishtinë 2008, f. 198.

4 Fikret Karçiç, *Myslimanët e Ballkanit*, Tiranë 2016, f. 231-232.

5 Sylë Ukshini, *Lufta Për Kosovë*, f. 234-235.

6 Fehmi Ajvazi, *Komploti*, Prishtinë 2011, f. 51.

7 Fetnete Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë pa Apologji (vëllim 2) më fakte kundër shpifjeve*, Prishtinë 2008, f. 105.

8 Faton Mehmetaj, *Veprimtaria kriminale e "Dorës së Zezë" serbe në trojet shqiptare*, Prishtinë 2004, f. 381.

9 Faton Mehmetaj, *Lufta speciale e shërbimeve sekrete serbe kundër Kosovës pas shpalljes së Pavarësisë*, Prishtinë 2012, f. 174.

10 Faton Mehmetaj, *Veprimtari e shërbimeve sekrete serbe kundër Kosovës*, Prishtinë 2009, f. 141.

11 Bardhyl Mahmuti, *Mashtrimi i madh*, f. 172.

12 Po aty, f. 242.

13 Petrit Imami, *Serbët dhe shqiptarët ndër shekuj (vëllime 2)* Samizdat B92, Beograd. 2017, f. 266.

14 Florenc Hartman, *Paqja dhe ndëshkimi*, Koha, mars 2011, f. 138.

15 Bardhyl Mahmuti, *Kurthet terminologjike në funksion të mohimit të gjenocidit në Kosovë*, f. 47.

16 Po aty, f. 48.

17 Mr.sc. Ruzhdi Jashari, *Dosjet e dokumenteve dhe dëshmitë e sekreteve serbe*, Prishtinë, 2013, f. 20-21.

Rezistenca – nga historia në ndërgjegje

PhD. Merjeme Gashi

Duke qenë se ne, shqiptarët e Kosovës, kemi përjetuar një luftë relativisht jo shumë kohë më parë, do të pritej që të kishim një ndjeshmëri të veçantë ndaj dhimbjes së popujve të tjerë që sot përjetojnë tragjedi të ngjashme. Sot është duke u ushtruar një gjenocid para syve të botës. Pa filtra, pa efekte. Për njëzet e dy muaj rresht. I gjithë globi është dëshmitar i shkatërrimit të një vendi dhe zhdukjes së një populli.

Në retrospektivë, kur shqiptarët përballeshin me copëtim të trojeve dhe me kërcënime ekzistenciale, Kongresi i Berlinit kishte injoruar tërësisht çështjen shqiptare. Kështu, vendimet e atij Kongresi rrezikuan copëtimin e trojeve shqiptare në favor të shtet kombeve të reja fqinje si, Malit të Zi, Serbisë e Greqisë. Kjo bëri që shqiptarët për qëllime mbrojtëse të rezistonin dhe të organizoheshin. Në një letër të shkruar nga fiset shqiptare të Malësisë së Madhe drejtuar konsullatës austro-hungareze, italiane, angleze dhe franceze, në mënyrë kategorike kundërshtohet dhënia e Plavës, Gucisë, Hotit, Grudës, Kelmendit dhe viseve të tjera që sipas marrëveshjes ndërkombëtare i takonin Malit të Zi. Në këtë petition të shkruar më 4 prill 1880 ata shpreheshin kështu: “...Ndryshimi i racës, besimit, zakonet e lirisë, që kemi fatin me gëzu janë në kundërshtim me aneksimin e pretenduar. Prandaj s’ka njeri që mos të dijë privilegjet që qeveria e Naltmadhnisë së Tij Sulltanit na ka akordua në të gjitha anët, e ushtrimi i besimit, gjuhës e zakoneve janë prova të gjalla të kënaqjes sonë të plotë që jemi pjesëtarë të perandorisë së lumnueshme të Naltmadhnisë së Tij Sulltanit, me të cilat na ka lidhë tradita shekullore nderi e besnikërie. Dëshirojmë me jetu e me gëzu lirinë, për të cilën jemi kryenaltë; ndryshe na nuk kishim me ndejt pa kundërshtu cilindo qoftë për ndrimin e modifikimit të fatit tonë e të status-quosë. Prandaj kemi vendosë me derdhë gjakun deri në pikën e fundit para se të hyjmë në zgjedhën e ndonjë qeverie të huaj.”¹ Fjalja “kemi vendosë me derdhë gjakun deri në pikën e fundit para se të hyjmë në zgjedhën e ndonjë qeverie të huaj” nuk ishte vetëm një

deklaratë politike. Ishte rezistenca e një populli që nuk pranon të shuhet dhe dorëzohet. Dhe çuditërisht, një rezistencë e ngjashme dëgjohet edhe sot nga Gaza.

Petitioni i fiseve malësore nuk ishte një rast i izoluar i kohës apo një përjashtim. Dokumente të tjera arkivore, siç është edhe një deklaratë e banorëve të Ulqinit drejtuar Konsullit Kirby Green gjatë vitit 1880, dëshmojnë qartësisht të njëjtin qëndrim. Në letrën e tyre ata shpreheshin si vijon: “Ne banuesit e Ulqinit, që prej shekujsh kemi qenë nën dominimin e Lartmadhërisë së Tij Sulltanit, dhe meqë gjuha, zakonet, dhe feja jonë janë të kundërta nga ato të Malit të Zi, pranon të vdesë dhe plotësisht të shlyhet nga faqja e dheut sesa t’i aneksohet Malit të Zi, ose të hyjë nën qeverinë e egër të tij, e në këtë mënyrë të jetë i ndarë nga Qeveria e drejtë e Lartmadhërisë së Tij perandorake.”²

Nga këto deklarata të shqiptarëve të asaj kohe shihet një rezonancë e thellë mes këtij qëndrimi dhe asaj që ndodh sot në Gaza. Shqiptarët në fund të shekullit XIX dhe palestinezët sot, janë përballur me plane për t’u aneksuar, për t’u shuar ose për t’u shndërruar në pakica nën sundimin e një tjetri. Të dyja palët kanë ngritur rezistencën jo si akt dëshire për luftë, por si një refuzim i nënshtrimit. Rezistenca palestineze në



Gaza, me gjithë kompleksitetin e saj, të shtyn të mendosh më thellë për atë nëpër çka kanë kaluar dhe çfarë kanë ndjerë dikur shqiptarët në përballje me copëtimin, me rrezikun e humbjes së tokës, dëbimin nga ajo dhe humbjen e lirisë. Një lexim i tillë i historisë mundëson të kuptojmë dhe përjetojmë ndryshe të kaluarën tonë, duke parë në sytë e një populli tjetër që sot përpiqet të mbijetojë, të ruajë identitetin, të mos dorëzohet, edhe atëherë kur bota hesht ose i mbyll sytë.

Shqiptarët e fundshekullit XIX kishin përballë Fuqitë e Mëdha dhe lakmitë territoriale të fqinjëve. Palestinezët sot përballen me një izolim të skajshëm, pushtet të pamëshirshëm që mohon çdo të drejtë elementare të njeriut. Por ndjenja themelore është e njëjtë: ajo e rezistencës, e së drejtës për të jetuar në tokën tënde pa rrezikuar ekzistencën dhe tëhuajësimin.

Leximi i letrës së shkruar nga krerët e fiseve malore në vitin 1880, të cilët kishin përkatësi fetare me shumicë katolike, por që shprehnin besnikëri të plotë ndaj Sulltanit dhe Perandorisë Osmane, logjikisht çon në një pyetje tjetër. Si është e mundur që një dokument kaq i qartë, i shkruar në emër të vetë shqiptarëve të kohës, të bie kaq shumë në kundërshtim me narrativen historike që sot mbizotëron në shumicën e historiografisë shqiptare? Si ka mundësi që një pjesë e mirë e historianëve bashkëkohorë ende i qasen Perandorisë Osmane me një gjuhë thuajse ideologjike: si “pushtuese”, “shfarosëse”, “e errët”, dhe “pengesë për ndërtimin e kombit shqiptar”?

Në përgjithësi, dihet se në historiografinë e vendeve pasuese të Perandorisë Osmane, periudha osmane përshkruhet me terma negativë si “pushtim”, “shtypje” e të ngjashme. Porë nga paradigma moderniste/zhvillimore, që në fillim të proceseve të ndërtimit të kombeve, është prodhuar ideja se sundimi osman përbënte pengesën kryesore për zhvillimin apo modernizimin e popujve të rajonit. Ky përfytyrim për periudhën osmane është riprodhuar vazhdimisht nga historiografia zyrtare/kombëtare, e cila ka qenë një nga mjetet më të rëndësishme për konsolidimin e proceseve të ndërtimit të shteteve-komb.³ Kjo mbështetet mbi bindjen se për të ndërtuar shtetin dhe kulturën kombëtare, si dhe për të formësuar identitetin kombëtar, është e domosdoshme zhvillimi i një qëndrimi kundërshtues ndaj së kaluarës. Halil İnalçık argumenton se teoria e “nënshtrimit osman” është përdorur nga historianë ballkanikë dhe arabë si një mënyrë për të shpjeguar

Halil İnalçık argumenton se teoria e “nënshtrimit osman” është përdorur nga historianë ballkanikë dhe arabë si një mënyrë për të shpjeguar prapambetjen e perceptuar ndaj kombeve të Evropës Perëndimore.

prapambetjen e perceptuar ndaj kombeve të Evropës Perëndimore.⁴

Lidhja e Prizrenit, në historiografinë shqiptare, pasqyrohet si një kryengritje popullore anti-osmane, dhe si një “zgjim” politik e ushtarak.⁵ Ndërsa dokumentet arkivore së bashku me memoaret e bashkëkohësve dëshmojnë se ishte pikërisht Porta e Lartë ajo e cila jo vetëm që e mbështeti dhe ia dha dritën e gjelbër kësaj Ldhjeje, por edhe kontribuoi në themelimin e saj.⁶ Shqiptarët e Lidhjes së Prizrenit, në pjesën dërrmuese, nuk luftuan për pavarësi nga Perandoria Osmane. Ata luftuan për ruajtjen e tokave shqiptare brenda asaj perandorie, për të shmangur copëtimin prej fqinjëve ballkanik. Besnikëria e tyre ndaj Sulltanit nuk vinte nga servilizmi, por nga bindja se ajo perandori u garantonte një status që, të paktën në atë moment, ishte më i favorshëm se çdo alternativë tjetër. Mund të thuhet se Lidhja e Prizrenit para se të kishte karakter etnik dhe agresiv, kishte një karakter mbrojtës.

Po ta lexojmë me ndershmëri, historia osmane për shqiptarët nuk është një kapitull i zi, është një periudhë me dritëhije, ku shqiptarët jo vetëm që rezistuan, por edhe u ngritën, u bënë pjesë e elitave administrative dhe ushtarake, formuan një klasë intelektuale të re, dhe më vonë, kur koha erdhi, përdorën edhe vetë institucionet osmane për të formësuar projektin kombëtar.

Edward Hallett Carr në librin e tij *What is History* (1961), ka thënë se: “Faktet janë të disponueshme për historianin në dokumente, mbishkrime e kështu me radhë, sikurse peshqit në pllakën e peshkatarit. Historiani i mbledh ato, i çon në shtëpi, i gatuan dhe i shërben në çfarëdo stili që i pëlqen.”

- 1 Public Record Office, London, *F. O. 195/1303*; The British Museum London, *Accounts and Papers (43). 1880. LXXXII. 82, 326*; në Skender Rizaj, Skender Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në Dokumentet Angleze*, (Prishtinë: Arkivi i Kosovës, 1978), 138-139.
- 2 Public Record Office, London, *F. O. 195/1303*; The British Museum, London, *Accounts and Papers, (44). 1881. C. 100, 92*; në Skender Rizaj, *op. cit.*, 166.
- 3 Bülent Bilmez, Arnavutluk Tarih Ders Kitaplarında Osmanlı/Türk İmgesi, *Osmanlı Araştırmaları*, XLIX, (2017), 352.
- 4 Halil İnalçık, Fransız Annales Ekolü ve Türk Tarihçiliği, *Osmanlı ve Modern Türkiye*, (İstanbul: Timaş Yayınlar, 2018), 271.
- 5 Kristo Fashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, (Tiranë: Toena, 1997), 92.
- 6 Eqrem bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, (Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2003), 159.

Masakra e Srebrenicës e vitit 1995 në Bosnje e Hercegovinë në dritën e shtypit shqiptar në Kosovë (2)

Nuridin Ahmeti

SREBRENICA U SHIT PARA GJASHTË MUAJVE!

Ky është titulli i të përditshmes “Bujku” në Kosovë i datës 17 korrik të vitit 1995, të cilin material e kishte përgatitur korrespondenti i kësaj gazete në Bon të Gjermanisë Jusuf Buxhovi, i cili duke ju referuar emisionit të njohur të “Preseclub” të Televizionit Gjerman, shkruante se në një mbledhje të fshehtë në Gjenevë të Zvicrës të mbajtur nga Grupi i kontaktit për Bosnjën, në muajin dhjetor të vitit 1994, anglezët, francezët dhe rusët ishin pajtuar që Srebrenica dhe Zhepa t’u jepen serbëve, me qëllim që t’i joshin serbët për të pranuar marrëveshje paqeje me bashkësinë ndërkombëtare. Me një fjalë, e gjithë kjo që ndodhi në Srebrenicë ishte e planifikuar. Sipas përshkrimit të gazetës që botohej në Kosovë, gazetari i gazetës “Tageszeitung” Andreas Zunach, atë që ndodhi në Srebrenicë e kishte quajtur si bankrotim moral të Perëndimit në Bosnje, dhe se Grupi i Kontaktit të cilin gazetari i quan “trojka” pro serbe, me qëllim të “qartësimit etnik” të Bosnjës kishte rënë dakord që Srebrenicën dhe Zhepen t’ua jepnin serbëve. Politika e Parisit, Londrës dhe Moskës, ka qenë në një linjë me atë të Serbisë. Se Srebrenica u është dorëzuar serbëve, këtë mendim e mbrojnë edhe gazetari holandez Ben

Franca, Anglia
dhe Rusia
gjithnjë kanë
qenë të
mendimit se
Bosnja e ndarë
është fakt që
duhet të
akceptohet
dhe se
bashkësia
ndërko-
mbëtare duhet
të bëjë çmos
që një gjendje
e tillë të bëhet
edhe realitet...

Kapen. Shkrimi përfundon me konstatime se, pavarësisht si ka ndodhur ngjarja në Srebrenicë, Perëndimi ka pësuar bankrot moral “pa marrë parasysh se a kanë ekzistuar apo jo prapaskenat e ndryshme, që kanë përgatitur rënien e Srebrenicës dhe çfarë fshihet prapa një veprimi të tillë, ekziston bindja se, tash për tash, Perëndimi ka përjetuar një bankrot të madh moral, të cilin duhet ta përmirësojë sa më shpejt dhe sa më mirë, dhe se, kjo mund të bëhet vetëm po që se respekton parimet morale e njerëzore, në mënyrë që për të vendosur, madje edhe po u detyruan që këtë ta bëjë me anën e intervenimit ushtarak. Sepse, edhe taktika, edhe diplomacia, edhe durimi, një ditë mund të shpenzohen siç po ndodh në Bosnje...”¹ Siç duket, për këtë favor që u kishin bërë forcat ndërkombëtare serbeve, duke i lenë të lirë të veprojnë në Srebrenicë, ata do të shpërblehen nga makineria serbe, me lirim të forcave holandeze të cilët i kish marrë pengë. Shtypi shkruante se serbët i liruan 55 holandezë.²

Për hir të korrektësisë, shkrimin e J. Buxhovit, të botuar në të përditshmen “Bujku”, në Kosovë po e botojmë në tërësinë e tij, ku shkruan: “Pak ditë pas rënies së Srebrenicës në duart e serbëve dhe shpërthimit të një tragjedie të paparë të popullatës boshnjake faqe botës, në opinion përditë e më shumë po



dalim fakte të reja, që vërtetojnë dyshimet e kamotshme se kjo që ndodhi ka qenë e programuar dhe e kurdisur nga disa qarqe brenda përbrenda korifeut të vendosjes, cili ka mandatin për rregullimin e hapësirës së ish-Jugosllavisë. Në emisionin e sotëm special të programit të parë të televizionit gjerman “Presociub” u tha se në Bosnjë, Perëndimi bankrotoi moralisht dhe se kjo do të ketë pasoja të rënda jo vetëm për Ballkanin, por edhe për të. Gazetari i gazetës “Tageszeitung” Andreas Zunach këtë bankrot moral të Perëndimit e arsyetoi me faktin se brendapërbrenda grupit të Kontaktit për Bosnjë- Hercegovinën ka ekzistuar dhe ekziston edhe sot e gjithë ditën një tendencë, e cila parapëlqen ndarjen e Bosnjë-Hercegovinës në tri pjesë etnike. Franca, Anglia dhe Rusia gjithnjë kanë qenë të mendimit se Bosnja e ndarë është fakt që duhet të akceptohet dhe se bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjë çmos që një gjendje e tillë të bëhet edhe realitet, në mënyrë që në hapësirat e ish-Jugosllavisë të mbizotërojë paqja. Gazetari Zunach konstaton se në një mbledhje të fshehtë të Grupit të Kontaktit në Gjenevë, në dhjetor të vitit të kaluar, “trojka” pro serbe (Rusia, Anglia, Franca) është pajtuar që Srebrenica dhe Zhepa, e mbase dikur edhe Gorazhda, t’u dorëzohen serbëve, në mënyrë që pastaj të bëhet “qartësia etnike” në Bosnjë dhe akceptimi i planit të bashkësisë ndërkombëtare nga serbët. Parisi, Londra dhe Moska kanë qenë të një mendjeje se “serbëve duhet t’u bëhen koncesione”, për shkak të “pozitës së fituesit në front” dhe faktit se ata “nuk do të pranojnë kurrë që Lindja e Bosnjës të jetë myslimane! Në këtë mbledhje, konstaton Zunach, amerikanët dhe gjermanët ndonëse kundërshtuan, nuk vunë veto, por gjërat i lanë “të hapura”, gjë që le për të kuptuar se edhe ata u mëdyshen... Zhvillimi i ngjarjeve dhe ato që ndodhen këto ditë, bëjnë të ditur se “trojkës” së kamotshme iu bënë koncesione, çmimin e të cilit po e paguan sot popullata boshnjake. Madje, gazetari Zunach, zhurmën dhe gjoja shqetësimin e Shirakut, e

disa të tjerëve në Perëndim, e konsideron si farsë të pamoralshme, e cila ka për qëllim që para opinionit të fshehtë prapaskenat dhe lojërat që janë bërë pikërisht nga perëndimorët. Edhe gazetari holandez Ben Kapen është i mendimit se Srebrenica u është dorëzuar serbëve dhe se “brengosjet” dhe “reagimet” e Perëndimit ishin një farsë e paskrupullt që flet se këtu pati hile të mëdha. Këtë konstatim ai e ilustron me reagimin e komandantit holandez të helmetëkaltërve në Srebrenicë, i cili katër ditë rresht ka kërkuar ndihmë nga Qendra e OKB-së në Sarajevë dhe Zagreb dhe se ditën e fundit, komandantët francezë dhe anglezë, të cilët janë përgjegjës për të kërkuar intervenimin ushtarak të NATO-s, thuajse në mënyrë sarkastike i thanë “se aty asgjë nuk mund të ndryshohet” dhe se “bëj përpjekje të mos iu shkaktosh telashe helmetëkaltërve” pra “që të mos i hidhërosh serbët”. Gazetari Kapen është i mendimit se bombardimi sa për sy e faqe i dy tankeve të vjetra serbe ishte mashtrim optik dhe asgjë tjetër, për të cilin pastaj rusët e kapen çastin që ra Srebrenica, gjoja që nuk u konsultuan. Edhe rreth se ashtuquajturës letër që Akashi ia ka dhënë Karaxhiqit para një muaji, si “garanci” se trupat për veprim të shpejtë nuk do të bëjnë tjetër pos do të sillen si helmetëkaltërit, pra që nuk do t’i sulmojnë serbët, u tha se atë e shkruan dhe e nënshkruan ambasadorët e Francës, të Anglisë dhe të Rusisë pranë Këshillit të Sigurimit! Akashi, u tha, ka bërë vetëm punën e postierit të thjeshtë dhe asgjë tjetër, siç e bënë edhe Gali e nëpunësit e tjerë të Kombeve të Bashkuara. Në opinion, jo rrallë, spekulohet me rolin e Akashit dhe të Galit, gjoja se ata po i penguan sulmet eventuale të NATO-s dhe po sillkan mosmarrëveshje dhe konfuzitet midis helmetëkaltërve e NATO-s! Në këtë emision, gazetarët mysafirë, për herë të parë para opinionit gjerman, dëshmuuan se nuk është Organizata Botërore ajo që “po na i frenuaka veprimet kundër serbëve”, por pikërisht është Perëndimi, në radhë të parë francezët,

anglezët, të cilët bëjnë kalkulime joparimore në njërën anë, duke kokëtuar me rusët, e në anën tjetër, demonstrojnë “muskujt” dhe “gatishmërinë që t’i ndihmohet çështjes së drejtë të Bosnjë-Hercegovinës”. Gazetarja amerikane Alison Smole lidhur me dyfytërsinë e theksuar të disa faktorëve perëndimorë rreth Bosnjës dhe krizës së Ballkanit në përgjithësi, deklaroi se kjo i ka shtyrë amerikanët që ata të përmbahen paksa, por kjo nuk do të thotë se kështu do të jetë përgjithmonë. Para dy vjetësh Amerika ka qenë e vendosur që në Ballkan të intervenojë, në mënyrë që t’i ndalet turri soldateskër serbe, qëllimet e së cilës kanë qenë të qarta. Francezët, anglezët dhe rusët, në radhë të parë francezët, ishin ata që jo vetëm nuk morën pjesë në këtë projekt, por minuan atë me arsyetim sdo të gjenden zgjidhje paqësore konform parimeve ndërkombëtare! Tash, të njëjtit kërkojnë që amerikanët të jenë më aktivë. Natyrisht se amerikanët nuk mund të lejojnë që në Ballkan të krijohen raporte që i dëmtojnë interesat e saj dhe të Perëndimit, por ata kërkojnë të mos luhen lojëra të dyfishta. Gazetarja Smole mendon se Srebrenica përfundimisht ka treguar se koncepti i tanishëm i helmetëkatërve nuk mund të mbahet dhe se duhet të bëhet një kthesë radikale, e cila në plan të parë nënkupton vendosmërinë dhe unitetin e faktorit ndërkombëtar, në radhë të parë të perëndimorëve. Megjithatë, pa marrë parasysh se a kanë ekzistuar apo jo prapaskenat e ndryshme, që kanë përgatitur rënien e Srebrenicës dhe çfarë fshihet prapa një veprimi të tillë, ekziston bindja se, tash për tash, Perëndimi ka përjetuar një bankrot të madh moral, të cilin duhet ta përmirësojë sa më shpejt dhe sa më mirë, dhe se, kjo mund të bëhet vetëm po që se respekton parimet morale e njerëzore, në mënyrë tepër të vendosur, madje edhe po u detyruan që këtë ta bëjë me anën e intervenimit ushtarak. Sepse, edhe taktika, edhe diplomacia, edhe durimi, një ditë mund të shpenzohen siç po ndodh në Bosnjë...”³

Gjatë operacionit të pushtimit të Srebrenicës nga forcat serbe, një pjesë e ushtarëve holandezë ishin marrë pengë, pas kryerjes së operacionit, gazeta njoftonte se 55 paqeruajtësit holandezë u liruan dhe me aeroplan speciale u larguan për në vendin e tyre.⁴

Qeveria e Republikës së Shqipërisë po ndjek me vëmendje dhe shqetësim zhvillimet e ditëve të fundit në Republikën e BH-së. Ajo shpreh indinjatën e saj për politikën dhe veprimet agresive serbe, të cilat kanë intensifikuar dhe rritur dhunën mbi popullsinë civile boshnjake.

Më 19 korrik 1995, mediat shkruanin se i pari i OKB-së, Butros Gali, e kishte anuluar vizitën e planifikuar në Turqi. Këtë anulim, zëdhënësi i qeverisë turke, e kishte arsyetuar se në momentet që ishte planifikuar vizita, Gali kishte vizitë më të rëndësishme në Gjenevë, sipas tij “Butros Gali shtyri vizitën, ngase s’mund ta linte Gjenevën, në kohën kaq kritike për Bosnjën!”⁵ Në fakt, sipas informatave të korrespondentes së “Bujkut” në Turqi, “sekretari i përgjithshëm nuk erdhi, sepse Turqia nuk e dëshironte. Që kur u shpall lajmi për vizitë, të gjithë u ngritën në këmbë, duke protestuar haptas në rrugët e Stambollit, Ankarasë, Izmirit, Bursës. Revoltën e tyre e shkaktoi qëndrimi i Galit dhe i organizatës që i prin lidhur me luftën në Bosnjë. Ditëve të fundit vërshojnë pamjet tronditëse nga Bosnja e shkatërruar. Të gjitha emisionet informative në radiotelevizion fillojnë me ngjarjet e fundit dramatike pas rënies së Srebrenicës dhe tashti Zhepës, e që lënë nën hije luftën e pashpallur të ushtrisë turke kundër pjesëtarëve të Partisë Popullore të Kurdistanit”.⁶ Me një fjalë, Butros Gali, ishte i padëshiruar në Turqi dhe druhej se prezenca e tij, mund të shkaktonte ndonjë revoltë atje.

E indinjuar nga ajo çfarë po ndodhte në Bosnje, Qeveria e Shqipërisë, lëshon një deklaratë, ku shprehet e shqetësuar me atë çfarë po ndodh në Bosnje. “Qeveria e Republikës së Shqipërisë po ndjek me vëmendje dhe shqetësim zhvillimet e ditëve të fundit në Republikën e BH-së. Ajo shpreh indinjatën e saj për politikën dhe veprimet agresive serbe, të cilat kanë intensifikuar dhe rritur dhunën mbi popullsinë civile boshnjake. Vazhdimi i gjenocidit, dhunës, spastrimit etnik në Srebrenicë dhe Zhepë, është sulmi i tanishëm i kombinuar i serbëve të Bosnjës dhe Krainës për pushtimin e enklavës së Bihaqit, i cili rrit ndjeshëm rrezikun e një komflagracioni më të madh në ish-Jugosllavi me efekte të paparashikueshme në gjithë rajonin e Ballkanit. Mbështetja që mbetja e ish-armatës jugosllave i jep në trupa, municion dhe teknike serbëve të Bosnjës dhe Krainës është një dhunim i hapur i së ashtu quajturës embargo që Beogradi zyrtar pretendon të aplikojë ndaj tyre. Qeveria e Republikës së Shqipërisë është e mendimit se



tani është momenti kur krahas vazhdimit të përpjekjeve diplomatike për një zgjidhje politike të konfliktit, komuniteti ndërkombëtar të marrë masa energjike dhe praktike për t'i dhënë fund agresionit dhe dhunës serbe. Një veprim i tillë i vendosur do të kontribuonte në zgjidhjen e konfliktit në Bosnjë dhe të krizës në ish-Jugosllavi, si dhe do të shërbente si një mjet parandalues ndaj shtrirjes së konfliktit në Jug⁷; shkruan në mes të tjerash në deklaratën e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

I revoltuar me indiferencën e Perëndimit ndaj asaj që po ndodhte në Bosnje, i deleguari special i KB-së për të drejtat e njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë Tadeush Mazovjecki, jep dorëheqje të pa revokueshme, duke akuzuar “bashkësinë ndërkombëtare se ka pranuar rënien e dy zonave të mbrojtura të KB-ve, Srebrenicës dhe Zhepës dhe se me këtë bashkësi ndërkombëtare pranoi edhe shkeljen e të drejtave të njeriut që pasoi pas pushtimit të këtyre zonave. Kjo për mua është e papranueshme”⁸- theksonte në mes të tjerash z. Mazovjecki.

PËRFUNDIM

Nga materialet e shfletuara në lidhje me këtë ngjarje, mund të thuhet se shtypi shqiptar i Kosovës, dhe gazeta e saj zyrtare ditore “Bujku”, kësaj ngjarje i dhanë jehonë. Shkrimet që bënin fjalë për Srebrenicën zënin faqen e parë. Drejtuesit e kësaj gazete nuk u mjaftonin vetëm me një lajm që e botonin në faqen e parë, por sipas nevojës ata publikonin edhe më shumë se një lajm, një, dy e tre lajme për këtë ngjarje në faqet e para. Zakonisht, lajmet e botuara në këtë gazetë i merrnin nga agjencitë e huaja të lajmeve perëndimore. Në muajin korrik, të vitit 1995, hasim lajme të konsiderueshme nga Gjermania në lidhje me luftën në Bosnje. Këto lajme përgatiteshin nga gazetari i ish-gazetës “Rilindja”, tani korrespondentë i gazetës “Bujku”, shkrimtari e publicisti i njohur Jusuf Buxhovi. Fajtori për të gjithë këtë që ndodhi në

Srebrenicë, ishte bashkësi ndërkombëtare. Ata, dëshironin ta shfajësonin vetveten, por realiteti ishte ndryshe. Të dhënat tregojnë se ata u treguan jo serioz në mbrojtjen e popullsisë myslimane boshnjake, dhe ky mos seriozitet, i atyre që i kishin dhënë garanci për mbrojtje, rezultoi ma masakrimin e kësaj popullate nga ushtria serbe. Këto aspekte shtypi i potenconte në vazhdimësi.

Shtypi në gjuhën shqipe në Kosovë, i beri jehonë të bujshme edhe dorëheqjes së të dërguarit special të KB-së për të drejtat e njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë, Tadeush Mazovjecki dhe deklaratës së tij. Ky personalitet u trajtua në disa vazhime në shtypin e Kosovës, duke vlerësuar si njeri guximtar e human.

Për udhëheqjen boshnjake dhe për analistët e ndryshëm nga bota, kjo ngjarje ka ndodhur si rezultat i neglizhencës së faktorit ndërkombëtar. Shtypi i muajit korrik i vitit 1995, pothuajse për çdo ditë botonte nga një e më shumë lajme që lidhen me Srebrenicën dhe me fatin e popullsisë boshnjake myslimane. Para muajit korrik, të vitit 1995 në shtyp, hasim lajme për Srebrenicën, varësisht se më çfarë intensiteti përmendej edhe nga agjencitë e ndryshme të lajmeve botërore, por kohë pas kohe hasim lajme, pothuajse deri në fund të vitit 1996.

- 1 J. Buxhovi, “Srebrenica u shit para gjashtë muajve!”, *Bujku*, 17 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1, 3.
- 2 “Serbët liruan 55 paqeruajtës holandezë”, *Bujku*, 17 korrik, Prishtinë, 1995, f. 3.
- 3 *Bujku*, 17 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1, 3.
- 4 *Bujku*, 17 korrik, Prishtinë, 1995, f. 3.
- 5 Qamile Blakçori, “Gali, mos eja”, *Bujku*, 19 korrik, Prishtinë, 1995, f. 3.
- 6 *Bujku*, 19 korrik, Prishtinë, 1995, f. 3.
- 7 H. M., “Me masa energjike të parandalohet agresioni serb”, *Bujku*, 26 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1.
- 8 “Mazovjecki heq dorë nga frikacaku Gali”, *Bujku*, 28 korrik, Prishtinë, 1995, f. 1.

Kontributi i El Frabiut (872 – 950) në zhvillimin e shkencës

M.sc Artan S. Mehmeti

Elbu Nasër Muhamed el Farabi, lindi në një fshat në afërsi të qytetit Farab (qyteti Farab sot mban emrin Otar) që ndodhet në Kazakistanin e sotshëm. Ai ishte i njohur për veprimtarinë e tij në filozofi shoqërore dhe fetare, logjikë, psikologji, metafizikë, filozofi politike, etikë, muzikë, si dhe për studime në astronomi, matematikë, kozmos, fizikë, urbanizëm dhe gjeografi.

Edhe pse kontributi i El Farabiut në gjeografi nuk është aq i drejtpërdrejtë sa në filozofi, logjikë apo muzikë, ndikimi i tij në zhvillimin e mendimit hapësinor dhe kozmologjik në botën islame është i rëndësishëm. Ai e trajtoi kozmologjinë e cila është e lidhur ngushtësisht me gjeografinë fizike, duke përshkruar strukturën e universit dhe lëvizjen e trupave qiellorë sipas modelit aristotelian-ptolemeik. Kjo ndikoi në formimin e një kuptimi shkencor dhe filozofik mbi hapësirën. El Farabiu e analizoi në mënyrë të detajuar edhe organizimin hapësinor dhe social të qyteteve duke kontribuar në zhvillimin e shkencës së urbanizmit.

Në librin më titull “Risala fi’l- ‘ Akl”, El Farabiu zhvillon një trajtim të thelluar të intelektit, duke e ndarë atë në nivele dhe funksione, nga intelekti potencial deri tek intelekt i fituar dhe ai aktiv. Sipas tij, vetëm përmes zhvillimit të intelektit njeriu mund të arrijë të kuptojë rendin e universit dhe të hyjë në një marrëdhënie harmonike me të. Ky libër është themelor për të kuptuar se si njohuria dhe mendimi racional ndikojnë në perceptimin e kozmosit. Këto teori ndihmuan në përfytyrimin e një universi të organizuar sipas parimeve të qëllimit dhe rendit, duke ofruar një kornizë konceptuale që

ndikoi më vonë në zhvillimin e modeleve gjeografike dhe astronomike, si dhe në studimet e mjedisit.

Në librin “Kitab el Xham’ bajna Ra’ jaj el Hakimajn”, El Farabiu bënë një analizë të detajuar të filozofisë së Platonit dhe Aristotelit, duke u munduar për të krijuar një harmoni në mes pikëpamjeve të tyre filozofike për natyrën e universit



El Farabiu



dhe vendin e njeriut brenda këtij universi. Kjo vepër ndihmoi zhvillimin e mendimit filozofik mbi universin, duke u bërë burim bazë edhe për studimet e mëvonshme që pasuan në shkencën e astronomisë dhe kozmografisë.

“Kitab el Musika el Kabir”, në këtë libër ai nuk kufizohet në një trajtim të konceptit të muzikës, por përkundrazi ai e sheh atë si një pasqyrim të harmonisë që sundon në kozmos. Përmes analizës së strukturave muzikore, intervaleve dhe modaliteteve, El Farabiu e identifikon një rend universal që ka analogji të drejtpërdrejta me rregullin e trupave qiellorë dhe të realitetit metafizik. Muzika, sipas tij, është një disiplinë që na lejon të kuptojmë lëvizjet harmonike të universit dhe të vetë shpirtit njerëzor. Në këtë kuptim, muzika bëhet një mënyrë e perceptimit të rendit kozmik dhe një formë e thelluar e dijes.

Në fushën e filozofisë politike dhe urbanizmit, El Farabiu shkroi librin më titull “Kitab el Madina el Fadila”. Në këtë libër, ai e harton një model të qytetit ideal si pasqyrë e rendit kozmik. Ky qytet sipas tij është një bashkësi e ndërtuar mbi virtytin, dijen dhe bashkëpunimin racional, ku çdo individ kryen funksionin e tij në harmoni me qëllimin e përgjithshëm të bashkësisë.

Modeli i qytetit ideal i paraqitur nga El Farabiu është i bazuar në dy shtylla të filozofisë aristoteliane: konceptin e formës (morf) si parim organizues dhe nocionin e qëllimit (telos) si drejtim evolucionar. Ky sistem teorik është i kombinuar me parime etike dhe metafizike të traditës islame. Sipas tij, qyteti ideal duhet të udhëhiqet nga një filozof i ditur, i cili, duke pasur njohuri të së vërtetës, orienton qytetarët drejt lumturisë shpirtërore dhe zhvillimit të plotë të potencialit të tyre njerëzor. Këto ide, të shprehura në veprën e tij mbi organizimin politik të shoqërisë, kanë lënë gjurmë të rëndësishme në studimet e mëvonshme të gjeografisë politike dhe urbanizmit. Në veprën e tij, ai e koncepton qytetin si një entitet dinamik ku ndërthuren ngushtë dimensionet fizike, politike dhe shpirtërore.

Në librin e titulluar “Kiab el Sijasa el Madaniija”, El Farabiu analizon më tej marrëdhëniet midis shtetit dhe qytetarit, duke propozuar një qeverisje të bazuar në virtyte dhe dituri (arsimim), ku ligjet dhe institucionet shërbejnë për të realizuar rendin dhe mirëqenien shoqërore. Kjo vepër ka shërbyer si një burim i rëndësishëm për teoritë e mëvonshme mbi organizimin politik dhe urban, duke e lidhur drejtpërdrejt filozofinë me praktikën e urbanizmit. Modeli i propozuar nga El Farabiu nuk është thjesht teorik, por paraqet një kornizë praktike për organizimin e hapësirave urbane dhe jetën në qytete, ku arsimit dhe drejtësia janë parime udhëheqëse.

Në fushën e gjeografisë dhe marrëdhënies së saj me mjedisin, El Farabiu kontribuoi përmes veprës së tij “Kitab el Huruf”. Edhe pse kjo vepër është kryesisht një trajtim logjiko-filozofik mbi gjuhën dhe sqarimet e koncepteve, gjithashtu ka pasur edhe një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e mendimit gjeografik dhe në kuptimin e marrëdhënies në mes njeriut dhe mjedisit. Në këtë vepër, El Farabiu trajton lidhjen ndërmjet gjuhës, koncepteve dhe realitetit, duke theksuar se përdorimi i termave ndikon drejtpërdrejt në perceptimin dhe organizimin e botës. Kjo qasje ndihmon formësimin e kategorive gjeografike si hapësira, vendi dhe kufijtë, duke sqaruar nocionet e “hapësirës”, “lëvizjes” dhe “ndryshimit”. Gjithashtu, vepra ofron një bazë teorike të gjerë për analizimin e marrëdhënieve në mes njeriut dhe natyrës, si dhe kontribuon në strukturimin dhe sqarimin e koncepteve të mjedisve natyrore brenda kontekstit të filozofisë islame.

Në veprën “Ihsa’ el’ Ulum”, El Farabiu propozon një klasifikim sistematik të të gjitha disiplinave të njohura të kohës së tij, duke përfshirë logjikën, matematikën, shkencat natyrore, metafizikën dhe shkencat praktike. Një nga disiplinat që ai i kushtoi një vëmendje të veçantë në këtë sistem ishte gjeografia, të cilën e sistemoi si pjesë integrale e shkencave që i studiojnë realitetin fizik dhe hapësinor. Disiplinën e gjeografisë El Farabiu e sistemon në lidhje të ngushtë me disiplinat e tjera siç janë: astronomia, meteorologjia dhe filozofia natyrore. Kjo ndërthurje pasqyron

Farabiu ka ndërtuar një bazë të fuqishme filozofike, teorike dhe metodologjike që ka ndikuar në mënyrë thelbësore në lindjen dhe zhvillimin e mendimit gjeografik në botën islame.

synimin e tij për të kuptuar mjedisin fizik si një element të një strukture më të gjerë dhe të organizuar të universit. Nëpërmjet kësaj qasjeje, ai thekson rolin e gjeografisë jo vetëm si shkencë përshkruese, por edhe si mjet për të interpretuar ndikimin e mjedisit në jetën dhe zhvillimin e shoqërive njerëzore. Kështu, në "Ihsa' el' Ulum", gjeografisë i është dhënë një vend i rëndësishëm në hartën e dijes, duke reflektuar dhe pasqyruar përpjekjen e El Farabiu për të kuptuar mjedisin si pjesë e një strukture më të gjerë dhe të organizuar të universit.

Megjithëse El Farabiu nuk e studioi direkt gjeografinë, studimet e tij filozofike mbi natyrën dhe organizimin shoqëror krijuan një bazament teorik që u shërbeu brezave të mëvonshëm të gjeografëve dhe filozofëve për të eksploruar ndërveprimet në mesë hapësirës fizike dhe realiteteve shoqërore e politike. Në këtë mënyrë, El Farabiu mund të konsiderohet si një ndër themeluesit e paradigmes filozofike që kontribuoi në formësimin e gjeografisë politike dhe asaj njerëzore në botën islame. Këto ide filozofike u shndërruan në pikënisje për studiuesit myslimanë si: Ibën Sina, El Biruni dhe Ibën Halduni, të cilët i zhvilluan më tej në disiplinat shkencore si në gjeografinë fizike, astronomi dhe etnografi. Veçanërisht i rëndësishëm është ndikimi që El Farabiu ka pasur tek Ibën Halduni, i cili në veprën e tij "Mukaddimeh" (Prologomena), *jo vetëm iu referua, por edhe i zhvilloi dhe i thelloi edhe më tej konceptet e shtetit ideal dhe të organizimit shoqëror, duke u bazuar në ato që El Farabiu kishte ndërtuar brenda kuadrit të filozofisë politike.*

Gjithashtu, edhe dijetarët e tjerë të shquar si El Mesudi, në veprën e tij "Muruxh'udh dhebebi ve me'adin ul xhevher", dhe El Biruni, në "Kitab'ul Tarihu'l Hind", adoptuan metoda filozofike të ndërthurura me vëzhgime sistematike dhe metodologjinë empirike, të cilat u formuluan dhe u përdorën nga El Farabiu. Përdorimi i këtyre metodave, këtyre studiuesve ju mundësoi të

zhvillonin kërkime më të thelluara dhe më të strukturuar në fushat e gjeografisë, etnografisë dhe historisë natyrore.

Si përfundim, mund të konstatojmë se, pavarësisht nga fakti se El Farabi nuk u përkushtua drejtpërdrejt studimeve gjeografike dhe nuk shkroi vepra të dedikuara kësaj disipline, ai ka ndërtuar një bazë të fuqishme filozofike, teorike dhe metodologjike që ka ndikuar në mënyrë thelbësore në lindjen dhe zhvillimin e mendimit gjeografik në botën islame. Konceptet e tij mbi natyrën e universit, rendin shoqëror dhe rolin arsyetues, luajtën një rol themelor në konsolidimin e gjeografisë si një disiplinë e veçantë dhe e pranuar gjerësisht brenda traditës shkencore islame.

Burimet:

- Prof. dr. Fuat Sezgin, *Epoka e madhe e panjohur, nga historia e shkencës dhe e teknologjisë islame*, përktheu nga turqishtja: Altin Qefaliu, LOGOS-A, Shkup 2015;
- Sami Frashëri, *Qytetërimi Islam*, LOGOS-A, Shkup 2009;
- Sigrid Hunke, *DIELLI I ALLAHUT SHKËLQEN MBI PERËNDIMIN* Trashëgimia jonë arabe, Shqipëroi nga frëngjishtja Ornella Ademovi, Tiranë 2007;
- Ahmed Essa, Othman Ali, *STUDIME NE QYTETËRIMIN ISLAM* Kontributi Mysliman në Rilindje, përktheu: Festime Mehdiu Gashi, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC), Tiranë 2019;
- Xhorxh Sarton, *Historia e Shkencës Islame*, Përktheu, plotësoi me shtojcë dhe përgatiti për botim: Ermal BEGA, Botoi: Qendra Shqiptare për Studime Orientale – A.C.F.O.S. B-O-O-K-S, (botimi i dytë) Tiranë 2020;
- KONTRIBUTET MUSLIMANE NË QYTETËRIMIN BOTËROR, përgatitën për botim: M. Basheer Ahmed, Md; Ambassador Syed A. Ahsani; Dilnawaz A. Siddiqui, Phd, përktheu: Festime Mehdiu Gashi, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC), Tiranë 2019;
- Dr W. Hazmy C.H. Dr Zainurashid Z. Dr Hussaini R., *BIOGRAPHY Muslim Scholars and Scientists*, Published by: Islamic Medical Association of Malaysia N. Sembilan, (<https://docs.google.com/file/d/0B-e6qHPbxSdNd1oxMUVCVG82a0E/edit>); <https://en.wikipedia.org/wiki/Al-Farabi>; <https://plato.stanford.edu/entries/al-farabi/>; <https://www.muslimphilosophy.com/ip/rep/H021.htm>; <https://www.britannica.com/biography/al-Farabi>; <https://thegreatthinkers.org/al-farabi/introduction/>; <https://www.middleeasteye.net/discover/farabi-muslim-philosopher-music-theorist-who>; <https://www.gov.kz/memleket/entities/mfa-london/activities/3387>;

MYFTIU TËRNAVA ZHVILLOI NJË VIZITË ZYRTARE NË BOSNJE DHE HERCEGOVINË

- **Myftiu Tërnavë u prit në takim nga reisul ulema i Bosnje dhe Hercegovinës, Husein ef. Kavazoviq**



Më 10 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, qëndroi për vizitë zyrtare në Sarajevë, me ftesë të Reisul-ulemas së Bashkësisë Islame të Bosnjë e Hercegovinës, Husein ef. Kavazoviq.

Gjatë kësaj vizite, në ambientet e Rijasetit në Sarajevë, Myftiu Tërnavë u prit nga Reisul-ulema Kavazoviq, i cili e falënderoi për vizitën vëllazërore dhe e njohu atë me veprimtarinë institucionale të Bashkësisë Islame të BeH-së, si dhe me sfidat me të cilat ajo përballet në përditshmëri.

Në takim, Myftiu Tërnavë vlerësoi lart rolin, kontributin dhe qëndrueshmërinë e Bashkësisë Islame të Bosnjë e Hercegovinës, duke theksuar rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndër-institucional dhe lidhjeve të ngushta ndërmjet dy bashkësive islame dhe popujve tanë.

“Kemi përjetuar të njëjtin agresor, i cili synoi shfarosjen dhe dëbimin e popullit tonë për shkak të përkatësisë etnike dhe fetare,” u shpreh ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Në shenjë respekti dhe solidariteti, Myftiu Tërnavë i dhuroi Reisul-ulemas librin “Dëshmitar i gjenocidit në Srebrenicë”, të autorit Mevludin Hrnjić, imam dhe i mbijetuar i gjenocidit. Ky botim i Shtëpisë Botuese “Dituria Islame”, u promovua në Prishtinë, në prag të shënimit të 30-vjetorit të gjenocidit në Srebrenicë.

- **Myftiu Tërnavë mori pjesë në shënimin e përvjetorit të 30-të të gjenocidit në Srebrenicë**

Më 11 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në shënimin e 30-vjetorit të gjenocidit serb mbi popullatën boshnjake në Potočar të Srebrenicës.

Në përvjetorin e 30-të të gjenocidit në Srebrenicë, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në ceremoninë zyrtare përkujtimore të mbajtur në Qendrën Memoriale në Potočar. Në këtë ngjarje të rëndësishme ishin të pranishëm udhëheqësit më të lartë të Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe delegacione nga vende të ndryshme të botës.

Myftiu Tërnavë mori pjesë edhe në faljen e namazit të xhumasë në mesxhidin e Qendrës Memoriale, si dhe në faljen e namazit të xhenazes për shtatë viktimat e reja të identifikuar të gjenocidit, trupat e të cilëve janë varrosur pas 30 vitesh. Me këtë rast, te varrezat e viktimave, Myftiu bëri lutje për shpirtat e të gjithë atyre që u masakruan nga forcat serbe, duke shprehur respektin dhe dhembjen e thellë për humbjen e tyre.



Ai ishte i shoqëruar nga Reisul-ulema i Bashkësisë Islame në Bosnjë e Hercegovinë, Husein ef. Kavazoviq dhe nga Reisul-ulema i Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut, h.fz. Shaqir ef. Fetai. Së bashku vizituan Qendrën Memoriale dhe varrezat e viktimave të gjenocidit në Potočar, duke shprehur solidaritetin dhe nderimin e tyre për viktimat dhe familjet e tyre.

- **Myftiu Tërnavë vizitoi fabrikën “GA-ME-HA”**

Më 12 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe Reisul-ulemaja i Bashkësisë Islame të Maqedonisë së Veriut, h.fz. Shaqir ef. Fetahu, të shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tyre, realizuan një vizitë në fabrikën e prodhimeve ushqimore dhe të pijeve “GA-ME-HA” në Sarajevë.

Delegacioni u prit ngrohtësisht nga pronari i fabrikës, z. Adem Miftari, i cili u dëshiroi mirëseardhje dhe i njohu mysafirët me historikun, zhvillimin dhe kapacitetet



prodhuese të kësaj ndërmarrjeje të njohur, e cila operon me sukses në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në tregjet rajonale.

Gjatë vizitës në ambientet e fabrikës, mysafirët patën mundësi të shohin nga afër procesin e prodhimit të mbi 1000 artikujve të ndryshëm ushqimorë. Z. Adem Miftari është një ndërmarrës i suksesshëm nga fshati Çalje, komuna e Gostivarit. Aktualisht, në fabrikën “GA-ME-HA” janë të punësuar rreth 150 punëtorë, ndërsa ekziston një tendencë e qartë për rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe të numrit të të punësuarve në periudhën e ardhshme.

Në përmbyllje të vizitës, Myftiu Tërnavë dhe Reisul-ulemaja Fetahu përgëzuan z. Miftari për suksesin dhe vizionin e tij afarist dhe e inkurajuan që të shqyrtojë mundësinë e zgjerimit të aktivitetit edhe në Kosovë, përmes hapjes së një filiali të fabrikës “GA-ME-HA”.

- **Myftiu Tërnavë vizitoi Qendrën Kulturore Shqiptare në Sarajevë**

Më 12 korrik 2025, në kuadër të vizitës së tij zyrtare në Bosnjë e Hercegovinë, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, zhvilloi një takim të ngrohtë dhe domethënës me drejtuesit e Qendrës Kulturore Shqiptare në Sarajevë, si dhe me përfaqësues të komunitetit dhe afaristëve shqiptarë që jetojnë dhe veprojnë prej shumë vitesh në Sarajevë dhe në qendra të tjera të këtij shteti.

Në këtë takim miqësor, organizuar në ambientet e Qendrës Kulturore, mirëseardhjen dhe përshëndetjen për myftiun dhe bashkëpunëtorët e tij e dha kryetari i Qendrës, z. Mitat Fidani. Ai falënderoi Myftiun Tërnavë për këtë vizitë të veçantë, duke e cilësuar atë si një dëshmi të qartë të kujdesit dhe përkujdesjes që Bashkësia Islame e Kosovës tregon për shqiptarët jashtë atdheut, për ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar, kulturor dhe fetar.

Z. Fidani e njohu myftiun për organizimin, strukturën dhe aktivitetet që zhvillon Qendra Kulturore Shqiptare në



Sarajevë, me theks të veçantë në rolin e saj në mbledhjen e komunitetit shqiptar, në ruajtjen dhe promovimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare, si dhe në përpjekjet për integrim të suksesshëm në jetën shoqërore dhe institucionale të Bosnjë e Hercegovinës. Ai theksoi gjithashtu rolin e rëndësishëm që luajnë afaristët shqiptarë në zhvillimin ekonomik lokal dhe në krijimin e urave të bashkëpunimit me komunitetin vendas.

Myftiu Tërnavë, pasi shprehu kënaqësinë për pritjen vëllazërore, shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e tij të sinqertë për përkushtimin dhe kontributin e komunitetit shqiptar në Sarajevë dhe më gjerë. Ai theksoi se lidhjet ndërmjet popullit shqiptar dhe atij boshnjak janë të ndërtuara mbi histori të përbashkëta, mbi sfida të përbashkëta dhe mbi përvoja të dhembshme të përballjes me agresionin dhe padrejtësinë, çka i ka afruar edhe më shumë këto dy popuj në frymën e solidaritetit, bashkëjetesës dhe respektit të ndërsjellë.

Në fjalën e tij, Myftiu Tërnavë ritheksoi gatishmërinë dhe përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës për të mbështetur Qendrën Kulturore Shqiptare dhe gjithë komunitetin shqiptar në Bosnjë e Hercegovinë në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar dhe fetar, në veçanti përmes bashkëpunimeve kulturore, edukative dhe fetare. Ai po ashtu ndau me të pranishmit disa nga përvojat, të arriturat dhe sfidat me të cilat është përballur Bashkësia Islame e Kosovës, duke ofruar mbështetje dhe frymëzim për punën e përbashkët në të ardhmen.

Në përmbyllje të takimit, kryetari i Qendrës, z. Fidani, i dorëzoi Myftiut Tërnavë një mirënjohje simbolike në shenjë falënderimi për vizitën dhe kujdesin e treguar, ndërsa të dy palët shkëmbyen dhurata simbolike që forcojnë lidhjet shpirtërore dhe kulturore mes shqiptarëve të Kosovës dhe atyre të diasporës në Bosnjë e Hercegovinë..

MYFTIU TËRNAVA ZHVILLOI NJË VIZITË ZYRTARE NË MAL TË ZI

- **Myftiu Tërnavë u prit në takim nga Reisul-ulema i Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Rifat ef. Fejzović**



Më 29 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, qëndroi për një vizitë zyrtare në Mal të Zi, ku ka realizuar takime të rëndësishme me drejtuesit më të lartë të Bashkësisë Islame të Malit të Zi, me përfaqësuesit e Këshillave të Myftinisë në Tivar dhe Ulqin, me kryetarin e Komunës së Ulqinit, kryetarin e Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve, si dhe me konsullin e Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë në Ulqin.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë është pritur nga Reisul-ulema i Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Rifat ef. Fejzović, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët më të afërt të Rijasetit, si dhe nga drejtuesit e Myftinisë së Ulqinit.

Reisi Fejzović e falënderoi Myftiun për vizitën, duke e konsideruar atë si një vizitë vëllazërore. “Jemi të nderuar me vizitën tuaj, i nderuar Myfti. Ju falënderojmë për bashkëpunimin e sinqertë dhe mbështetjen që na keni dhënë ndër vite. Jemi të përkushtuar që të rrisim nivelin e bashkëpunimit në fushën e arsimit, kulturës dhe botimeve”, tha ndër të tjera reisi Fejzović.

Ai gjithashtu e njohu Myftiun me të arriturat, sfidat dhe projektet e Bashkësisë Islame të Malit të Zi.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë theksoi se, pavarësisht bashkëpunimit të mirë ndër vite, ka ardhur koha që ky bashkëpunim të intensifikohet edhe më shumë, përmes koordinimit të nismave të përbashkëta në projekte konkrete. Në këtë kontekst, Myftiu vlerësoi lart kontributin e Bashkësisë Islame të Malit të Zi në strehimin dhe akomodimin e të zhvendosurve nga Kosova gjatë luftës së vitit 1999. Ai shprehu mirënjohjen e thellë për ndihmën e dhënë veçanërisht nga

Myftinitë e Ulqinit, Rozhajës dhe Tivarit për pritjen dhe strehimin e qytetarëve të dëbuar nga forcat serbe.

“E kemi të qartë se solidariteti vëllazëror në kohë të vështira nuk harrohet. Ajo që ka bërë popullata shqiptare dhe boshnjake për të dëbuarit nga Kosova meriton vlerësim të drejtë dhe dinjitoz. Prandaj, jemi duke përgatitur organizimin e një konference ku do të trajtohet kjo çështje jo vetëm në Mal të Zi, por edhe në vendet e tjera”, tha Myftiu Tërnavë.

Ai shtoi se është me rëndësi që të krijohen mundësi që komuniteti shqiptar kudo që jeton në Mal të Zi të gëzojë të drejtat e tij në gjuhë, arsim, edukim dhe punësim.

- **Myftiu Tërnavë vizitoi Mexhllisin e Bashkësisë Islame në Tivar**

Më 28 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, zhvilloi një vizitë në Mexhllisin e Bashkësisë Islame në Tivar, ku u prit nga kryeimami i mexhllisit dhe udhëheqësi i Qendrës Islame në Tivar, Mujadin ef. Milaimi.

Kryeimami Milaimi e falënderoi Myftiun për vizitën dhe e njohu atë me organizimin e punës së Mexhllisit, si dhe me funksionimin e Qendrës Islame në Tivar.

Myftiu Tërnavë, pasi falënderoi për pritjen, përgëzoi kryeimamin për kontributin dhe angazhimin e tij në ngritjen e jetës fetare në Tivar dhe rrethinë. Ai gjithashtu shprehu gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për të bashkërenduar aktivitete të përbashkëta me Mexhllisin e Tivarit, në funksion të ruajtjes së vlerave kombëtare dhe islame në mesin e qytetarëve të këtij qyteti.

Delegacioni nga Kosova gjatë kësaj vizite vizitoi edhe pjesën historike të Çarshisë së Vjetër të Tivarit.



- **Myftiu Tërnavë vizitoi Konsullatën e Shqipërisë në Ulqin**



Më 29 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vizitoi Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Ulqin, ku u prit nga konsulli i Përgjithshëm, z. Arben Doçi.

Konsulli Doçi e falënderoi Myftiun për vizitën dhe e njohu atë me aktivitetin dhe angazhimet që Konsullata zhvillon në Ulqin, Tivar dhe Krajë. Ai theksoi se gjithmonë e ka vlerësuar lart rolin e Bashkësisë Islame në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, kulturor dhe fetar të shqiptarëve në Mal të Zi.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë përgëzoi konsullin për punën e palodhshme që po bën në shërbim të qytetarëve shqiptarë në Mal të Zi, duke theksuar se duhet angazhim i të gjithëve për të krijuar kushte dhe premisa për një jetë dinjitoze për shqiptarët në Mal të Zi, përmes kultivimit të traditës, kulturës dhe identitetit të tyre.

- **Myftiu Tërnavë vizitoi Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi**



Më 29 korrik 2025, gjatë qëndrimit në Ulqin, Myftiu Tërnavë vizitoi Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi, ku u prit nga kryetari i Këshillit, z. Faik Nika.

Z. Nika e njohu Myftiun me misionin e Këshillit për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit të shqiptarëve në Mal të Zi. Ai shprehu shqetësimin për migrimin e shtuar të shqiptarëve drejt vendeve perëndimore dhe për procesin e heshtur të asimilimit.

Ai kërkoi që Myftiu, në bashkëpunim me Myftininë e Ulqinit, të ndihmojë në ruajtjen e identitetit dhe përkatësisë islame e shqiptare.

Myftiu Tërnavë, pasi falënderoi për pritjen e ngrohtë, vlerësoi lart punën dhe vizionin e Këshillit dhe shprehu gatishmërinë për të kontribuar në ruajtjen e gjuhës, arsimit dhe kulturës shqiptare.

- **Myftiu Tërnavë takoi kryetarin e Komunës së Ulqinit**



Më 29 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Tërnavë është pritur në takim nga kryetari i Komunës së Ulqinit, z. Genci Nimanbegu. Kryetari Nimanbegu e falënderoi Myftiun për vizitën dhe theksoi se aktualisht Ulqini është i mbushur me vizitorë nga Kosova.

“Vizita juaj në Ulqin është e një rëndësie të veçantë, sepse, siç dihet, ne kemi raporte të veçanta dhe lidhje të ngushta me Kosovën dhe qytetarët e saj”, tha ai.

Nimanbegu shtoi se Komuna ka bashkëpunim të frytshëm me Myftininë e Bashkësisë Islame në Ulqin, dhe shprehu shqetësimin e tij për migrimin në rritje të popullsisë nga këto treva.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë theksoi se Ulqini, për të dhe për qytetarët e Kosovës, është një vend i veçantë dhe me ndjesi të posaçme. Ai shprehu gatishmërinë për të kontribuar në bashkëpunim me Myftininë në Ulqin në përgatitjen e kuadrove, mbështetjen me literaturë, si dhe për realizimin e

projekteve të përbashkëta. “Duhet bërë më shumë në ruajtjen, kultivimin dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe fetar. Duhet kushtuar rëndësi fillimisht ruajtjes së gjuhës, sepse gjuha është elementi më dallues i identitetit të një populli”, theksoi ai.

- **Myftiu Tërnavë mori pjesë në promovimin e librit “Institucionet Islame dhe imamët e Krajës”**



Më 30 korrik 2025, në mexhllisin e Krajës në qendër të Ostrosit – Komuna e Tivarit, u promovua botimi më i ri “Institucionet Islame dhe imamët e Krajës”, i autorit Hamdi Alaj.

Ky botim ndriçon rolin dhe kontributin e institucioneve fetare dhe imamëve të Krajës në ruajtjen e identitetit fetar e kombëtar.

Në promovim mori pjesë edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili përgëzoi autorin për punën dhe përkushtimin e tij.

Vlerësimet për librin dhanë edhe: Irfan Kaca – kryeimam i Krajës, Ali Bardhi – kryeimam i Ulqinit dhe Ramadan Shkodra – drejtor në BIK.

Autori Hamdi Alaj theksoi se libri është një përpjekje për të dokumentuar dhe çmuar trashëgiminë fetare dhe kulturore të kësaj treve.

- **Myftiu Tërnavë takoi imamët e Ulqinit**

Më 29 korrik 2025, gjatë qëndrimit në Ulqin, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ka takuar imamët e Mexhllisit të Bashkësisë Islame të Ulqinit, të cilët i ka përgëzuar për kontributin e çmuar në misionin e tyre fisnik për t’iu prirë, edukuar dhe fisnikëruar besimtarët e kësaj treve.

Myftiu vlerësoi lart edhe angazhimin shembullor të këtij mexhllisi, e posaçërisht të imamëve të tij, gjatë pritjes dhe përkujdesjes ndaj të dëbuarve nga Kosova gjatë luftës së vitit 1999, duke dëshmuar një ndjenjë të thellë vëllazërie dhe solidariteti.

Në këtë takim, Myftiu Tërnavë u bëri thirrje imamëve që të angazhohen me përkushtim për ruajtjen, kultivimin dhe promovimin e identitetit tonë fetar, gjuhësor dhe kulturor. Ai shprehu gjithashtu gatishmërinë për t’i mbështetur imamët me përgatitje profesionale, literaturë dhe trajnime të nevojshme për përmbushjen sa më të suksesshme të misionit të tyre.



Takimi u zhvillua në një atmosferë vëllazërore, ku u bashkëbisedua për arritjet, sfidat dhe punën që bëhet çdo ditë me xhematët e kësaj treve.

- **Myftiu i Kosovës vizitoi Panairin e Librit në Ulqin**



Më 29 korrik 2025, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ka vizituar Panairin e Librit që u mbajt në qytetin e Ulqinit. Gjatë vizitës së tij, Myftiu ndaloi te stendat e botuesve pjesëmarrës, ku u informua nga afër mbi ecurinë e panairit si dhe për interesimin e publikut ndaj librit dhe botimeve të ndryshme.

Ndër pjesëmarrësit në këtë panair është edhe shtëpia botuese “Dituria Islame”, e cila vepron në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës. Myftiu pati rastin të shoh nga afër interesimin e vizitorëve për botimet e BIK-ut dhe vlerësoi kontributin e kësaj shtëpie botuese në promovimin e dijes, kulturës dhe trashëgimisë islame ndër shqiptarët.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NDIHMËS SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA (OKB), Z. MIROSLAV JENÇA

Më 8 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim zyrtar ndihmës sekretarin e përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, z. Miroslav Jenča.

Gjatë takimit u diskutua për rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës në promovimin e paqes, harmonisë dhe tolerancës ndërfaqetare në vend. Myftiu Tërnavë e njohu z. Jenča për angazhimin e pandërprerë të BIK-ut në ruajtjen e bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve fetare dhe në kultivimin e vlerave të respektit të ndërsjellë, mirëkuptimit dhe dialogut.

“Ne besojmë fuqishëm se feja duhet të jetë faktor i paqes, jo i ndarjes. Bashkësia Islame e Kosovës gjithmonë ka qenë dhe do të mbetet promotore e tolerancës dhe mirëkuptimit ndërfaqetare,” theksoi Myftiu Tërnavë.

Nga ana e tij, z. Jenča vlerësoi lart kontributin e BIK-ut në ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe paqësore në Kosovë. Ai potencoi rëndësinë që ka roli i liderëve fetarë në nxitjen e stabilitetit dhe ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve.



KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 1 korrik 2025, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e saj të rregullt, të kryesuar nga kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Në këtë mbledhje u diskutua për aktivitetin në Diasporë, si dhe për mënyrat dhe format e intensifikimit dhe shtimit të këtij aktiviteti, si dhe u diskutua për raportin e grumbullimit dhe therjes së kurbaneve.



MYFTIU TËRNAVA TAKOI KRYETARËT E KËSHILLAVE TË BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Më 2 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka mbajtur një takim me kryetarët e Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës, me të cilët diskutoi për një sërë çështjesh me rëndësi, përfshirë këtu gjendjen aktuale të jetës fetare në Kosovë dhe mbarëvajtjen e saj.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për organizimin dhe mbarëvajtjen e haxhit për këtë vit, si dhe për ecurinë e organizimit të therjes së kurbaneve.

Myftiu Naim ef. Tërnavë vlerësoi kontributin e Këshillave në ruajtjen e unitetit dhe zhvillimin e aktiviteteve fetare në nivel kombëtar. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë

mes Këshillave dhe Kryesisë, për t'u përballur me sfidat aktuale dhe për të përmbushur nevojat shpirtërore të besimtarëve.



NË GJAKOVË U BË PËRURIMI I DORËSHKRIMIT “SAHIHU I BUHARIUT” – KOPJA E JUNINIT

Më 3 korrik 2025, nën organizimin e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame dhe në bashkëpunim me Këshillin e Bashkësisë Islame të Gjakovës, në mënyrë solemne u bë përurimi i dorëshkrimit “Sahihu i Buhariut” – kopja e Juninit, i cili dorëshkrim qe ruajtur për kohë të gjatë në Xhaminë e Hadumit në Gjakovë.

Programi filloi me fjalën e mirëseardhjes nga kryetari i Këshillit të BI-së së Gjakovës, Valon ef. Myrta, i cili falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, si dhe theksoi rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë islame.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, tha se kjo kopje e dorëshkrimit të cilën sot po e përurojmë ka një rëndësi të madhe për trashëgiminë tonë të begatë. Ai tha se sot ajo po kthehet aty ku edhe kishte vendin, pra në Xhaminë e Hadumit, nga edhe është marrë si dorëshkrim. Drejtori Bajgora shprehu

gatishmërinë dhe interesimin e tij dhe të Institutit që ai drejton që edhe të tej të kontribuojnë në ndriçimin e trashëgimisë islame. Në fund të fjalës së tij, drejtori Bajgora, ftoi të gjithë ata që kanë vepra të vjetra në dorëshkrime që t'i sjellin ato tek Instituti, në mënyrë që të bëhet ruajtja dhe deshifrimi i tyre.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, në fjalën e tij, theksoi se dorëshkrimi që ne sot po e prezantojmë është një nga versionet më të besueshme të Sahihut të Buhariut. “Ajo që e bën këtë dorëshkrim edhe më të veçantë dhe më të rëndësishëm nuk është vetëm vlera e tij tekstuale, por edhe fakti se është lexuar dhe kopjuar në një xhami të Kosovës, pra në Xhaminë e Hadum Agës në Gjakovë dhe është vakëfnuar për lexuesit dhe nxënësit brez pas brezi.”

Myftiu Tërnavë theksoi rëndësinë e librave, duke rikujtuar faktin se gjatë luftës së fundit në Kosovë, një pjesë e konsiderueshme e dorëshkrimeve janë asgjësuar. “Këto dorëshkrime, të cilat

përfaqësojnë trashëgiminë kulturore islame të ne, datojnë nga gjysma e shekullit XIV. Megjithatë, gjatë periudhave të vështira historike, nëpër të cilat kaloi vendi ynë, e sidomos gjatë luftës së fundit në Kosovë 1998-1999, me djegien e arkivit dhe të bibliotekave të Bashkësisë Islam të Kosovës, një pjesë e konsiderueshme e këtyre dorëshkrimeve të çmuara janë djegur dhe shkatërruar nga forcat serbe.”

Pas pjesës hyrëse, sesioni shkencor vazhdoi me paraqitjen e kumtesave nga studiuesit: dr. Sulejman Osmani, Abdulkadër Arnauti dhe Muhamed Stublla, të cilët elabouran në detaje rëndësinë e këtij dorëshkrimi dhe vlerën e tij në historinë e shkencës së hadithit.

Promovimi i këtij dorëshkrimi u përmbyll me ceremoninë e dorëzimit të “Sahihut të Buhariut” – kopja e Juninit nga Myftiu Tërnavë për Xhaminë e Hadumit. Pranimin e këtyre librave e bëri kryetari i Këshillit të BI-së së Gjakovës, Valon ef. Myrta.



U PROMOVUA LIBRI “DËSHMITAR I GJENOCIDIT NË SREBRENICË” I AUTORIT MEVLUDIN HRNJIĆ

Më 8 korrik 2025, në kuadër të 30-vjetorit të gjenocidit në Srebrenicë, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka botuar librin “Dëshmitar i gjenocidit në Srebrenicë”, të autorit boshnjak, imamit Mevludin Hrnjić.

Ky libër rrëfen përjetimet e vetë autorit gjatë gjenocidit të vitit 1995 në Srebrenicë – si një nga krimet më të rënda ndaj popullsisë myslimane në Bosnje dhe Hercegovinë.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, e vlerësoi librin si një dëshmi të fuqishme që kontribuon në ruajtjen e kujtesës historike dhe në ndërgjegjësimin shoqëror për krimet e kryera.

I pranishëm në promovimin e librit ishte edhe kryeministri në detyrë i Kosovës, z. Albin Kurti, i cili theksoi rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike dhe solidaritetit të popullit të Kosovës me viktimat e gjenocidit në Srebrenicë.

Ky libër u çmua edhe u vlerësua nga Ramadan Shkodra, drejtor për Shtyp dhe Veprimtari Botuese në Bashkësinë Islame të Kosovës edhe për faktin se ky botim është rrëfim i një dëshmitari që përjetoi errësirën e gjenocidit.

Autori, njëherësh imami Mevludin Hrnjić, vetë i mbijetuar i masakrës së Srebrenicës, rrëfeu se libri është një dëshmi personale e asaj që përjetoi si fëmijë në korrikun e vitit 1995.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NXËNËSIT E AKADEMISË “HIFDH KIDS”

Më 22 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në një takim të ngrohtë dhe frymëzues nxënësit që vijnë në mësim-besimin pranë

Akademisë së Kuranit “Hifdh Kids”, e të cilët shoqëroheshin nga mësueset e tyre, hafëzet Rineta dhe Fatime Nitaj.

Gjatë kësaj bisede, Myftiu Tërnavë, uroi dhe përgëzoi nxënësit për arritjet e

tyre të dukshme në mësimin e Kuranit përmendsh, duke i inkurajuar ata që të vazhdojnë edhe më tej, me përkushtim dhe durim rrugën e nisur, si dhe duke ua kujtuar atyre se ruajtja në memoriet e tyre e Kuranit fisnik është një dhuratë dhe një përgjegjësi e madhe për ta.

Nxënësit e Akademisë, me zërin e tyre të bukur, të përkushtuar lexuan disa ajete dhe sure nga Kurani fisnik, teksa mësueset e tyre, shprehën falënderimet për Myftiun Tërnavë për mbështetjen dhe përkrahjen që vazhdimisht ua ka dhënë atyre.



MYFTIU TËRNAVA MBAJTI HYTBEN E XHUMASË NË XHAMINË E FSHATIT HOGOSHT TË KAMENICËS

Më 25 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka mbajtur hytben e xhumasë në xhaminë e fshatit Hogosht të Kamenicës.

Ai para xhematit të Hogoshtit ligjëroi rreth figurës së myderrizit Haki ef. Sermaxha.

“Sot jam këtu me një ndjenjë të veçantë nderimi dhe përkushtimi. Kam vendosur që këtë ditë ta kaloj me ju – në vendlindjen e një figure të shquar të dijes, fesë dhe atdhedashurisë, në vendlindjen e Haki efendi Sermaxhës. Ky personalitet i dijes dhe i karakterit nuk ishte thjesht një imam apo mësues

i zakonshëm. Ai ishte një myderriz i ndritur, një arsimdashës i paepur dhe një atdhetar i rrallë, që tërë jetën ia kushtoi këtij vendi, këtij populli, gjuhës shqipe, besimit islam dhe identitetit tonë kombëtar” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI FSHATIN HOGOSHT TË KAMENICËS

Më 25 korrik 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, realizoi një vizitë të veçantë në fshatin Hogosht të Kamenicës, ku u prit me respekt nga banorët e zonës, përfaqësues të institucioneve lokale dhe biznesmenë.

Gjatë qëndrimit në këtë trevë, Myftiu Tërnavë vizitoi kullën e heroit kombëtar Kadri Zeka, një simbol i qëndresës dhe sakrificës për liri. Me këtë rast, Myftiu shprehu vlerësimin për kontributin e familjes Zeka dhe gjithë atyre që u sakrifikuan për lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Vizita e tij përfshiu edhe ndalesën në kompaninë private “Güris”, e cila

operon në fushën e energjisë së ripërtrishme. Ai u njoh nga afër me punën e kësaj kompanie, duke përgëzuar drejtuesit për angazhimin në zhvillimin ekonomik dhe përkushtimin ndaj burimeve të qëndrueshme të energjisë.

Në fund të vizitës, Myftiu Tërnavë vizitoi memorialin e dëshmorëve të fshatit Kikë, ku këndoi nga një Fatiha për shpirtin e të rënëve dhe theksoi rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike dhe vlerësimit të sakrificave të bijve më të mirë të vendit.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË PROMOVIMIN E DOKUMENTARIT KUSHTUAR HAKI EF. SERMAXHËS

Më 25 korrik 2025, Këshilli i Bashkësisë Islame në Kamenicë organizoi një ngjarje kulturore e fetare për të përkujtuar jetën dhe veprën e myderrizit Haki ef. Sermaxhajt.

Në kuadër të kësaj ngjarjeje, u shfaq dokumentari “Kandili i Shqipërisë Etnike – për myderrizin Haki ef. Sermaxhaj” dhe u promovua libri “Xhamia e Hogoshtit – monografi”, i autorit Xhemush Biçku. Ngjarja u mbajt në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për kontributin e jashtëzakonshëm fetar, arsimor dhe kombëtar të Haki ef. Sermaxhajt, përpara një numri të madh qytetarësh, intelektualësh dhe përfaqësuesish të institucioneve lokale e qendrore.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, tha se jeta e Haki ef. Sermaxhajt është dëshmi e përkushtimit të ulemave shqiptarë për mbrojtjen e Islamit dhe atdheut. Ai theksoi se figura të tilla janë udhërrëfyese për brezat që vijnë dhe dëshmi e çmimit të lartë që kanë paguar dijetarët tanë në mbrojtje të identitetit

kombëtar dhe fetar. Myftiu Tërnavë gjithashtu shprehu rëndësinë që ka ruajtja e kujtesës kolektive, për të mos harruar sakrificat e dijetarëve tanë nëpër dekada të errëta.

Kryetari i Kamenicës, Kadri Rahimaj, tha se jeta dhe vepra e Haki Sermaxhajt është një model i mirë që duhet ndjekur nga gjeneratat e reja dhe të jetë shkak i bashkëpunimit dhe forcimit të lidhjeve mes njëri-tjetrit. Ai e cilësoi Sermaxhajin si figurë që e ndërthurte urtësinë, dijen dhe trimërinë, dhe theksoi se emra të tillë nuk duhet të mbesin vetëm në histori, por të shndërrohen në inspirim për veprim sot.

Gjatë këtij organizimi u promovua edhe botimi i imamit, Xhemush Biçkut, “Xhamia e Hogoshtit – monografi”, një libër që dokumenton historinë dhe trashëgiminë shpirtërore të vendlindjes së Haki ef. Sermaxhajt. Libri u vlerësua si një kontribut i çmuar për ruajtjen e identitetit fetar e kulturor të zonës dhe si dëshmi e gjallë e rrënjëve të thella islame në këto anë.



Myderriz Haki ef. Sermaxhaj lindi më 14 tetor 1914 në Hogosht të Dardanës, në një familje me tradita fetare dhe atdhetare. U edukua si intelektual i përkushtuar ndaj fesë, kombit dhe atdheut.

Pasi përfundoi shkollën fillore në vitin 1925/26, vazhdoi në Medresenë “Meddah” të Shkupit më 1927/28, ku u formua nga Myderrizi i njohur Ataullah Kurtishi. Në vitin 1940, pas përfundimit të medresesë, u kthye në Gjilan si Myderriz dhe drejtor i Medresesë “Atik”, ku reformoi sistemin mësimor dhe futi gjuhën shqipe si lëndë mësimi për herë të parë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, iu bashkua Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare (L.L.T.Sh), ONDSH-së dhe organizatës “Besa Kombëtare”, me degë të shtrira në të gjitha viset shqiptare të ish-Jugosllavisë. Ai udhëhoqi Komitetin e Qarkut të NDSH-së në Gjilan, duke kontribuar në përpjekjet për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Në gusht të vitit 1946, pas burgosjes së udhëheqjes së NDSH-së, u arrestua nga OZN-a në Shkup, ku u torturua rëndë. Për shkak të gjendjes shëndetësore nuk u gjykua në “Procesin e Gjilanit”, por veçmas, dhe u dënua me 20 vjet burg. U dërgua në burgun e Mitrovicës së Sremit. Vdiq më 27 janar 1948 pas 9 muajsh në spitalin e burgut, ku edhe u varros nga shokët e tij. Eshtrat e tij ende prehen në tokë të huaj.



DREJTORIA E DIASPORËS PRAN BIK -UT, ORGANIZOI TAKIM ME BASHKATDHEITARËT TANË QË JETOJNË DHE VEPROJNË NË MËRGATË

Besimtarë nga Gjermania, Zvicra, Austria, e deri nga Australia dhe Amerika, u bashkuan sot në një takim tashmë tradicional në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë.

Kësaj ftese iu përgjigjën kryetarë të unioneve dhe të bashkësive islame shqiptare, kryetarë të qendrave islame shqiptare, anëtarë të kryesive të qendrave, përfaqësues të xhamive dhe besimtarë të shumtë nga diaspora.

Ekrem Simnica, drejtor i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës tha se ky takim është një dëshmi e gjallë e vëllazërisë dhe e lidhjes fetare e kombëtare që na bënë krenarë në çdo vend të botës.

Mirëseardhje në vendlindje dhe në vendin ku morën mësimet fetare dhe kombëtare u dëshiroi edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë me ç’rast tha se po e bëjnë krenarë vendin ku u



arsimuan dhe u edukuan në vendet ku sot po jetojnë.

Në anën tjetër edhe bashkatdhetarë që ishin në këtë takim dhanë sugjerime, propozime dhe ide për thellimin e bashkëpunimit mes tyre dhe Bashkësisë Islame të Kosovës.

Ky takim tashmë është shndërruar në takim tradicional, ku çdo vit takohen

në Medresenë “Alauddin” për të rritur mundësitë e bashkëpunimit për organizimin sa më të mirë të jetës fetare në vendet ku jetojnë mërgimtarët.

Në fund Bashkësia Islame e Kosovës kishte përgatitur dhurata për mërgimtarët tanë që ishin pjesë e këtij takimi miqësor dhe vëllazëror.

U MBAJT FORUMI I PARË I TË DIPLOMUARVE NGA BALLKANI NË UNIVERSITETET SAUDITE



Nën patronazhin e universiteteve kryesore saudite dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, në Tiranë, nga 7 deri më 9 korrik 2025, u mbajt Forumi i Parë i të Diplomuarve nga Ballkani në universitetet saudite.

Në emër të Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, mori pjesë shefi i kabinetit, Besim ef. Mehmeti.

Organizuar nga universitetet “Imam Muhamed bin Saud”, Islamik i Medinës

dhe “Umm al Qura”, forumi mblodhi qindra të diplomuar dhe figura të larta akademike e diplomatike nga rajoni.

Ndër të ftuarit ishin ambasadori saudit në Tiranë, Feisal Hifzi, rektorë të universiteteve organizatore dhe përfaqësues diplomatikë nga Katari, Kuvajti, Libia dhe Palestina.

Ceremonia u hap me himnet kombëtare, lexim nga Kurani dhe një dokumentar mbi rolin e Mbretërisë në


përkrahje të arsimit dhe studentëve ndërkombëtarë.

Rektori Ahmed al Ameri theksoi rëndësinë e lidhjes me të diplomuarit dhe rolin e tyre në përhapjen e dijes, gjuhës arabe dhe vlerave të moderimit. Ai vlerësoi vizionin saudit për ndikim global në arsim.

Ambasadori Hifzi e cilësoi Forumin si një urë për forcimin e lidhjeve me Ballkanin dhe të diplomuarit si ambasadorë të vlerave islame saudite.

Në emër të të diplomuarve, myftiu Agim Duka falënderoi Mbretërinë për formimin akademik dhe ndikimin në jetën e tij profesionale e shpirtërore

Forumi përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zgjerimit të bashkëpunimit arsimor e kulturor mes Arabisë Saudite dhe Ballkanit, përmes rrjetit të të diplomuarve si ura të dialogut dhe zhvillimit



KËTU MUND T'I GJENI:
BOTIMET DHE PERIODIKUN
E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS
BOTIMET E SHTËPISË BOTUESE "DITURIA ISLAME"

**SHTËPIA BOTUESE
"DITURIA ISLAME"**

+383 44 754 008

LIBRARIA DITURIA ISLAME

"BAJRAM KELMENDI, NR. 176, 10 000 PRISHTINË - KOSOVË"

DITURIA ISLAME • Nr. 417 GUSHT 2025